



# Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë – EULEX

## Raporti i Monitorimit të Drejtësisë

Zbatimi i Rekomandimeve

Nëntor 2024



# **Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë – EULEX Raporti i Monitorimit të Drejtësisë**

Zbatimi i Rekomandimeve

Nëntor 2024



# TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave .....	5
Parathënie .....	7
<b>1. Hyrje .....</b>	<b>9</b>
<b>2. Gjetjet nga monitorimi sistemik .....</b>	<b>10</b>
2.1. Trajtimi i rasteve të ‘profilit të lartë’ dhe ish-rasteve të EULEX-it nga gjyqësori i Kosovës .....	10
2.2. Produktiviteti i seancave gjyqësore .....	14
2.3. Funkcionimi i Departamentit Special në Gjykatën Themelore dhe Gjykatën e Apelit të Prishtinës .....	16
2.4. Politika e rigjyimit brenda sistemit të drejtësisë së Kosovës .....	18
2.5. Caktimi i rasteve në procedurën e rigjyimit .....	20
2.6. Regjistrimi i procedurave gjyqësore .....	22
2.7. Shpallja e aktgjykimeve penale në shkallë të parë .....	24
2.8. Përdorimi i paraburgimit gjatë procedurës penale .....	25
2.9. Zbatimi i sanksioneve penale përfundimtare .....	28
2.10. Zbatimi i dënimeve plotësuese .....	30
2.11. Caktimi i seancave gjyqësore .....	35
2.12. Konfiskimi dhe sekuestrimi (konfiskimi i përkohshëm) i pasurisë .....	36
2.13. Institucionet publike, shtetërore dhe shoqërore si palë të dëmtuara .....	38
<b>3. Gjetjet nga monitorimi tematik .....</b>	<b>40</b>
3.1 Antikorrupsioni .....	40
3.2 Krimet sipas të drejtës ndërkombëtare .....	42
3.3 Dhuna në baza gjinore .....	46
3.4 Privatizimi dhe likuidimi .....	51
3.5 Të drejtat pronësore – Mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë dhe detyruese në kundërshtim me të drejtat pronësore .....	53
3.6 Drejtësia për të miturit: aplikimi i ‘masave të diversitetit’ për shkelësit e mitur .....	54
3.7 Administrata e gjykatës – Sistemi Informativ i Menaxhimit të Lëndëve (SIML) .....	56
<b>Shtojcë – Lista e rasteve të monitoruara dhe të referuara .....</b>	<b>59</b>
Ish rastet e EULEX-it .....	65
Ish-rastet e EULEX-it të krimeve të luftës .....	66
Rastet e krimeve të luftës që nuk janë shqyrtuar nga EULEX-i .....	73



## Lista e shkurtesave

<b>AKK</b>	Agjencia Kundër Korrupsionit
<b>TFAK</b>	Task Forca Anti-Korrupsionit (PK)
<b>AAPSK</b>	Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
<b>APK</b>	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit
<b>GJTH</b>	Gjykata Themelore
<b>PTH</b>	Prokuroria Themelore
<b>KP</b>	Kodi Penal
<b>KPRSFJ</b>	Kodi Penal i Jugosllavisë
<b>SIML</b>	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Lëndëve
<b>GJA</b>	Gjykata e Apelit
<b>KPP</b>	Kodi i Procedurës Penale
<b>KEDNJ</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>GJEDNJ</b>	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
<b>DHBGJ</b>	Dhuna në baza gjinore
<b>FDHK</b>	Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë
<b>KDM</b>	Kodi i Drejtësisë për të Mitur
<b>SHKK</b>	Shërbimi Korrektues i Kosovës
<b>KGJK</b>	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
<b>PK</b>	Policia e Kosovës
<b>AKP</b>	Agjencia Kosovare e Pronës
<b>KPK</b>	Këshilli Prokurorial i Kosovës
<b>KKPK</b>	Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës
<b>SHSK</b>	Shërbimi Sprovues i Kosovës
<b>AKKVP</b>	Agjencia Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronës
<b>LESK</b>	Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Kriminale
<b>LEPS</b>	Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale
<b>AKP</b>	Agjencia Kosovare e Privatizimit
<b>DHPGJS</b>	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme
<b>NJHS</b>	Njësia për Hetime Speciale (PK) (ish-TFAK)
<b>PSRK</b>	Prokuroria Speciale e Kosovës
<b>GJS</b>	Gjykata Supreme
<b>VNT</b>	Vlerësimi i nevojave për trajnim
<b>NJHKL</b>	Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës (PK)



# Parathënie

Kam kënaqësinë t'u prezantoj homologëve tanë dhe publikut të gjerë në Kosovë Raportin e katërt publik të Monitorimit të Drejtësisë të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX).

Që nga heqja graduale e mandatit të tij ekzekutiv në vitin 2018, EULEX-i e ka monitoruar në mënyrë aktive të gjithë zinxhirin e drejtësisë, duke përfshirë policinë, brenda një konteksti kritik, ku mandati i tij i ri është përshtatur jo vetëm me nevojat specifike të institucioneve ligjore të Kosovës, por edhe me parimet më të gjera të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit.

Tranzicioni me faza nga një mandat ekzekutiv në një rol monitorues dhe këshillues e pasqyron strategjinë në zhvillim të EULEX-it në Kosovë, duke u fokusuar tani në forcimin e pronësisë vendase të sistemit të drejtësisë. Ky ndryshim strategjik e thekson qasjen më të gjerë të BE-së për fuqizimin e institucioneve vendase duke ruajtur mbikëqyrjen për të siguruar përafrimin me standardet evropiane.

Vizioni i BE-së për sundimin e ligjit e thekson pavarësinë gjyqësore, transparencën, llogaridhënien dhe respektimin e të drejtave të njeriut – si gurthemel që e përbëjnë bazamentin e çdo shoqërie të qëndrueshme dhe demokratike. Në këtë drejtim, rolet monitoruese, këshilluese dhe mbështetëse të EULEX-it janë të një rëndësie të madhe për nxitjen e këtyre parimeve në Kosovë, ndërsa ajo ecën në rrugën drejt integritit në BE, në mënyrë që të vlerësohet përputhshmëria institucionale me kornizën ligjore të Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut.

Bazuar në gjetjet e procesit të tij të monitorimit të fuqishëm, si dhe me respektin e plotë për pavarësinë e institucioneve të monitoruara, EULEX-i nxjerr rekomandime për autoritetet përkatëse për të ndihmuar në adresimin e mangësive të identifikuara, si dhe e përcjell zbatimin e tyre.

Që nga viti 2018, EULEX-i i ka publikuar gjashtë Raporte të Monitorimit të Drejtësisë. Tre të parët u ndanë ekskluzivisht me organet e drejtësisë dhe institucionet përgjegjëse për sundimin e ligjit. Megjithatë, nga viti 2020, raportet janë bërë publike, duke synuar që ta rrisin llogaridhënien institucionale dhe të kontribuojnë për një kuptim më të thellë të asaj se si zbatohet sundimi i ligjit në Kosovë. Më hollësisht, Raportet e mëparshme të Monitorimit të Drejtësisë, të publikuara në vitet 2020, 2021 dhe 2022, vlerësuan aspekte të ndryshme të funksionimit të sistemeve të drejtësisë penale dhe civile, duke marrë parasysh këndvështrimet sistemike dhe tematike. Përveç paraqitjes së gjetjeve të monitorimit, këto raporte ofruan rekomandime të shumta për institucionet e sundimit të ligjit me qëllim të mbështetjes së përputhshmërisë më të mirë me kornizën ligjore të Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut.

Ky raport është më ndryshe, pasi e shqyrton në mënyrë specifike zbatimin e rekomandimeve të bëra në raportet e mëparshme, duke e vlerësuar shkallën e progresit të arritur deri më tani. Megjithatë, ky raport nuk i adreson të gjitha çështjet sistemike dhe tematike të monitoruara nga EULEX-i, por fokusohet në një nëngrup të përzgjedhur bazuar në monitorimin e mbi 300 rasteve, si dhe në të dhënat dhe informacionet e mbledhura nga institucionet përkatëse dhe konsultimet me zyrtarët e policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit, krahas anëtarëve të odave të avokatëve dhe shoqërisë civile.

Përmes monitorimit të rasteve specifike, EULEX-i e ka vlerësuar zbatimin e shumë rekomandimeve të parapara për adresimin e shqetësimeve sistemike. Po ashtu, EULEX-i e ka vlerësuar trajtimin e disa llojeve të veprave penale, siç janë korrupsioni, dhuna në baza gjinore dhe krimet sipas së drejtës ndërkombëtare. Gjithashtu, ky raport e vlerëson progresin në tema të tjera, siç janë rastet civile që kanë të bëjnë me kontestet pronësore, aplikimin e masave të diversitetit për të miturit në rastet penale dhe funksionimin e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Lëndëve (SIML).



Për më tepër, qasja e publikut të gjerë në gjetjet dhe rekomandimet tona synon ta promovojë pjesëmarrjen e të gjitha palëve përkatëse, para së gjithash të popullit të Kosovës, në avancimin e mëtutjeshëm të Kosovës në rrugën e saj evropiane. Ai duhet të shërbejë si thirrje për veprim për leadershipin e Kosovës dhe shoqërinë e saj civile që të angazhohen më thellë në proceset reformuese. Rruga drejt anëtarësimit në BE është në thelb politike, duke kërkuar jo vetëm reforma institucionale, por edhe angazhim të qëndrueshëm nga të gjithë sektorët e shoqërisë për të mbështetur vlerat e demokracisë, sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut. Kjo qasje pjesëmarrëse është jetike: pa mbështetje të gjerë shoqërore, edhe reformat ligjore të projektuara mirë mund të mos zënë rrënjë në praktikë.

Në përgjithësi, raporti thekson progresin në fusha të caktuara, ndërsa identifikon progres të kufizuar ose fare progres në të tjera. Është shqetësuese që ne vazhdojmë të shohim një mospërputhje midis kornizës ligjore gjithëpërfshirëse, e cila kryesisht përputhet me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, dhe zbatimit të saj praktik. Kjo e thekson nevojën për mbështetje dhe këshilla të vazhdueshme për institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë për ta tejkaluar këtë mospërputhje dhe për të siguruar zbatim efektiv dhe të përgjegjshëm.

Për më tepër, është thelbësore që qeveria e Kosovës të vazhdojë ta ketë prioritet luftën kundër korrupsionit, mbrojtjen e grupeve të cenueshme dhe zbatimin e të drejtave të njeriut, veçanërisht në fushat si dhuna në baza gjinore dhe krimet e luftës. Këto nuk janë thjesht çështje teknike, por janë thellësisht të ndërthurura me stabilitetin politik të Kosovës dhe me reputacionin e saj ndërkombëtar. Gjetjet e EULEX-it bëjnë të ditur se progresi në këto fusha nuk ka qenë i njëjlojtë dhe kjo duhet të interpretohet si rrezik strategjik për trajektoren evropiane të Kosovës.

EULEX-i vazhdon të jetë partner i palëkundur i Kosovës, ndërsa ky raport paraqitet si një shprehje e prekushtimit tonë të vazhdueshëm për ta mbështetur Kosovën dhe popullin e saj në rrugën e tyre drejt Bashkimit Evropian; por Kosova duhet të tregojë vullnet politik, pavarësi gjyqësore dhe angazhim aktiv me shoqërinë civile për ta ngushtuar hendekun ndërmjet standardeve ligjore dhe zbatimit të tyre në praktikën e përditshme. Aftësia për t'i shndërruar ligjet në drejtësi efektive dhe të drejtë nuk është vetëm një kriter për anëtarësim në BE, por një imperativ strategjik për stabilitetin afatgjatë, prosperitetin dhe qëndrueshmërinë demokratike të Kosovës. Është gjithashtu e rëndësishme të kujtojmë se anëtarësimi në BE nuk është vetëm përgjegjësi e institucioneve, por një proces i drejtuar nga të gjitha segmentet dhe sektorët e shoqërisë, siç shihet në të gjitha proceset e kaluara të anëtarësimit.

Në këtë sfond, ne kemi zgjedhur t'i ndajmë gjetjet dhe rekomandimet tona me publikun e gjerë, me shpresën se shumëkush në Kosovë do t'i konsiderojë ato informuese dhe frymëzuese.

Mangësitë e identifikuar në këtë raport që mbeten të pazgjidhura, si dhe sfidat e reja të vërejtura gjatë vitit aktual, do të vazhdojnë t'i udhëheqin aktivitetet tona monitoruese dhe këshilluese. Ato do të jenë në fokus të raportit të vitit të ardhshëm, duke siguruar llogaridhënie dhe progres të vazhdueshëm.

Si përfundim, ky raport shërben si një mjet diagnostikues dhe një udhërrëfyes. Fokusi strategjik tani duhet të zhvendoset drejt përshpejtimin të reformave, duke siguruar që institucionet e Kosovës të lëvizin përtej pajtueshmërisë së thjeshtë drejt transformimit të vërtetë dhe të qëndrueshëm në sektorin e drejtësisë. Kjo do të kërkojë jo vetëm mbështetje të jashtme, por një konsensus të brendshëm politik që e përfron të ardhmen e Kosovës me vlerat dhe parimet evropiane.

Sikurse me të gjitha raportet e mëparshme, edhe ky nuk do të ishte i mundur pa angazhimin dhe bashkëpunimin e institucioneve përkatëse të Kosovës, të cilëve u shpreh falënderimet e mija për bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm. Kam besim se Raporti ynë i shtatë i Monitorimit të Drejtësisë do të pritë në të njëjtën frymë konstruktive sikur edhe për raportet pararendëse.

**Giovanni Pietro Barbano**  
*Shefi i Misionit EULEX Kosovo*

# 1. Hyrje

Njësia për Monitorimin e Rasteve (NJMR) e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) e vlerëson funksionimin e Policisë së Kosovës dhe të gjyqësorit në aspektin e përmbushjes procedurale, ligjore dhe të drejtave të njeriut. Kjo përfshin të gjithë zinxhirin e drejtësisë penale (policinë, prokurorinë dhe gjykatat) si dhe aspekte të sistemit të drejtësisë civile. Ky është Raporti i katërt i Monitorimit të Drejtësisë i përgatitur nga EULEX-i dhe i vënë në dispozicion për publikun e gjerë.

Raportet e mëparshme të Monitorimit të Drejtësisë, të publikuara në 2020, 2021 dhe 2022, vlerësuan aspekte specifike të funksionimit të gjithë zinxhirit të drejtësisë penale dhe civile, duke ndërthurur një perspektivë sistemike dhe tematike. Krahas gjetjeve të monitorimit, këto raporte japin rekomandime të shumta për institucionet përkatëse të sundimit të ligjit në Kosovë që synojnë t'u ndihmojnë atyre në arritjen e përputhshmërisë më të mirë me ligjin e Kosovës dhe standardet e të drejtave të njeriut.

Për ta përcjellë progresin e arritur nga institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë, ky Raport i Monitorimit të Drejtësisë vlerëson se deri në çfarë mase janë zbatuar disa nga rekomandimet e mëparshme. Ai nuk mbulon të gjitha çështjet sistemike dhe tematike të monitoruara nga EULEX-i, por vetëm një përzgjedhje të tyre.

Bazuar kryesisht në monitorimin e rasteve të përzgjedhura, EULEX-i e ka vlerësuar zbatimin e shumë prej rekomandimeve që synojnë adresimin e shqetësimeve sistemike të identifikuara në seksionin e titulluar 'Gjetjet nga monitorimi sistemik'. Në mënyrë të ngjashme, përmes monitorimit të trajtimit të llojeve të veçanta të veprave penale, si korrupsioni, dhuna në baza gjinore dhe krimet sipas së drejtës ndërkombëtare, EULEX-i i vlerësoi shumë nga rekomandimet e parashtruara më parë në lidhje me fusha specifike tematike, në seksionin e titulluar 'Gjetjet e Monitorimit Tematik'.

Gjithashtu, rekomandimet e bëra për tema të tjera, si trajtimi i rasteve civile lidhur me kontestet pronësore, aplikimi i masave të diversitetit ndaj të miturve në rastet penale dhe funksionimi i Sistemit Informativ për Menaxhimin e Lëndëve, janë vlerësuar edhe për këtë raport dhe mund t'i gjeni në seksionin e titulluar 'Gjetjet nga monitorimi tematik'.

Gjetjet dhe rekomandimet e përfshira në këtë raport bazohen në monitorimin e mbi 300 rasteve, si dhe në të dhënat dhe informacionet e marra nga institucionet përkatëse dhe nga konsultimet me policinë, prokurorinë, zyrtarët e drejtësisë, anëtarët e odave të avokatëve dhe shoqërisë civile.

Si pikënisje, shumë nga gjetjet i referohen periudhës shtator 2022 deri në shtator 2023; megjithatë, raporti mbulon gjithashtu zhvillimet që kanë ndodhur para ose pas kësaj periudhe kohore, deri në mesin e vitit 2024, në varësi të kohës kur janë nxjerrë rekomandimet përkatëse dhe të rëndësisë së tyre, siç është thënë në secilin kapitull.

Një pasqyrë me detaje shtesë të gjitha rasteve gjyqësore të përmendura dhe të referuara në këtë raport është dhënë në shtojcën e rasteve.

## 2. Gjetjet nga monitorimi sistematik

### 2.1. Trajtimi i rasteve të ‘profilit të lartë’ dhe ish-rasteve të EULEX-it nga gjyqësori i Kosovës

#### Sfondi

Për qëllime të monitorimit, EULEX-i e përkufizon një rast ‘të profilit të lartë’ si një rast në të cilin të pandehurit kishin pozita të larta politike ose administrative, akuzat e ngritura kundër tyre kishin të bënin me grupe të mëdha, të organizuara, vepra të rënda penale dhe dëme me vlera të larta, si dhe rastet e trajtuara më parë nga EULEX-i të cilat janë ende në proces (aktualisht, EULEX-i është duke monitoruar një numër të përgjithshëm prej 49 rastesh të profilin të lartë). Veprat kryesore penale kanë të bëjnë me krimin e organizuar, korrupsionin e nivelit të lartë dhe krimet e dhunshme.

Në të gjitha raportet e tij të mëparshme të monitorimit të drejtësisë, EULEX-i raportoi se një numër i konsiderueshëm i rasteve të profilin të lartë kishin treguar progres të ngadaltë si gjatë hetimeve ashtu edhe gjatë procedurave gjyqësore, ndonjëherë duke përfshirë rigjykime të përsëritura që i kanë vonuar më tej gjykimet. Gjykimi i çështjeve pa vonesa të panevojshme është thelbësor në çdo sistem efikas të drejtësisë. Rastet e profilin të lartë tërheqin interes të gjerë publik dhe dukshmëri të lartë duke pasur parasysh faktin se autorët janë shpesh persona të njohur ose që akuzohen për krime shumë të rënda. Prandaj, është me interes të veçantë që këto raste të trajtohen me kohë dhe në mënyrë efektive, pasi që ato ndikojnë në besueshmërinë e sistemit të drejtësisë në tërësi dhe formësojnë besimin e publikut tek gjyqësori.

#### Rekomandimet e dhëna nga EULEX-i

- ✓ Gjykatat duhet të sigurojnë që gjykimet të mos vonohen në mënyrë të padrejtë, gjë që paraqet shqetësim specifik në lidhje me shumë raste të profilin të lartë, gjithashtu për të shmangur përshtypjen se gjyqësori i Kosovës nuk ishte plotësisht gati apo i gatshëm për t’i gjykuar këto raste.
- ✓ Prokuroritë dhe gjykatat duhet të monitorojnë në mënyrë më sistematike procedimin e rasteve të profilin të lartë, t’i bëjnë të ditura procedurat jashtëzakonisht të gjata dhe rigjykimet e përsëritura, t’i identifikojnë shkaqet e këtyre vonesave dhe t’i korrigjojnë ato.
- ✓ Gjyqësori i Kosovës duhet t’i jep prioritet rasteve që tërheqin interes të konsiderueshëm publik dhe mediatik, si dhe rastet që përfshijnë korrupsion të nivelit të lartë dhe politikanë apo figura të tjera publike, në përputhje me *Planin Strategjik të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022-2024*<sup>1</sup>.

#### Zbatimi

*Plani Strategjik i KGJK-së për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022-2024* i përcakton objektivat dhe veprimet për gjyqësorin për ta përmirësuar efikasitetin në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Që nga viti 2022, është vërejtur progres i caktuar në trajtimin e disa rasteve të profilin të lartë, përfshirë rastet e mëparshme të EULEX-it ku seancat u caktuan sërish pas pandemisë me COVID-19. Një aspekt specifik i përmirësimit ishte rritja e shfrytëzimit të seancave të njëpasnjëshme në rastet e korrupsionit dhe të profilin të lartë (shih Kapitullin 2.11. ‘Organizimi i seancave gjyqësore’), në përputhje me dispozitat e përshkruara në Planin Strategjik të lartpërmendur.

<sup>1</sup> *Plani strategjik i KGJK-së për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022-2024*, [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/44297\\_Vendimi\\_KGJK\\_se\\_Nr\\_292\\_2021\\_Miratohet\\_Plani\\_Strategjik\\_per\\_Zgjidhjen\\_Efikase\\_te\\_Lendëve\\_te\\_Korrupsionit\\_dhe\\_Krimit\\_te\\_Organizuar\\_2022-2024.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/44297_Vendimi_KGJK_se_Nr_292_2021_Miratohet_Plani_Strategjik_per_Zgjidhjen_Efikase_te_Lendëve_te_Korrupsionit_dhe_Krimit_te_Organizuar_2022-2024.pdf), uebsajti i KGJK vetëm në versionin shqip, KGJK, tetor 2021, (qasur më 3 tetor 2022).

Progres i caktuar është identifikuar në një numër të rasteve të profilit të lartë, ku disa prej tyre e rifituan ritmin pasi ishin në gjendje pasive për një periudhë të gjatë kohore kurse disa të tjera u gjykuan.

Një numër i konsiderueshëm i rasteve përfunduan me lirim nga akuza, ndonëse paraprakisht ishin shqiptuar dënimet në gjykimet fillestare, ndërsa rastet e tjera janë ende në proces për disa vite, pa aktgjykim të formës së prerë.

Më poshtë janë dhënë disa raste përkatëse të profilit të lartë, për ta analizuar progresin e tyre, apo mungesën e tij, në periudhën pas shtatorit 2022.

### **Rastet e profilit të lartë me progres të caktuar, që e kanë rimarrë ritmin ose janë duke u gjykuar**

Në ish rastin e EULEX-it *Olympia*, Gjykata Themelore e dënoi njërin nga dy të pandehurit me tetë vjet burgim, ndërsa tjetri u lirua nga akuza. Ata u akuzuan për vrasjen e një zyrtari të UNMIK-ut dhe një zyrtari të Policisë së Kosovës (PK) në Podujevë. Aktgjykimi u shpall 19 vjet pas kryerjes së veprës dhe gjashtë vjet pas ngritjes së aktakuzës.

Në rastin e vrasjes së *Oliver Ivanoviqit*, drejtues i 'Iniciativës Qytetare Serbia, Demokracia, Drejtësia', të kryer në vitin 2018, aktakuza është ngritur në dhjetor 2020, ndërsa shqyrtimi kryesor ka filluar më 6 korrik 2021. Seancat e rregullta janë caktuar që kur ka filluar shqyrtimi kryesor, por një numër i konsiderueshëm i tyre ishin joproductive ose u anuluan. Aktgjykimi është shpallur në Gjykatën Themelore (GJTH) të Prishtinës më 28 qershor 2024. Katër nga gjashtë të pandehurit janë shpallur fajtorë.

Në rigjykimin e dytë të *rastit Sekiraga*, i pandehuri është dënuar nga gjykata themelore më 3 maj 2024 dhe i është shqiptuar dënimi prej 25 vjet burgim për vrasjen e një polici. Vepra ka ndodhur 17 vite më parë, ndërsa aktakuza është ngritur nga EULEX-i dhjetë vjet më parë. Me shpalljen e aktgjykimit nga gjykata themelore, gjyqtari i hoqi të pandehurit masën e arrestit shtëpiak, e cila rezultoi me suspendimin e këtij gjyqtari nga KGJK-ja. Gjykata e Apelit (GJA) më pas e ndryshoi masën në paraburgim, por i pandehuri nuk mund të gjendej më nga PK-ja.

Në *Rastin e të dëbuarve turq*, i cili ngriti shqetësime të mëdha për të drejtat e njeriut, Gjykatën Themelore të Prishtinës e dënoi ish-Drejtorin e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar me katër vjet e tetë muaj burgim. Të pandehurit e tjerë u liruan nga akuza. Vendimi u nxor më 19 korrik 2023, pothuajse dy vjet pas aktakuzës dhe pesë vjet pas deportimit të gjashtë shtetasve turq nga Kosova në Turqi në bazë të kërkesës së autoriteteve turke.

Në rastin "*Syri i Popullit*", aktakuza është ngritur në vitin 2018, me akuzën e përgatitjes së veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë. Aktgjykimi u shpall në nëntor 2022. Një i pandehur u dënuar me katër vjet burgim, ndërsa tjetri u lirua nga akuza.

Në rastin e gjyqtarit Sali Berisha, Gjykata Themelore e Pejës e dënoi atë, më 28 prill 2023, me dy vjet e gjysmë burgim për marrje ryshfeti dhe mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, në bazë të një aktakuze të vitit 2020. Përveç kësaj, ai mori një dënim plotësues që ia ndalon ushtrimin e funksioneve të administratës publike për tre vjet. Më 29 shkurt 2024, GJA e konfirmoi vendimin për fajësinë, por e uli dënimin në dy vjet burgim.

Rigjykimi i *Rastit 3%* u finalizua gjithashtu. Aktakuza është ngritur në vitin 2017 kundër tre të pandehurve të cilët dyshohet se kanë përvetësuar para në lidhje me 'kontributet e 3%' (kontribut vullnetar, kryesisht me origjinë nga diaspora, në mbështetje të Kosovës gjatë viteve 1990) gjatë periudhës 2006-2015. Më 19 dhjetor 2023, GJA e konfirmoi vendimin e shkallës së parë për fajësinë të datës 13 korrik 2023, por e uli dënimin me burg nga tre vjet në 18 muaj dhe shqiptoi një gjobë prej 3,500 Euro. Përfundimisht, më 30 maj 2024, Gjykata Supreme (GJS)

vendosi se veprat penale kishin arritur parashkrimin absolut më 20 maj 2022. Prandaj, të pandehurit në fund nuk u dënuan.

Aktgjykimi është nxjerrë edhe për *rastin Autostrada drejt Shkupit*, në të cilin është ngritur aktakuza më 4 shkurt 2022 kundër ish-Ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj dhe tre të pandehurve të tjerë për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar. Më 31 janar 2024, të katër të pandehurit u dënuan në shkallën e parë me burgim ndërmjet tre vjet e tetë muaj dhe një vit e tetë muaj.

### Rastet e profilit të lartë të gjykuara me lirim nga akuza

Në ish *rastin e EULEX-it City Club*, aktakuza është ngritur në vitin 2017 kundër një të pandehuri të akuzuar se, në janar 2010 në City Club në Pejë, e ka vrarë një person dhe i ka plagosur dy të tjerë. Më 30 nëntor 2023, në rigjykimin e dytë, gjykata e shpalli të pafajshëm të pandehurin pas shtatë vjetësh në paraburgim dhe dy dënimeve paraprake nga Gjykata Themelore e Pejës. Trajtimi joefektiv i rastit ka rezultuar me qëndrimin e të pandehurit në paraburgim për shtatë vjet para se të shpallej i pafajshëm.

Në *Rastin Autostrada e Gjilanit*, në të cilin katër zyrtarë të Ministrisë së Infrastrukturës u paditën në shkurt 2021 me disa akuza si ushtrim të ndikimit, keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe pastrim parash, të gjithë ata u liruan nga akuza me aktgjykimin e shkallës së parë më 7 maj 2024.

Në ish rastin e EULEX-i *Medicus*, ku aktakuzat u ngritën në vitin 2020, Gjykata Themelore e Prizrenit i liroi nga akuza të dy të pandehurit në rigjykimin e dytë në qershor të vitit 2023, edhe pse ata ishin shpallur fajtorë më parë, duke përfshirë edhe nga ish-trupat gjykues të EULEX-it. Vendimi për ankesën është ende në pritje.

Ish *rasti i EULEX-it Grande I* përfundoi me lirim nga akuza në tetor 2023 në Gjykatën Themelore të Prishtinës për akuzat më të rënda pasi kishte qenë në sistemin gjyqësor që nga ngritja e aktakuzës në vitin 2016. Shembuj të tjerë të rasteve të profilit të lartë që përfunduan me lirim nga akuza janë rastet: *Rasti Naser Kelmendi* (pas nëntë vjetësh)<sup>2</sup>, *Olympus II* (pas shtatë vjetësh)<sup>3</sup>, *Infrakos* (pas tre vjetësh)<sup>4</sup> dhe *Hydrocentralet* (pas tre vjetësh)<sup>5</sup>.

### Rastet e profilit të lartë ende në proces pa progres të dukshëm

Një numër i konsiderueshëm i rasteve të profilit të lartë mbetën ende me ritme të ngadalta apo edhe pasive. Për shembull, *rasti Stenta III* ishte pasiv për ca kohë dhe megjithëse ka rritur ritmin kohët e fundit, progresi është ende i ngadaltë.

Në ish rastin e EULEX-it *Olympus I*, aktakuza është ngritur në vitin 2016 me akuzën për pronësi të paligjshme të tokës në pronësi shoqërore dhe pronave të tjera. Pas pandemisë me COVID-19, duke filluar nga mesi i vitit 2022, seancat u zhvilluan rregullisht në Gjykatën Themelore të Prishtinës deri më 11 maj 2023, por me ritëm shumë të ngadaltë në pjesën e dytë të vitit 2023. Disa seanca të njëpasnjëshme ishin caktuar në fillim të vitit 2024, por shumë prej tyre nuk ishin produktive dhe për këtë arsye gjykimi është ende në proces. Paraburgimi i zgjatur i dy prej të pandehurve për më shumë se shtatë vjet, respektivisht më shumë se dy vjet përpara se të liroheshin në arrest shtëpiak, i kombinuar me ecurinë e dobët të gjykimit, ngrit shqetësime

2 Aktakuza në këtë rast është ngritur në korrik të vitit 2014, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është shpallur në tetor të vitit 2023.

3 Aktakuzat në këtë rast janë ngritur në tetor të vitit 2016, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është shpallur në shtator të vitit 2023.

4 Aktakuza për këtë rast është ngritur në dhjetor të vitit 2019, ndërsa aktgjykimi i GJTH-së së Prishtinës është shpallur në janar të vitit 2023.

5 Aktakuza në këtë rast është ngritur në prill të vitit 2020, ndërsa aktgjykimi i gjykatës themelore është shpallur në nëntor të vitit 2023.



serioze në lidhje me të drejtën për liri, të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe prezumimin e pafajësisë së të pandehurve.

*Rasti i Veteranëve* është ende në proces, gjashtë vjet pas ngritjes së aktakuzës. Pas pesë tentativave të dështuara, seanca e parë e rigjyimit u zhvillua më 31 tetor 2023, pas anulimit nga ana e GJA të aktgjyimit për lirim nga akuza të nxjerrë në shkallë të parë për të dymbëdhjetë të pandehurit në mars 2022. Gjykimi është ende në proces.

Ish *rasti i EULEX-it Toka 4*, në të cilin një grup i madh i të pandehurve akuzohet për pronësi të paligjshme të tokës në pronësi shoqërore, dhe i cili lidhet me rastet e mëparshme të EULEX-it *Olympus I* dhe *Olympus II*, është një shembull tjetër i një rasti të profilit të lartë i cili ishte pasiv prej vitesh, pa seanca produktive në periudhën 2019-2022. Gjykimi rifilloi në fund të vitit 2022 dhe shënoi seanca produktive gjatë vitit 2023, edhe pse me një ritëm të ngadaltë. Rasti është ende në pritje, tetë vjet pas ngritjes së aktakuzës nga prokurorët e EULEX-it më 3 mars 2016.

Rastet e tjera të profilit të lartë vazhdojnë të ngecin për shkak të procedurave joefikase. Për shembull, *Rasti Avanci*, në të cilin në vitin 2020 u paditën dy zyrtarë të punësuar në Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale dhe në Ministrinë e Shëndetësisë për përvetësim në detyrë dhe ndërhyrje në sistemet kompjuterike është larg përfundimit, pavarësisht faktit se u zhvilluan seanca të shumta gjyqësore.

Në mënyrë të ngjashme, rigjykimi në *Rastin Salih Qitaku dhe të tjerët* ka qenë pasiv që nga seanca fillestare e rigjyimit në korrik 2017. Aktakuza është ngritur në vitin 2014 kundër katër anëtarëve të dyshuar të një grupi të organizuar kriminal për organizimin e migrimit ilegal të banorëve të Kosovës drejt vendeve të Evropës Perëndimore.

Gjykimet në disa *Raste Brezovica* u përshkuan me një ritëm të ngadaltë. Në *Rastin Brezovica I*, bazuar në aktakuzën e datës 11 nëntor 2020 kundër 11 të pandehurve, pas përpjekjeve të shumta të pasuksesshme për gati dy vjet për ta mbajtur seancën fillestare, ajo u zhvillua vetëm në gusht të vitit 2023. Në *Rastin Brezovica II*, ku aktakuza ishte ngritur më 9 dhjetor 2022 kundër 12 të pandehurve, shqyrtimi fillestar u mbajt përfundimisht më 3 prill 2023. Mirëpo, fillimi i shqyrtimit gjyqësor është shtyrë disa herë.

Dy nga ish rastet e EULEX-it, të cilat patën pak ose aspak progres, përkundër aktakuzave të ngritura ndërmjet nëntë dhe shtatë viteve më parë, janë *Rasti Touareg* (aktakuza e ngritur në 2015) dhe *Rasti Transporti* (aktakuza e ngritur në 2016). Të dyja këto raste ishin transferuar nga Gjykata Themelore e Mitrovicës në Gjykatën Themelore të Prishtinës në shkurt të vitit 2024.

Rasti *Fahredin Gashi*, në të cilin aktakuza u ngrit në Gjykatën Themelore të Prishtinës më 5 nëntor 2010, pati ngecje për një periudhë të gjatë në pritje të kërkesës së kryetarit të trupit gjykues drejtuar KGJK-së lidhur me caktimin e një eksperti të huaj për ta vlerësuar të pandehurin.

Në ish *rastin e EULEX-it Bill Clinton II*, aktakuza u ngrit më 30 tetor 2019, pas së cilës nuk u shënua asnjë progres për gati katër vjet.

Për më tepër, hetimi në ish rastin e EULEX-it për vrasjen e pjesëtarit të EULEX-it Audrius Šenavičius në shtator 2013 (*Rasti Blu*), nuk pati asnjë zhvillim të ri që nga viti 2021.

## Konkluzione

Në trajtimin e rasteve të profilit të lartë është shënuar shumë pak progres. Një numër i konsiderueshëm i tyre nuk kanë pasur progres domethënës dhe kërkojnë veprime të mëtejshme pasi janë në proces për vite me radhë. Rastet e tjera të profilit të lartë përparuan dhe shpesh përfunduan me lirim nga akuza, duke përfshirë disa ish raste të EULEX-it. Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe KGJK duhet të ndjekin nga afër nëse rastet janë duke u gjykuar siç duhet bazuar në të drejtën procedurale dhe materiale dhe provave të administruara. Nëse identifikohen shqetësime, institucionet e përmendura duhet t'i shqyrtojnë shkaqet e ndarjes

së papërshtatshme të drejtësisë në rastet e profilit të lartë dhe të identifikojnë se ku mund të bëhen përmirësime në zinxhirin e drejtësisë penale. Rastet që i nënshtrohen zvarritjes së gjatë rrezikojnë të arrijnë parashkrimin, që do të thotë se ai rast nuk mund të gjykohej më. Kjo është veçanërisht shqetësuese në rastet e profilit të lartë<sup>6</sup> dhe duhet të adresohet siç duhet nga gjyqësori.

## 2.2. Produktiviteti i seancave gjyqësore

### Sfondi

EULEX-i vazhdoi ta përcjellë raportin e seancave produktive në rastet që i monitoron. Një seancë konsiderohet produktive kur mbahet siç është planifikuar dhe është bërë progres drejt gjykimit (p.sh. kur diskutohen provat materiale, merren në pyetje të pandehurit, palët e dëmtuara ose dëshmitarët, ose kur jepen fjalët hyrëse dhe përfundimtare). Një seancë është joproduktive kur fillon, por shtyhet pa ndonjë progres domethënës.

Seancat joproduktive shkaktojnë vonesa të pajustificuara procedurale, të cilat përbëjnë një barrë shtesë për sistemin e drejtësisë dhe, më e rëndësishmja, ndikojnë negativisht në të drejtën për një gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm të njohur nga Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). E njëjta gjë vlen edhe për seancat që anulohen me një njoftim shumë të vonshëm, shpesh pikërisht në ditën kur ishte planifikuar të zhvillohej seanca.

Monitorimi i EULEX-it ka vërejtur raporte të larta të seancave joproduktive, si dhe një trend të anulimit të seancave me një njoftim të vonshëm. Arsyet për të dyja janë të ngjashme, kryesisht mungesa e mbrojtësve, e të pandehurve apo e prokurorëve.

### Rekomandimet e dhëna nga EULEX-i

- ✓ Gjyqtarët duhet të jenë më të thuktë në verifikimin e arsyeve të mungesës së palëve dhe në zbatimin e masave ndëshkimore dhe disiplinore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale (KPP). Gjykatat duhet t'i mbajnë prokurorët përgjegjës për vonesat ose mungesat e pajustificuara duke e njoftuar Kryeprokurorin e prokurorisë përkatëse. Gjithashtu, gjykatat duhet të gjobisin avokatët mbrojtës për zvarritjen e procedurave dhe ta njoftojnë Odën e Avokatëve.
- ✓ Gjykatat duhet t'i japin përparësi rasteve të profilit të lartë dhe të shmangin vonesat e panevojshme procedurale.
- ✓ Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe kryetarët e gjykatave duhet të mbajnë shënim rastet kur nuk zbatohen masat ligjore dhe të mbajnë përgjegjës gjyqtarët përgjegjës.

### Zbatimi

Në periudhën shtator 2022 – maj 2024, EULEX-i i ka monitoruar gjithsej 821 seanca<sup>7</sup>, prej të cilave 230 (28%) kanë qenë pa ndonjë progres në gjykimin e rasteve (138 seanca joproduktive dhe 92 seanca të anuluar).


Duhet të kihet parasysh se para shtatorit të vitit 2022, EULEX-i nuk ka mbajtur shënim numrin e seancave të anuluar, por vetëm ato joproduktive. Në periudhën nga nëntori 2021 deri në gusht 2022, 26% e seancave të monitoruara nga EULEX-i ishin joproduktive, kurse në periudhën nga mesi i marsit 2020 deri në tetor 2020, 30% e seancave ishin joproduktive.

<sup>6</sup> Shih gjithashtu Raportin "Amnistia e kriminalitetit përmes parashkrimit" të Institutit të Kosovës për Drejtësi, në [Amnistia-i-kriminalitetit-permes-parashkrimit-2023-Pdf-anglisht.pdf \(kli-ks.org\)](#) (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

<sup>7</sup> Për qëllime të kësaj analize, shpalljet e aktgjykimeve, edhe pse në to kanë marrë pjesë monitoruesit e EULEX-it, nuk llogariten në numrin e përgjithshëm të seancave as nuk llogariten si seanca produktive. Pasi një shpallje e aktgjykimit është caktuar, ajo zakonisht ndodh dhe nuk mund të shënohet si produktive pasi kjo nuk është një *seancë dëgjimore në vetvete*.

Dy arsyt kryesore për seancat joproduktive ose të anuluar mbetën të pandryshuara në krahasim me periudhat e mëparshme: mungesa e të pandehurit ose kërkesa e tij/saj për shtyrjen e seancës pa ndonjë arsyetim të duhur (63 seanca, 27%), e ndjekur nga mungesa ose kërkesa e avokatit mbrojtës për ta shtyrë seancën (50 seanca, 22%), kryesisht duke pretenduar se u duhej më shumë kohë për përgatitjen e rastit ose për shkak se ishin të sëmurë. Mungesa në momentin e fundit e një (ose më shumë) gjyqtarëve të trupit gjykues ka shkaktuar shtyrjen e seancës në 23 raste (10%). Disa seanca u detyruan të shtyheshin për shkak të mospjesëmarrjes së prokurorëve në seanca ose kërkesës për shtyrje (22 seanca, 10%), mungesës së dëshmitarëve, ekspertëve apo palëve të tjera (21 seanca, 9%) dhe çështjeve të ndryshme të menaxhimit të gjykatës apo arsyeve të tjera (51 seanca, 22%).

### Arsyet e seancave joproduktive/të anuluar



Për më tepër, EULEX-i ka vërejtur se në shumë raste, arsyeja e mungesës së palëve në seancat joproduktive ose të anuluar ose nuk është dhënë, ose nuk është arsyetuar me prova me shkrim, aspekt që shpeshherë është injoruar nga gjykatat. Ky trend tashmë është vërejtur në periudhat e mëparshme.

KPP parashikon një sërë masash për të qortuar palët që vonojnë procedurat për shkak të mungesës së tyre të pajustificuar ose për arsye të tjera. Për shembull, mund të shqiptohen gjoba<sup>8</sup>, ndërsa në rastin e prokurorëve dhe mbrojtësve, Kryeprokurori<sup>9</sup> përkatësisht Oda e Avokatëve mund të njoftohen<sup>10</sup> për veprime të mëtejshme. Gjykatat zbatuan masa ndëshkuese ndaj palëve fajtoresh për vonesa të pajustificuara vetëm në pak raste. Për shembull, në një rast, kryetari i trupit gjykues njoftoi se për mungesën e prokurorit do të njoftohej Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë<sup>11</sup>. Në një rast tjetër të monitoruar<sup>12</sup>, kryetari i trupit gjykues i ka dënuar tre mbrojtës në seanca të ndryshme gjyqësore për shkak të mungesës së tyre, ndërsa në një tjetër, të dy mbrojtësit që munguan janë dënuar me gjobë nga 500 euro<sup>13</sup>. Në rastet e mungesës së pajustificuar të pandehurit, gjykata mund të shqiptojë dënime më të

8 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, neni 65, paragrafi 1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759> (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

9 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, neni 301, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759> (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

10 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, neni 65, paragrafi 2, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759> (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

11 Rasti Shantazhi (PAKR 58/15 – GJTH Prishtinë).

12 Rasti Dragan Jabllanović dhe tjerët (PPS 12/2016 – GJTH Prishtinë).

13 Rasti Olympus I (PKR 610/16 – GJTH Prishtinë).



ashpra, si p.sh. të urdhërojë arrestimin e tij<sup>14</sup>, masë e cila nuk është zbatuar kurrë. Megjithatë, ka pasur raste të rralla kur kryetari i trupit gjykues e ka përmendur praninë e detyrueshme në seancën vijuese të pandehurit që ka munguar, ose në të kundërtën do të urdhërohej arrestimi<sup>15</sup>. Nga gjithsej 821 seanca të monitoruara, 321 ishin për rastet e profilit të lartë<sup>16</sup>. Në këtë grup, 56 seanca (18%) ishin joproduktive dhe 52 (16%) u anuluan. Të dyja bashkë paraqesin një raport të lartë (34%) të seancave të cilat përfundojnë pa progres në gjykimin e rasteve. Kjo bie ndesh me Rekomandimet e dhëna nga EULEX-i se rastet e profilit të lartë duhet të gjykohen menjëherë për shkak të peshës së veprave apo profilit të pandehurve, siç është përshkruar në *Planin Strategjik të KGJK-së për zgjidhjen efikase të rasteve të korrupsionit dhe krimin të organizuar 2022-2024*.

Sipas informatave të marra nga KGJK më 12 shtator 2023, nuk mbahet shënim për rastet në të cilat janë aplikuar masa ndëshkimore. Megjithatë, në mesin e vitit 2024, KGJK-ja i konfirmoi EULEX-it se ishte duke u hartuar një rregullore për organizimin dhe veprimtarinë e brendshme të gjykatave, e cila potencialisht do të mund ta adresonte edhe këtë çështje.

### Konkluzione

Është bërë pak progres për ta rritur produktivitetin e seancave kurse raporti i seancave joproduktive dhe të anuluar mbetet i lartë. Për më tepër, gjykatat vazhdojnë të ngurrojnë kur bëhet fjalë për zbatimin e ndëshkimeve dhe masave të nevojshme për t'i penguar sjelljet që çojnë në vonesa të panevojshme. Duke marrë parasysh sa më sipër, EULEX-i përsërit rekomandimet e tij dhe u bën thirrje institucioneve përkatëse që ta trajtojnë këtë çështje si çështje urgjente, për shkak të ndikimit negativ në të drejtën për gjykim të drejtë, efikasitetin e procedurave dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor.

## 2.3. Funkcionimi i Departamentit Special në Gjykatën Themelore dhe Gjykatën e Apelit të Prishtinës

### Sfondi

Korniza ligjore për themelimin e Departamenteve Speciale është Ligji për Gjykatat<sup>17</sup>, i cili ka hyrë në fuqi në janar 2019. Ai e rregullon themelimin e Departamentit Special në Gjykatën Themelore (GJTH) të Prishtinës, i cili ka kompetencë t'i shqyrtojë rastet që janë nën juridiksionin e Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK), si dhe të Departamentit Special në Gjykatën e Apelit (GJA). Departamentet Speciale në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe në Gjykatën e Apelit janë funksionalizuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) më 1 korrik 2019 me gjashtë gjyqtarë përkatësisht tre gjyqtarë.

Raporti i EULEX-it i Monitorimit të Drejtësisë 2020 e përshëndeti krijimin e Departamenteve Speciale pasi pritej që ato të kishin një ndikim pozitiv në efikasitetin dhe cilësinë e sistemit gjyqësor. Këto dy Departamente Speciale i trajtojnë ekskluzivisht rastet nën juridiksionin e PSRK-së, që kanë të bëjnë me veprat më të rënda penale. Sfidat e vërejtura ose të parapara në atë raport e pasqyronin shqetësimin e EULEX-it se këto departamente kishin mungesë të personelit sa i përket gjyqtarëve, asistentëve mbështetës, bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjorë.

14 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, neni 302, paragrafi 1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759> (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

15 Rasti Olympus I (PKR 610/16 – BC Prishtinë).

16 Për përkufizimin e "rasteve të profilit të lartë", shihni Kapitullin 2.1.

17 Ligji për Gjykatat Nr. 06/L - 054

## Rekomandimet e dhëna nga EULEX-i

- ✓ Rritja e numrit të gjyqtarëve në Departamentin Special në shkallë të parë dhe në nivelin e apelit në përputhje me dispozitat ligjore për diversitetin etnik siç parashihet në ligj<sup>18</sup> dhe në *Rregulloren për Organizimin dhe Funkcionimin e Departamentit Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe në Gjykatën e Apelit*.
- ✓ Rekrutimi staf shtesë mbështetës, si bashkëpunëtorë profesionalë dhe zyrtarë ligjorë.
- ✓ Instalimi i pajisjeve të nevojshme në Pallatin e Drejtësisë në Prishtinë për të mundësuar marrjen në pyetje të dëshmitarëve nën masat mbrojtëse.
- ✓ Rritja e numrit të përkthyesve për gjuhën shqipe/serbe.

## Zbatimi

Në janar të vitit 2021, Departamenti Special në GJTH të Prishtinës i kishte 12 gjyqtarë kurse Departamenti Special në GJA i kishte gjashtë gjyqtarë. Megjithatë, në vitin 2023, në Departamentin Special në GJTH të Prishtinës ky numër u zvogëluar në dhjetë gjyqtarë ndërsa në GJA ra në katër. Më vonë atë vit, numri i gjyqtarëve u rrit në 11 në GJTH, ndërsa GJA i kishte ende katër, duke i lënë të dy departamentet me mungesë të stafit.

Po ashtu, KGJK-ja autorizoi kryetarët e gjykatave (GJTH dhe GJA) që të ndërmerrnin të gjitha veprimet e nevojshme për ricaktimin e stafit profesional dhe ndihmës në Departamentin Special kurdo që të ishte e nevojshme. Më 16 qershor 2023, KGJK publikoi tre konkurse për gjyqtarë në Departamentin Special, një në GJTH dhe dy në GJA. Këto vende të lira më pas u plotësuan.

Në korrik të vitit 2022, KGJK-ja vendosi të emërojë gjashtë bashkëpunëtorë profesionalë dhe 11 zyrtarë ligjorë në Departamentin Special në GJTH të Prishtinës.

Ekspertët e EULEX-it i studiuuan statistikat e KGJK-së, siç janë paraqitur në tabelat e mëposhtme, në mënyrë që ta përcaktojnë shkallën në të cilën rritja e numrit të gjyqtarëve dhe stafit mbështetës në këto departamente ka kontribuar në rritjen e efikasitetit dhe rezultatit të tyre. Të dhënat e efikasitetit janë të bazuara në vlerësimet mesatare të standardizuara të kohës së nevojitur për gjykime e cila llogaritet përmes krahasimit të numrit të rasteve të pranuar me numrin e rasteve të gjykuara çdo vit, pa i marrë parasysh rastet e trashëguara nga viti i mëparshëm dhe as ato që nuk janë përfunduar dhe janë bartur në vitin vijues. E llogaritur në këtë mënyrë, një nivel i efikasitetit prej më pak se 100% do të thotë se numri i rasteve të pazgjdhura është rritur. Duhet të theksohet se këto të dhëna, duke përfshirë sistemin e përcaktimit të nivelit të efikasitetit, burojnë nga KGJK-ja dhe nuk kanë mundur të verifikohen nga EULEX-i.

<b>Rastet e pranuar dhe të gjykuara nga Departamenti Special në GJTH të Prishtinës – Shqyrtimi kryesor</b>			
	<i>2021</i>	<i>2022</i>	<i>2023</i>
Rastet e pranuar	72	81	82
Rastet në pritje nga periudha e mëparshme	66	82	103
I gjykuar (i përfunduar)	37	42	60
Në pritje (u bart në vitin e ardhshëm)	101	121	125
Efikasiteti	51%	52%	73%

<b>Rastet e pranuar dhe të gjykuara nga Departamenti Special në Gjykatën e Apelit – Shqyrtimi kryesor</b>			
	2021	2022	2023
Rastet e pranuar	36	50	55
Rastet në pritje nga periudha e mëparshme	5	5	12
I gjykuar (i përfunduar)	36	43	57
Në pritje (u bart në vitin e ardhshëm)	5	12	10
Efikasiteti	100%	86%	104%

Këto shifra tregojnë një numër të përgjithshëm në rritje të rasteve të bartura në vitin vijues në të dy Departamentet Speciale, përkundër rritjes së përgjithshme të rasteve të gjykuara për çdo vit. Në Departamentin Special të Gjykatës Themelore të Prishtinës, këta numra janë rritur vazhdimisht, gjë që tregon për pamundësinë e kolegjeve që të merren me caktimin e shtuar të lëndëve, veçanërisht në fazën e shqyrtimit kryesor. Departamenti Special në GJA nuk e pati të njëjtën rritje të rasteve si në GJTH, por pati një rritje të dukshme nga viti 2021 në 2023 të rasteve të bartura në vitin e ardhshëm në fazën e shqyrtimit kryesor. Si përfundim, për shkak të rritjes së vazhdueshme të vëllimit të rasteve të caktuara për çdo vit, duket se edhe struktura aktuale e Departamenteve Speciale mund të rezultojë e pamjaftueshme për trajtimin e ngarkesës aktuale dhe të pritshme të rasteve në të ardhmen.

Raporti i Monitorimit të Drejtësisë 2020 i EULEX-it përfshinte një rekomandim për instalimin e pajisjeve të nevojshme për të mundësuar marrjen në pyetje të dëshmitarëve nën masa mbrojtëse në GJTH të Prishtinës. Aktualisht, një projekt për instalimin e pajisjeve të regjistrimit me video dhe audio është në fazën përfundimtare të realizimit të tij, përfshirë pajisjet për marrjen në pyetje të dëshmitarëve nën masa mbrojtëse.

Lidhur me rekomandimin për rritjen e numrit të përkthyesve për gjuhën shqipe/serbe, EULEX-i konstatoi se numri aktual i përkthyesve të punësuar në Departamentet Speciale ishte i mjaftueshëm. Me sa u tha, monitorimi i EULEX-it vërejti se përkthimet e dokumenteve gjyqësore në gjuhën serbe shpesh vonoheshin, çështje kjo e cila duhet të adresohet.

## Konkluzione

Që nga viti 2021, rritja e vëllimit të punës së Departamenteve Speciale, së bashku me një ulje, në vitin 2023, të numrit të gjyqtarëve për të dyja gjykatat (GJTH dhe GJA), rezultoi në një rritje të vazhdueshme të numrit të rasteve të pazgjidhura në fazën e shqyrtimit kryesor që u transferuan nga një vit në tjetrin. Megjithatë, bazuar në monitorimin e EULEX-it të disa rasteve të gjykuara në Departamentin Special në GJTH të Prishtinës, një faktor shtesë i cili ka kontribuar po ashtu në këtë rritje të numrit të rasteve të pazgjidhura është se disa raste të gjykuara në Departamentin Special në GJTH të Prishtinës nuk u trajtuan në mënyrë efikase. EULEX-i vërejti një ritëm të përgjithshëm të ngadaltë në procedura, që është rezultat i një numri të madh të seancave joproductive dhe pauzave të gjata ndërmjet seancave gjyqësore. Disa nga këto raste përfshijnë rastin e vrasjes së Oliver Ivanoviqit dhe disa ish raste të tjera të EULEX-it të profilit të lartë, të cilat janë ende në pritje në Departamentin Special në GJTH të Prishtinës, pra më shumë se gjashtë vjet pasi janë transferuar në drejtësinë e Kosovës. Shembuj të këtillë janë *Rasti Toka 4*, *Rasti Fahredin Gashi* dhe *Rasti Bill Clinton*, siç u theksua edhe në seksionin e mëparshëm.

## 2.4. Politika e rigjyimit brenda sistemit të drejtësisë së Kosovës

### Sfondi

Raporti i EULEX-it për Monitorimin e Drejtësisë 2020 ka ngritur çështjen e praktikës së zakonshme në Gjykatën e Apelit (GJA) për dërgimin e një përqindje të lartë të rasteve në gjykatën themelore përkatëse për rigjykim, pavarësisht parimit të përgjithshëm ligjor që instrumenti i rigjyimit duhet të urdhërohet vetëm në raste të jashtëzakonshme. Kjo praktikë është shqetësuese pasi e pengon të drejtën e të akuzuarit për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe i ngarkon gjykatat themelore, të cilat tashmë përballen me një numër të konsiderueshëm të rasteve të pazgjdhura. Për më tepër, rigjykimet e shumta shpesh rezultojnë në periudha jashtëzakonisht të gjata të paraburgimit.

### Rekomandimet e dhëna nga EULEX-i

- ✓ Gjykata e Apelit duhet të shfrytëzojë më mirë mundësinë e dhënë nga Kodi i Procedurës Penale (KPP) për të mbajtur seanca, për të marrë prova të reja apo për të konfirmuar provat ekzistuese, me qëllim të përcaktimit dhe vlerësimit të duhur të fakteve materiale, me qëllim shmangien e anulimit të panevojshëm të aktgjyqimeve dhe kthimit të rasteve në rigjykim.
- ✓ Drafti i ri i KPP-së e përkufizon procedurën e rigjyimit si diçka e jashtëzakonshme, që duhet të përdoret vetëm në raste specifike. Kjo duhet të jetë nxitje shtesë për gjykatat e apelit që ato të përmbahen nga kthimi i panevojshëm i rasteve në rigjykim.
- ✓ Cilësia e aktgjyqimeve duhet të përmirësohet, me fokus specifik në nevojën për harmonizim më të mirë të dispozitivëve dhe pjesës së arsytimit të aktgjyqimeve.

### Zbatimi

KPP i ndryshuar, i cili hyri në fuqi më 17 shkurt 2022, prezantoi një dispozitë të re që synon adresimin e shqetësimit të lartpërmendur. Ajo parashikon se një rigjykim mund të urdhërohet nga GJA në raste të jashtëzakonshme, kur ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale ose nëse është e nevojshme për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, kurse GJA vlerëson se nuk mund ta modifikojë aktgjykimin<sup>19</sup>. Këto dispozita e kanë potencialin për t'i përmirësuar ndjeshëm procedurat gjyqësore, duke mbrojtur njëkohësisht nga manipulimi i fakteve dhe nxjerrja e aktgjyqimeve të padrejta. Për më tepër, në rastet që marrin vëmendjen e publikut, gjykimet e vonuara mund ta zbehin interesin e publikut dhe dispozita e re mund ta zbusë rrezikun e përdorimit të procedurave të rigjyimit për këtë qëllim. Fakti që KPP i ndryshuar e përcakton procedurën e rigjyimit si një procedurë të jashtëzakonshme, e cila do të përdoret vetëm në raste të veçanta, duhet të jetë një nxitje e mëtejshme për gjykatat e apelit që të përmbahen nga kthimi i rasteve në rigjykim.

Tabela e mëposhtme bazohet në statistikat e dhëna EULEX-it nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK). Të dhënat tregojnë numrin e rasteve që GJA i ktheu në gjykatat themelore për rigjykim, të zbrëthyer sipas departamenteve të gjykatës, në vitin 2022 dhe 2023.

<sup>19</sup> Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, nenet 402 dhe 403 të <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759> (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

Departamenti	Rastet që u kthyen për rigjykim		Rastet e gjykuara		% e rasteve të kthyera për rigjykim		
	2022	2023	2022	2023	2022	2023	
Departamenti special	9	8	43	56	21%	14%	↓
Departamenti i Krimeve të Rënda	98	89	653	663	15%	13%	↓
Penal për të Mitur	8	11	131	142	6%	8%	↑
Penal i Përgjithshëm	135	122	1684	1718	8%	7%	↓

Edhe pse tre nga katër departamentet e përmendura në tabelën e mësipërme shënuan ulje të përqindjes së rasteve të kthyera për rigjykim, të dhënat tregojnë se dispozitat e reja ligjore në KPP në lidhje me kushtet në të cilat mund të urdhërohet rigjykimi nuk çuan në një ulje domethënëse të numrit të rasteve të kthyera në gjykatat themelore për rigjykim.

### Konkluzione

Me përjashtim të Departamentit për të Mitur, pjesa tjetër e Departamenteve të Gjykatave shënuan rënie të përqindjes së rasteve të kthyera për rigjykim në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022. Përkundër kësaj, progresi ishte shumë larg pritjeve dhe rekomandimet e EULEX-it në këtë drejtim nuk janë zbatuar.

## 2.5. Caktimi i rasteve në procedurën e rigjykimit

### Sfondi

Raporti i Monitorimit të Drejtësisë i EULEX-it 2020 theksoi se praktika e gjykatave në lidhje me caktimin e rasteve të cilat i ishin kthyer për rigjykim të njëjtit trup gjykues që e kishte gjykuar rastin në shkallë të parë mund të ngrejë disa polemika. Raporti identifikoi një aspekt pozitiv të kësaj praktike: procedurat e rigjykimit ishin dukshëm më efikase kur gjykata është e familjarizuar me rastin. Nga ana tjetër, gjyqtarët që duhet ta gjykojnë sërish të njëjtin rast, bazuar në të njëjtat prova faktike ose vetëm pak të ndryshuara, shpesh përballen me një dilemë etike. Për më tepër, kjo situatë mund të ngrejë shqetësime në lidhje me paanshmërinë e tyre.

Në jurisprudencën e saj për nenin 6 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), e cila është veçanërisht e rëndësishme për një vlerësim të kësaj praktike kundrejt standardeve të drejtave të njeriut, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) këshillon kundër caktimit të rasteve brenda një gjykate të bazuar në kritere subjektive në vend të kritereve objektive, të paracaktuara. Siç përmendet në Raportin e Monitorimit të Drejtësisë të EULEX-it 2020, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, mungesa e paansisë gjyqësore mund të lindë kur një gjyqtar tashmë e ka shprehur një mendim për fajësinë e të akuzuarit<sup>20</sup>.

<sup>20</sup> Gómes de Liaño y Botella kundër Spanjës, §§ 67-72.



## Rekomandimi i dhënë nga EULEX-i

- ✓ Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) duhet ta vlerësojë praktikën aktuale gjyqësore dhe implikimet e saj dhe nëse konsiderohet e duhur, të vendos që ta nxjerrë një vendim ose interpretim udhëzues, ose përndryshe të ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore me qëllim që të sigurojë një interpretim dhe zbatim konsistent të dispozitave përkatëse, për të siguruar që të ruhet dhe konsolidohet paanshmëria dhe pavarësia e gjyqësorit.

## Zbatimi

Dispozitat e neneve 38 dhe 39 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) synojnë të sigurojnë një qasje të re, objektive dhe të paanshme ndaj një procedure gjyqësore që u konstatua me të meta nga shkalla e apelit. Në praktikë, rastet kthehen në rigjykim manualisht dhe jo përmes Sistemit Informativ për Menaxhimin e Lëndëve (SIML)<sup>21</sup> tek të njëjtët gjyqtarë ose trupa gjykues që e kishin gjykuar rastin fillimisht. Praktika aktuale gjyqësore nuk e respekton dispozitën e caktimit të rasteve përmes SIML-së. SIML ka një vegël për caktimin automatik të rasteve e cila përdoret për të siguruar shpërndarjen e rastësishme të rasteve gjyqësore. Përdorimi i kësaj vegle do të siguronte që një rast i kthyer në gjykatën themelore për rigjykim nuk do t'i caktohej të njëjtit trup gjykues ose gjyqtari që e kishte gjykuar rastin në shkallë të parë. Kjo gjithashtu do ta rriste objektivitetin e perceptuar të gjykatës në lidhje me rastin e kthyer. Praktika aktuale e caktimit manual është shkelje e dispozitave të nenit 38, paragrafi 2 i KPP-së, i cili ia ndalon gjyqtarit që të shërbejë si kryetar i trupit gjykues, gjyqtar individual ose anëtar i trupit gjykues, nëse ai kishte marrë pjesë në procedurat e mëparshme për rastin penal të njëjtë.

Gjatë dokumentimit të praktikës aktuale të gjykatave themelore dhe pyetjes nëse është marrë parasysh rekomandimi i bërë në raportin e mëparshëm, EULEX-i ka mbajtur takime me shkrimoret në gjykatat themelore dhe me Departamentin Ligjor të KGJK-së. Koncepti i përgjithshëm i aplikuar në shkrimoret dhe në Departamentin Ligjor të KGJK-së është se dispozitat e nenit 38, paragrafi 2 i KPP-së nuk zbatohen për situatën në të cilën rastet kthehen në gjykatat themelore për rigjykim, me arsyetimin se praktika e caktimit të i njëjti trup gjykues ishte më efikase për gjykatat pasi kursente kohë dhe burime. Homologët e EULEX-it ishin të mendimit se, gjatë gjykimit në rigjykim, trupi gjykues duhet të merret vetëm me udhëzimet e gjykatës së apelit, pasi ai ishte tashmë i njohur me rastin, dhe se nuk do të ndikohej nga aktgjykimi i tij i mëparshëm. Për më tepër, neni 402 i KPP e cilëson praktikën e rigjykimit si të jashtëzakonshme, e cila duhet ta kishte ulur vëllimin e rasteve që prekeshin nga kjo procedurë. Megjithatë, siç është theksuar në kapitullin 2.4 në këtë raport, EULEX-i konstatoi se përkundër këtij ndryshimi legjislativ, numri i rigjykimeve pothuajse nuk është zvogëluar. Përveç se është pranuar që procedura e rigjykimit është e jashtëzakonshme dhe e aplikueshme vetëm në situata specifike, homologët e konsultuar nga EULEX-i shprehën mendimin se, nëse ekziston dyshimi për njëanshmëri ose mungesë paanshmërie, madje edhe një dyshim i mundshëm i ndikimit të padrejtë ose mungesës së përvojës profesionale nga ana e gjyqtarit ose trupit gjykues, GJA e kishte instrumentin ligjor për t'i trajtuar këto aspekte. Dispozitat e nenit 398, paragrafi 2 i KPP-së i ofrojnë GJA-së mundësinë që, në kushte të caktuara, ta caktojë një gjyqtar si kryetar të trupit gjykues apo një trup gjykues të ri<sup>22</sup>. Homologët nga EULEX-i e konsideruan këtë dispozitë të mjaftueshme për t'i dhënë panelit të GJA-së instrumentin për të vendosur për rregullimet në përbërjen e trupit gjykues në themelore në situatat në të cilat plotësohen kushtet.

21 Sistemi Informatik për Menaxhimin e Lëndëve (SIML) është një sistem elektronik i cili ruan një sërë informacionesh në lidhje me rastet, duke lehtësuar një qasje më të shpejtë në dosjet gjyqësore dhe përditësimet e rasteve.

22 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, neni 398: "Gjykata e Apelit mund të urdhërojë gjykatën themelore që të caktojë një tjetër gjyqtar të vetëm gjykues, kryetar të trupit gjykues ose trup gjykues sipas një sistemi të caktimit të lëndëve që të jetë objektiv dhe transparent, nëse Gjykata e Apelit vlerëson se gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose trupi gjykues që e ka gjykuar rastin në mënyrë të vazhdueshme nuk e ka zbatuar ligjin siç duhet, ka vlerësuar shumë gabimisht provat ose moskaktimi i gjyqtarit apo trupit gjykues tjetër do të rezultonte në keqpërdorim të drejtësisë ose konflikt të interesit."

Gjatë diskutimeve me Departamentin Ligjor të KGJK-së, është paraqitur një argument shtesë në favor të mbajtjes së praktikës së njëjtë gjyqësore kur kemi të bëjmë me rigjykime. Zyrtarët e departamentit përmendën se departamenti ishte në proces të përgatitjes së rregulloreve të reja për vlerësimin profesional të gjyqtarëve. Një tregues për vlerësimin profesional të gjyqtarëve dhe avancimin e mundshëm të tyre raportohet të jetë përqindja e rasteve të kthyera nga GJA-ja. Kjo duhet t'i inkurajojë gjyqtarët që t'i kushtojnë vëmendje shtesë aspekteve që kanë të bëjnë me hartimin e aktgjykimit, vlerësimin e provave dhe zbatimin e drejtë të ligjit për të parandaluar rigjykimet.

Departamenti Ligjor i KGJK-së më tej e ka informuar EULEX-in se është angazhuar në rishikimin e udhëzimeve në lidhje me përdorimin dhe zbatimin e SIML-së në caktimin e rasteve të rigjykimit dhe, duke pasur parasysh komentet e EULEX-it, do t'i kushtonte vëmendjen e duhur kësaj çështje në mënyrë që të ndryshojë sistemin për të lejuar caktimin e rasteve përmes SIML-së. Megjithatë, në një takim me Kryetarin e GJA-së u ngrit një argument tjetër në favor të praktikës aktuale. U argumentua se gjyqtarët e shkallës së parë do të kishin më shumë nxitje për të hartuar aktgjykime të arsyetuar mirë, pasi ata ishin të vetëdijshëm se rasti do t'u kthehej atyre në rast të rigjykimit.

## Konkluzione

KGJK-ja, siç rekomandohet nga EULEX-i, e ka vlerësuar praktikën e caktimit të rasteve dhe po i kushton vëmendje kësaj çështjeje gjatë rishikimit të udhëzimeve të SIML-së. Megjithatë, praktika e caktimit manual vazhdon. Praktika aktuale e miratuar nga shkrimoret dhe e miratuar nga Departamenti Ligjor i KGJK-së, edhe pse nuk është plotësisht në përputhje me rregulloret lidhur me caktimin e rasteve, e as me dispozitat e KPP-së, ende siguron një metodë efikase dhe efektive të gjykimit të rasteve të kthyera në rigjykim. Megjithatë, sa i përket pajtueshmërisë me standardet e të drejtave të njeriut, veçanërisht të drejtën për një gjykim të drejtë në nenin 6 (1) të KEDNJ-së, kjo praktikë mbetet diskutabile.

## 2.6. Regjistrimi i procedurave gjyqësore

### Sfondi

Në Raportin e tij të Monitorimit të Drejtësisë 2021, EULEX-i ka vërejtur se procedurat gjyqësore në seancat gjyqësore të monitoruara nuk janë regjistruar asnjëherë me video ose audio. Përveç kësaj, procesverbalet me shkrim ishin kryesisht *fjalë për fjalë*. Kjo praktikë i ka ngadalësuar ndjeshëm seancat dhe i ka zgjatur gjykimet. Për më tepër, kjo praktikë i ngarkon palët dhe dëshmitarët që japin dëshmitë e tyre, sepse procesverbali *fjalë për fjalë* e detyron gjyqtarin, palët dhe dëshmitarët ta rregullojnë mënyrën e të folurit. Për më tepër, ata shpesh janë ndërprerë ose u është kërkuar që t'i përsërisin deklaratat e tyre. Duke pasur parasysh këtë, EULEX-i vlerësoi se kjo praktikë mund ta rrezikojë cilësinë e dëshmisë, veçanërisht në rastet e ndjeshme si krimet e luftës dhe rastet e dhunës në baza gjinore (DHBGJ), në të cilat dëshmitë janë një pjesë veçanërisht e rëndësishme e provave. Prandaj, nëse sigurohet që gjykatat të jenë të pajisura në mënyrë adekuate për regjistrimin me audio të seancave gjyqësore do ta rriste si efikasitetin ashtu edhe cilësinë e procedurave gjyqësore.

### Rekomandimet e dhëna nga EULEX-i

- ✓ Të gjitha gjykatat duhet të pajisen me pajisje teknike që të mund t'i regjistrojnë me audio procedurat gjyqësore.
- ✓ Kur këto pajisje të jenë në dispozicion, gjykatat duhet t'i përdorin ato të paktën për audio-regjistrimin e dëshmive të palëve, dëshmitarëve dhe ekspertëve dhe të mbajnë procesverbal me shkrim vetëm për gjërat thelbësore të seancës gjyqësore.

## Zbatimi

Kodi i ri i Procedurës Penale (KPP) ka hyrë në fuqi në shkurt 2023. Sipas nenit 311, paragrafi 2 i KPP-së, shqyrtimi gjyqësor, përveç procesverbalit me shkrim, regjistrohet edhe me audio ose me video. Megjithatë, shumica e seancave të shqyrtimit gjyqësor ende nuk janë duke u regjistruar, kryesisht për shkak të mungesës së pajisjeve teknike.

Projekti i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), i financuar nga Byroja Kombëtare e SHBA-ve për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit, për instalimin e pajisjeve për regjistrim në 27 gjykatat e shkallës së parë tashmë është finalizuar në të shtatë gjykatat themelore dhe në të gjitha 22 degët e tyre. Përveç regjistrimit të seancave, pajisjet duhet të përdoren edhe për të krijuar kushte adekuate për dhënien e dëshmive nga dëshmitarët e mbrojtur.

Një sallë gjykimi në secilën gjykatë themelore do të jetë e pajisur me pajisje për regjistrim me audio dhe video, ndërsa të gjitha sallat e tjera do të pajisen me pajisje për regjistrim me audio. Gjithashtu, në Gjykatën e Apelit (GJA) janë pajisur edhe dy salla për video-konferenca, ndërsa në objektin e KGJK-së janë instaluar pajisje për video dhe audio.

Një grup punues i KGJK-së është në proces të hartimit të rregullores për përdorimin e regjistrimit me audio dhe video gjatë seancave gjyqësore, të cilën KGJK-ja pritët ta miratojë në fund të këtij viti.

Dy gjyqtarë janë caktuar për testimin e pajisjeve teknike në Gjykatën Themelore (GJTH) të Gjilanit. Në kuadër të testimit, procedurat janë duke u regjistruar me shkrim dhe me audio, kurse më pas përgatitet një transkriptim i kësaj të fundit. Ndërsa në këtë fazë nuk arrihet efikasitet kohor përmes këtij regjistrimi të dyfishtë, cilësia e regjistrimeve të seancave është përmirësuar. Në rastet e mosmarrëveshjeve në lidhje me saktësinë e shënimeve me shkrim, ato mund të zgjidhen duke iu referuar regjistrimit me audio.

Në njërën nga sallat e gjykimit në GJTH të Prizrenit, të gjitha seancat për rastet e rënda penale janë regjistruar me audio për një kohë të gjatë, por nuk ishte përgatitur asnjë transkrip i këtyre regjistrimeve. Palëve që e kundërshtojnë saktësinë e procesverbalit me shkrim u lejohe qasja në regjistrimin me audio.

KGJK-ja e ka informuar EULEX-in se disa gjykata tashmë kanë filluar përdorimin e pajisjeve për regjistrim edhe pse rregullorja për procedurën e përdorimit të tyre ende nuk është finalizuar.

## Konkluzione

Ndërkohë që ende jo të gjitha gjykatat i kanë instaluar pajisjet teknike për regjistrim me audio dhe video, instalimi është duke vazhduar dhe testimi ka filluar. Prandaj, rekomandimi i parë mund të konsiderohet i zbatuar deri në fund të vitit 2024.

Sa i përket rekomandimit të dytë, nuk ekziston mundësia që të bëhet vetëm regjistrimi me audio i dëshmive të palëve, dëshmitarëve dhe ekspertëve, pasi neni 311 i KPP parashikon që procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të jetë me shkrim, ndërsa regjistrimi me audio ose video mund të bëhet vetëm *përveç* atij me shkrim. Meqenëse regjistrimi me shkrim *fjalë për fjalë* është duke u bërë ende si më parë, ky regjistrim nuk do ta rrisë ndjeshëm efektivitetin e procedurave gjyqësore. Megjithatë, mund të supozohet se regjistrimi me audio dhe video do ta rrisë cilësinë e procedurave. Sipas nenit 311, paragrafi 1 i KPP-së, është e mundur që regjistrimet me shkrim (procesverbali i seancës) të kufizohet vetëm në “elementet themelore” (që, sipas nenit 314 të KPP-së, janë informacion teknik si emri i gjykatës, palët e pranishme, identifikimin e aktakuzës, propozimet dhe aktvendimet etj, përveç përmbajtjes thelbësore të dëshmive). Veçanërisht ndryshimi i praktikës së regjistrimit të dëshmive *fjalë për fjalë* në regjistrimin vetëm të përmbajtjes thelbësore me shkrim mund ta përmirësojë efektivitetin e regjistrimit dhe në kombinim me regjistrimin me audio dhe video mund t'i zvogëlojë kundërshtimet për



përmbajtjen e procesverbalit. Kur të instalohen dhe të vihen në përdorim pajisjet, mbetet për t'u parë nëse gjyqtarët do ta shfrytëzojnë mundësinë për ta kufizuar regjistrimin me shkrim dhe nëse do të mbështeten në regjistrimet me audio dhe video si regjistrimi kryesor i gjykimeve.

## 2.7. Shpallja e aktgjykimeve penale në shkallë të parë

### Sfondi

Raporti i Monitorimit të Drejtësisë i EULEX-it 2020 ka identifikuar parregullsi në pothuajse 50% të shpalljeve të aktgjykimeve në shkallë të parë. Parregullsitë e konstatuara kanë qenë se nuk janë lexuar veprat penale, palëve nuk u janë dhënë udhëzime lidhur me mjetet juridike, arsyetimi i pamjaftueshëm i aktgjykimit dhe se shpallja nuk është dëgjuar si duhet. Sipas Kodit të ri të Procedurës Penale (KPP), më nuk kërkohet që të jepet një përmbledhje e shkurtë e arsyeve të aktgjykimit kur jepet një aktgjykim fajësie, siç kërkohet në KPP-në e mëparshme<sup>23</sup>. KPP-ja i ri parashikon që një përmbledhje e tillë e shkurtë do të jepet në kohën e shpalljes së vendimit në gjykatë vetëm nëse jepet aktgjykim për lirim nga akuza<sup>24</sup>. EULEX-i nuk ka qenë në gjendje që t'i përcaktojë arsyet për heqjen e kësaj kërkese dhe në bazë të monitorimit të shpalljeve mund të konkludohet se një përmbledhje e shkurtë e arsyeve është ende duke u dhënë në shumicën e rasteve, duke përfshirë edhe rastet e aktgjykimeve të fajësisë. Dhënia e arsyeve për aktgjykimin është me rëndësi si për të pandehurit ashtu edhe për të dëmtuarit, pasi që kjo i informon ata në një fazë të hershme për arsyet dhe provat në të cilat është bazuar aktgjykimi i fajësisë apo i lirit nga akuza. KPP-ja i ri parashihet që aktgjykimi me shkrim të jepet në afat prej 30 ditësh nga shpallja (15 ditë nëse i pandehuri është në paraburgim), me mundësi të zgjatjes së afatit deri në 60 ditë në rastet e ndërlikuara.

### Rekomandimi i dhënë nga EULEX-i

- ✓ Ekziston nevoja për trajnime më efektive të gjyqtarëve. Diskutimet në forume profesionale midis gjyqtarëve të shkallëve të ndryshme gjithashtu mund ta adresojnë në mënyrë efektive këtë shqetësim.

### Zbatimi

Ndërmjet prillit dhe shtatorit 2023, EULEX-i i ka monitoruar 16 shpallje të aktgjykimeve<sup>25</sup> dhe është fokusuar në mënyrë specifike në ato aspekte të shpalljeve ku janë identifikuar parregullsi. Bazuar në parregullsitë e mëparshme siç është shpjeguar më sipër, EULEX-i ka identifikuar parregullsi në dy nga 16 shpalljet.

Në njërin rast nuk është dhënë arsyetimi kurse në rastin e dytë vepra penale nuk është lexuar si duhet, nuk është dhënë arsyetimi dhe shpallja nuk është dëgjuar dhe kuptuar siç duhet.

Në rastin e dytë, gjyqtari nuk e ka dhënë arsyetimin me sugjerimin e mbrojtësit, edhe pse ky ishte aktgjykim për lirim nga akuza dhe pala e dëmtuar ishte e pranishme gjatë shpalljes. Edhe pse të gjitha shpalljet përveç njëres mund të dëgjoheshin dhe kuptoheshin, ato zakonisht lexoheshin shpejt. EULEX-i gjithashtu ka vërejtur se në shumicën e rasteve prokurori ka munguar gjatë shpalljes<sup>26</sup>. Sipas nenit 365, paragrafi 2 i KPP, aktgjykimi shpallet në prani të palëve, ndërsa

23 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, neni 366, paragrafi 2, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759> (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

24 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, neni 365, paragrafi 2, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759> (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

25 Nga 16 aktgjykime, nëntë ishin aktgjykime fajësie (me pranimin e fajësisë në dy raste), pesë aktgjykime për lirim nga akuza dhe dy aktgjykime ku një i pandehur u shpall fajtor ndërsa një i pandehur u lirua nga fajësia.

26 Në 12 nga 16 shpalljet ka munguar prokurori, ndërsa në të gjitha shpalljet kanë qenë të pranishëm mbrojtësit.

në paragrafin 4 thuhet se aktgjykimi shpallet edhe në mungesë të palës. Edhe pse prezenca e prokurorit nuk kërkohet me ligj, EULEX-i i inkurajon prokurorët, qoftë prokurori i rastit apo zëvendësuesi, të jenë të pranishëm gjatë shpalljes, duke pasur parasysh se kjo është një pjesë e rëndësishme e procedurës dhe duke marrë parasysh rolin e prokurorit si përfaqësues i një autoriteti publik dhe iniciuesi i procedurës.

Rekomandimi për trajnime më efektive dhe/ose diskutime në forume nuk është zbatuar. Megjithatë, shpallja e aktgjykimeve është një temë e mbuluar nga moduli i trajnimit *Shkrimi dhe arsyetimi ligjor*, i ofruar nga Akademia e Drejtësisë për më shumë se 10 vjet në kuadër të programit të trajnimit fillestar, i cili është i detyrueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar<sup>27</sup>, si dhe në Programin për Trajnim të Vazhdueshëm, i cili është vullnetar<sup>28</sup>. Akademia e Drejtësisë ofron edhe module të tjera trajnimi ku trajtohen temat që kanë të bëjnë me shpalljen e aktgjykimit.

## Konkluzione

Bazuar në gjetjet e përgjithshme pozitive dhe faktin se kjo temë mbulohet nga modulet e trajnimit në kuadër të programeve të Akademisë së Drejtësisë, EULEX-i konsideron se Rekomandimi i dhënë është zbatuar mjaftueshëm. EULEX-i e inkurajon gjyqësorin që të vazhdojë të bëjë shpallje të qarta dhe të ofrojë arsyetim, pavarësisht nga rezultati i rastit konkret, si dhe t'i lexojë shpalljet me një ritëm më të ngadaltë në mënyrë që të sigurohet se palët janë në gjendje ta kuptojnë të gjithë përmbajtjen dhe implikimet e shpalljes. Shpalljet e qarta dhe të plota të aktgjykimeve janë elementë të rëndësishëm për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë.

## 2.8. Përdorimi i paraburgimit gjatë procedurës penale

### Sfondi

Paraburgimi është masa më e rëndë e parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale (KPP) për të siguruar praninë e të pandehurit në gjykim, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale dhe për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale<sup>29</sup>. Meqenëse paraburgimi nënkupton një kufizim të rëndë të së drejtës për liri, KPP parashikon që ai duhet të përdoret si masë e fundit dhe të shqiptohet për një kohë sa më të shkurtër të mundshme<sup>30</sup>. Për më tepër, në përputhje me standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut për të drejtën e lirisë<sup>31</sup>, të cilat synojnë të sigurojnë që personat të mos privohen nga liria e tyre në mënyrë arbitrare, kushtet ligjore në bazë të cilave mund të caktohet kjo masë parashihen në KPP dhe ato janë të detyrueshme<sup>32</sup>. Është me rëndësi të theksohet se kur të pushojnë së ekzistuari arsyet që

27 Ligji për Akademinë e Drejtësisë, Nr. 05/L-095, 8 shkurt 2017, neni 19 i [ActDocumentDetail.aspx \(rks-gov.net\)](#) (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

28 Në varësi të performancës së punës, trajnimi mund të bëhet i detyrueshëm, sipas nenit 20 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, [ActDocumentDetail.aspx \(rks-gov.net\)](#) (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

29 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, neni 171, paragrafi 1.8, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759> (qasja e fundit më 20 shtator 2024). Masat e tjera janë: thirrja; urdhërarrest; premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin; ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar; paraqitja në stacionin policor; dorëzania; arresti shtëpiak.

30 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, neni 5, paragrafi 3, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759> (qasja e fundit më 20 shtator 2024): 'Çdo heqje lirie, e sidomos kohëzgjatja e paraburgimit në procedurë penale, duhet zvogëluar në kohën sa më të shkurtër të mundshme'.

31 Për shembull, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), neni 5, dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), neni 9.

32 Kodi i Procedurës Penale, 17 gusht 2022, neni 184, paragrafi 1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759> (qasja e fundit më 20 shtator 2024): 'Gjykata mund të caktojë paraburgim ndaj një personi vetëm nëse në mënyrë të qartë ka gjetur se:

1.1. ekziston dyshim i bazuar se personi i tillë ka kryer veprë penale;

1.2. përmbushet njëri nga kushtet e mëposhtme:

1.2.1. kur ai fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë se ekziston rrezik i ikjes së tij;

justifikojnë përdorimin e tij, paraburgimi duhet të ndërpritet ose të zëvendësohet me një masë më të butë<sup>33</sup>.

Në Raportet e Monitorimit të Drejtësisë të EULEX-it 2020 dhe 2021, EULEX-i gjeti se paraburgimi shpesh herë aplikohet në mënyrë sistematike, pa argumentim të duhur dhe kishte efekt ndëshkues, pavarësisht nëse ishte i paramenduar apo jo. EULEX-i gjithashtu vuri në dukje se ka pasur raste kur të pandehurit kanë qenë në paraburgim me vite pa një vendim përfundimtar. Pas kësaj, EULEX-i ka vazhduar t'i kushtojë vëmendje përdorimit të masës së paraburgimit në sistemin e drejtësisë penale, veçanërisht në lidhje me përdorimin e tepruar dhe kohëzgjatjen e tepërt të tij.

### Rekomandimet e dhëna nga EULEX-i

- ✓ Gjatë nxjerrjes së aktvendimeve për paraburgimin, në lidhje me rrezikun e mundshëm të arratisjes, ndikimit mbi dëshmitarët ose përsëritjes së veprës penale, gjyqtarët duhet t'u përmbahen rreptësishtë parakushteve ligjore<sup>34</sup> dhe të ofrojnë shpjegimin e të gjitha fakteve materiale të cilat e diktojnë paraburgimin, duke përfshirë arsyet për dyshimin e bazuar se personi ka kryer vepër penale.
- ✓ Gjyqtarët që e caktojnë paraburgimin duhet ta arsyetojnë këtë masë bazuar në fakte dhe duke ofruar prova të mjaftueshme për rreziqet specifike.
- ✓ Në rast se plotësohen kushtet për caktimin e një mase sigurie, duhet të urdhërohet masa më e butë kurse paraburgimi duhet të jetë mjeti i fundit.
- ✓ Gjyqtarët duhet ta llogarisin kohëzgjatjen e paraburgimit në përputhje me nenin 187, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale<sup>35</sup>.
- ✓ Gjykatat e Kosovës duhet të sigurojnë që vendimi i tyre t'i përmbushë kriteret e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit për të përcaktuar kohëzgjatjen e arsyeshme të paraburgimit në lidhje me kohëzgjatjen e gjykimit.
- ✓ Në rastet kur vlerësohet se paraburgimi nuk është më i nevojshëm dhe proporcional, i pandehuri duhet të lirohet nga paraburgimi.

1.2.2. kur ka arsye për të besuar se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit; ose

1.2.3. kur përkrahja e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej.

1.3. masat më të buta për sigurimin e pranisë së të pandehurit të parapara në nenin 173 të këtij Kodi do të ishin të pamjaftueshme për të siguruar praninë e personit të tillë, të parandalojë përsëritjen e veprës penale dhe të sigurojë zbatimin e suksesshëm të procedurës penale.

33 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, neni 182, paragrafët 2 dhe 3, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759> (qasja e fundit më 20 shtator 2024): 2. Paraburgimi duhet të reduktohet në kohën (...). 3. Paraburgimi hiqet dhe i paraburgosuri lirohet në çdo fazë të procedurës posa të pushojnë shkaqet e caktimit të tij.

34 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, neni 186, paragrafi 1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759> (qasur më 25 shtator 2023): 'Paraburgimi caktohet me aktvendimin me shkrim i cili përfshin (...) arsyetimin e të gjitha fakteve vendimtare që e kanë shkaktuar paraburgimin, duke përfshirë edhe arsyet për dyshim të bazuar se personi ka kryer vepër penale dhe faktet vendimtare nga neni 187, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. i këtij Kodi'.

35 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, neni 187, paragrafi 1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759> (qasur më 25 shtator 2023): 'I paraburgosuri mund të mbahet në paraburgim më së shumti një (1) muaj nga dita e arrestimit në bazë të urdhrorit nga neni 188 të këtij Kodi. Pas kësaj kohe, ai mund të mbahet në paraburgim vetëm me aktvendim të gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues me të cilin urdhërohet vazhdimi i paraburgimit'

## Zbatimi

Për t'i përcjellë këto rekomandime, EULEX-i e ka analizuar një mostër rastësore të 67 aktvendimeve për paraburgim të nxjerra në periudhën dhjetor 2021 – gusht 2023, të cilat janë marrë nga gjykatat themelore të Kosovës<sup>36</sup>. Duke i zberthyer të gjitha kriteret ligjore që duhen përmbushur<sup>37</sup> gjatë caktimit të paraburgimit, EULEX-i ka vërejtur si vijon:

- Elementi i parë që duhet plotësuar me rastin e caktimit të paraburgimit është dyshimi i bazuar se vepra penale është kryer. Nga 67 aktvendime, 39 i kanë përshkruar (shumica prej tyre vetëm pjesërisht) arsyet e dyshimit të bazuar, pjesa tjetër vetëm iu referuan provave të mbledhura, pa dhënë ndonjë arsyetim të duhur.
- Elementi i dytë i detyrueshëm është një nga këto: rreziku i arratisjes, rreziku i asgjësimit të provave ose pengimit në çfarëdo mënyre të procedurës penale, ose rreziku i përsëritjes së veprës penale për shkak të rrethanave të veprës penale ose rrethanave të tjera personale. Nga aktvendimet e analizuara, EULEX-i ka vërejtur se në 44 raste (prej 67 sish), gjykata e ka arsyetuar siç duhet ekzistimin e njëres prej këtyre rrethanave. Për shembull, rreziku i arratisjes ishte arsyetuar saktë në disa raste në bazë të shtetësisë së huaj të pandehurve dhe lidhjet e tyre të forta me vende të tjera<sup>38</sup>. Megjithatë, në 23 aktvendime, ekzistimi i një prej rreziqeve të mësipërme është përmendur shkurtimisht pa një arsyetim konkret të mbështetur me prova.
- Elementi i tretë lidhet me ekzistimin e 'bazave të artikuleshme'<sup>39</sup> për të besuar se masat më të buta për ta siguruar praninë e të pandehurit në procedurën penale janë të pamjaftueshme. Arsyetimi i artikuleshme është një arsye e dukshme nga rrethanat e rastit dhe të pandehurit dhe që mund të tregohet/shpjegohet lehtësisht nga gjykata. Vetëm në 10 prej aktvendimeve kjo është përshkruar në mënyrë eksplicite nga gjykata, në 57 të tjerat nuk është dhënë asnjë bazë për moscaktimin e masës më të butë. Nga 10 sish, vetëm shtatë aktvendime përfshinin dhe përshkruanin mjaftueshëm të gjitha elementet e nevojshme ligjore për caktimin e paraburgimit.

Llogaritja e kohëzgjatjes së paraburgimit vazhdoi të ndryshojë nga rasti në rast, në kundërshtim me rekomandimet e EULEX-it. Për shembull, në disa nga aktvendimet e analizuara kohëzgjatja e paraburgimit është llogaritur si një muaj, ndërsa në të tjerat si 30 ditë, të cilat nuk janë domosdoshmërisht ekuivalente.

EULEX-i i ka përcjellë rastet e profilit të lartë me gjykime në proces, në të cilat të pandehurit kanë qenë në paraburgim për një kohë të gjatë. Në *ish rastin e EULEX-it Olympia*, i pandehuri kishte qenë në paraburgim për më shumë se gjashtë vjet, gjë që paraqet shqetësime serioze për

36 Aktvendimet janë nxjerrë në rastet e dhunës në familje, vjedhjeve, vrasjeve, korrupsionit etj., si në vijim: GJTH e Ferizajt (katër aktvendime nga Departamenti i Përgjithshëm dhe pesë aktvendime nga Departamenti i Krimeve të Rënda), GJTH e Prizrenit (pesë aktvendime nga Departamenti i Përgjithshëm dhe pesë aktvendime nga Departamenti i Krimeve të Rënda), GJTH e Mitrovicës (tre aktvendime nga Departamenti i Përgjithshëm dhe katër aktvendime nga Departamenti i Krimeve të Rënda), GJTH e Pejës (pesë aktvendime nga Departamenti i Përgjithshëm dhe pesë aktvendime nga Departamenti i Krimeve të Rënda), GJTH e Prishtinës (pesë aktvendime nga Departamenti i Përgjithshëm, pesë aktvendime nga Departamenti i Krimeve të Rënda dhe katër aktvendime nga Departamenti Special), GJTH e Gjakovës (tre aktvendime nga Departamenti i Përgjithshëm dhe katër aktvendime nga Departamenti i Krimeve të Rënda), GJTH e Gjilanit (pesë aktvendime nga Departamenti i Përgjithshëm dhe pesë aktvendime nga Departamenti i Krimeve të Rënda).

37 Kodi i Procedurës Penale, 17 gusht 2022, neni 184, paragrafi 1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759>, dhe neni 187, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale, 04/L. -123, 28 dhjetor 2012 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2861> (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

38 Shembull: Aktvendimi nr. 2022: 001142, i nxjerrë më 06 janar 2022 nga GJTH Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda e konsideron shtetësinë shqiptare të pandehurit dhe punësimin e tij aktual në Gjermani si rrezik nga ikja prej përgjegjësisë penale.

39 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, neni 19, paragrafi 1.31, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759> (qasja e fundit më 20 shtator 2024): 'kur informata apo prova duhet të jetë e artikuleshme, pala e cila paraqet informacionin apo provën duhet të specifikojë në detaje informatën apo provën në të cilën mbështetet'. Për shembull, një i dyshuar që posedon edhe pasaportën e një vendi të huaj dhe ka lidhje të forta me të ose ka tentuar më parë t'i shmangte veprimet hetimore, mund të konsiderohet nga gjykata si bazë e artikuleshme për të vlerësuar se vetëm paraburgimi dhe jo një masë më e lehtë mund ta sigurojë praninë e tij/saj në gjykim.

të drejtat e njeriut. Në anën tjetër, është vërejtur përmirësim në *ish rastin e EULEX-it Olympus I*, ku dy nga të pandehurit u liruan në arrest shtëpiak në qershor 2022 pas shtatë, respektivisht gjashtë vjetësh në paraburgim, masë që u zëvendësua më vonë për njërin prej tyre me paraqitje në polici. Një i pandehur tjetër në të njëjtin rast, një serb i Kosovës, u lirua në prill 2024 pas dy vjet e gjysmë në paraburgim. Në *rastin e vrasjes së Oliver Ivanoviqit*, tre të pandehurit, në paraburgim që nga viti 2018, janë liruar në arrest shtëpiak më 3 qershor 2022, ku gjykata ka vlerësuar se kushtet për ekzistimin e masës së paraburgimit kishin pushuar së ekzistuari dhe do të mjaftonte një masë më e lehtë.

Nga shtatori i vitit 2023, prej gjithsej 601<sup>40</sup> të paraburgosurve, EULEX-i ka identifikuar 61 persona të cilët janë mbajtur në paraburgim për një kohë më të gjatë, duke përfshirë një femër e cila ka qenë në paraburgim për gati shtatë vjet, sipas të dhënave të ofruara nga Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK). Tabela e mëposhtme paraqet numrin e personave të paraburgosur për një periudhë më të gjatë (në total: 61 të paraburgosur).

Kohëzgjatja e paraburgimit	Më shumë se dy vjet	Më shumë se tre vjet	Më shumë se katër vjet	Më shumë se pesë vjet	Gjashtë vjet ose më shumë
Numri i të arrestuarve	36	9	3	3	10

## Konkluzione

Vetëm një numër shumë i vogël i aktvendimeve (shtatë nga 67) janë nxjerrë në përputhje me të gjitha parakushtet ligjore. Prandaj, EULEX-i konstaton se ka pasur shumë pak progres në zbatimin e rekomandimeve të tij në lidhje me përdorimin e tepruar të paraburgimit.

Në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të paraburgimit, numri i të paraburgosurve për një kohëzgjatje më të gjatë (për më shumë se dy vjet) u rrit nga 37 në vitin 2021 në 61 në vitin 2023 dhe mund të konstatohet se ende ekziston një numër i konsiderueshëm i të paraburgosurve në gjykime të zvarritura për një kohë shumë të gjatë. Megjithatë, siç u përkrah më lart, ka pasur progres të caktuar në lidhje me zgjatjen e tepërt të paraburgimit dhe zëvendësimin e tij me masa më të buta në disa nga rastet e profilit të lartë, por megjithatë duhen ndërmarrë hapa për të siguruar proporcionalitetin e paraburgimit gjatë gjithë procedurës penale.

## 2.9. Zbatimi i sanksioneve penale përfundimtare

### Sfondi

Zbatimi i sanksioneve penale është hapi i fundit në zinxhirin penal. Në Raportin e tij të Monitorimit të Drejtësisë 2021, EULEX-i nënvizoi se ky aspekt shpesh anashkalohej në vlerësimin e funksionimit të sistemit të drejtësisë penale. Zbatimi i duhur i sanksioneve penale është thelbësor për të siguruar besueshmërinë e sistemit gjyqësor. Në raportin e tij të lartpërmendur, EULEX-i ka vërejtur disa mospërputhje dhe mungesë të praktikave homogjene në zbatimin e dënimeve penale të formës së prerë nëpër gjykata të ndryshme themelore. EULEX-i vuri në dukje se pozita dhe funksionimi i Zyrtarit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nuk ishte përcaktuar qartë në rregulloret e brendshme të gjykatave të ndryshme themelore. Kjo pozitë kategorizohet ndryshe në secilën gjykatë themelore, ndonjëherë si nëpunës, në raste të tjera si nëpunës i lartë.

40 490 shqiptarë të Kosovës, 33 serbë të Kosovës, 4 boshnjakë të Kosovës, 1 turk i Kosovës, 9 ashkalinj të Kosovës, 3 egjiptianë të Kosovës, 8 romë të Kosovës, 0 goranë të Kosovës dhe 53 të huaj. Nga ky numër total, 11 të arrestuar ishin femra dhe pjesa tjetër meshkuj.



Zyrtari për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale zakonisht i raporton drejtpërdrejt kryetarit të gjykatës themelore.

Gjithashtu, Sistemi Informativ për Menaxhimin e Lëndëve (SIMI), një sistem elektronik i cili ruan informacione të ndryshme në lidhje me rastet gjyqësore (përfshirë aktgjykimet që përmbajnë sanksionet penale të aplikuara), nuk u përdor në masën më të mirë në lidhje me ekzekutimin e sanksioneve penale. EULEX-i gjithashtu ka monitoruar vështirësitë që lindin nga mungesa e referencës specifike në disa aktgjykime për mënyrën e zëvendësimit të gjobës kur ajo nuk mund të arkëtohet me detyrim, siç kërkohet nga Kodi i mëparshëm dhe i ri i Procedurës Penale (KPP).<sup>41</sup> Në atë kohë, EULEX-i konstatoi se këto raste ishin trajtuar nga zyrtarë të ndryshëm në secilën gjykatë themelore, qoftë nga kryetari i gjykatës, Zyrtari për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale apo nga personeli tjetër, duke çuar në mospërputhje dhe mungesë praktikash homogjene.

### Rekomandimet e dhëna nga EULEX-i

- ✓ Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) duhet të sigurojë që SIML-i të zbatohet plotësisht në të gjitha nivelet e procedurave të ekzekutimit. Për ta lehtësuar kalimin nga përdorimi i bazave të tyre të dhënave ose regjistrave manualë në një sistem të unifikuar, zyrtarët për ekzekutim duhet të trajnohen plotësisht.
- ✓ KGJK-ja duhet të sigurojë që pozita e zyrtarit për ekzekutim të rregullohet më mirë me terma specifike të referencës, kërkesat e punës, kategorinë e përcaktuar dhe sanksionet.
- ✓ Gjyqtarët duhet ta përfshijnë një referencë specifike në aktgjykimet e tyre për mënyrën e zëvendësimit të gjobës kur ajo nuk mund të arkëtohet me detyrim, siç kërkohet nga neni 365, paragrafi 2, KPP dhe neni 43, KPP (që do të thotë se kur personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk është në gjendje të paguajë gjobën, gjykata do ta përcaktojë mënyrën e zëvendësimit të gjobës, qoftë me dënim me burgim ose me punë në dobi të përgjithshme me pëlqimin e personit të dënuar).

### Zbatimi

Në disa gjykata, SIML-i ende nuk përdoret sistematikisht nga zyrtarët për ekzekutimin e sanksioneve penale, ndërsa në të tjerat, zyrtarët për ekzekutim ende nuk janë trajnuar plotësisht për ta përdorë këtë funksion. Për shembull, caktimi i rregullt i rasteve për ekzekutim tek zyrtarët për ekzekutimin e sanksioneve penale përmes SIML-it ka filluar vetëm në korrik 2023 në Gjykatën Themelore (GJTH) të Prishtinës. Ngjashëm me gjetjet fillestare, disa Zyrtarë për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale në gjykata të ndryshme themelore deklaruan se do të preferonin të vazhdonin përdorimin e bazave të dhënave të tyre dhe regjistrave manualë si një mjet rezervë, pavarësisht nga ngarkesa shtesë e punës, duke nënkuptuar se jo në të gjitha rastet Zyrtarët për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale kanë kaluar nga përdorimi i bazave të tyre të dhënave ose regjistrave manualë në një sistem të unifikuar.

EULEX-i kishte theksuar më herët se pozita e zyrtarit për ekzekutimin e sanksioneve penale nuk ishte e rregulluar në mënyrë specifike. Neni 11 i Rregullores së KGJK-së *për Organizimin e Brendshëm të Gjykatës* së vitit 2020, si dhe neni 4 i asaj të vitit 2013, ndër përgjegjësitë e kryetarit të gjykatës, e parashohin obligimin e përgjithshëm në vijim (pika 6): organizimin, mbikëqyrjen dhe ushtrimin e kontrollit të drejtpërdrejtë të ekzekutimit të sanksioneve penale në baza mujore". Prandaj, pozita e zyrtarit për ekzekutimin e sanksioneve penale ka qenë dhe në këtë fazë vazhdon të jetë e kategorizuar ndryshe në secilën gjykatë themelore, herë si nëpunës, në raste të tjera si nëpunës i lartë. Ata zakonisht i raportojnë drejtpërdrejt kryetarit të gjykatës

<sup>41</sup> Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, neni 364, paragrafi 2.4: "Kur i akuzuari dënohet me gjobë, në aktgjykim shënohet afati kur duhet paguar gjoba dhe mënyra e zëvendësimit të gjobës kur gjoba forcërisht nuk mund të arkëtohet," <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759> (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

themelore. Me sa duket, ende nevojitet të bëhet një përkufizim më specifik i pozitës së Zyrtarit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, duke përfshirë kërkesat e punës, termat e referencës, kategorinë dhe sanksionet.

Përfundimisht, EULEX-i i shqyrtoi përsëri vështirësitë e paraqitura nga mungesa e referencës specifike në disa aktgjykime për mënyrën e zëvendësimit të gjobës kur ajo nuk mund të arkëtohet me detyrim, siç kërkohet me nenin 364, paragrafi 2.4. të KPP-së. Edhe një herë u konstatua se këto raste po trajtohen ndryshe në secilën gjykatë themelore. Kryesisht është kryetari i gjykatës themelore ai që vendos për mënyrën e konvertimit, nganjëherë është Zyrtari për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, kurse në disa gjykata themelore këto vendime merren nga punonjës të tjerë, ose konsiderohet se vendimi nuk mund të miratohet dhe i kthehet gjyqtarit për ta ndryshuar vendimin duke përfshirë konkretisht mënyrën e konvertimit. Një aspekt që është vërejtur edhe nga EULEX-i është se në disa raste mundësia e ofruar nga neni 43, paragrafi 2 i Kodit Penal (KP) për përcaktimin e pagesës me këste është aplikuar shumë rrallë nga gjyqtarët në dënimet të tyre dhe herë pas here Zyrtarët për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale e ofronin këtë mundësi me iniciativën e tyre, duke pasur parasysh gjendjen e rëndë ekonomike të gjobiturve.

## Konkluzione

Përderisa është vërejtur progres i caktuar në lidhje me zbatimin e SIML-it në nivel të Zyrtarëve për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të gjitha Rekomandimet e dhëna nga EULEX-i mbeten relevante. Një përkufizim më specifik i pozitës së zyrtarit për ekzekutimin e sanksioneve penale do të ishte i dobishëm dhe gjyqtarët duhet të përfshijnë një referencë specifike në gjykimet e tyre për mënyrën e zëvendësimit të gjobës kur ajo nuk mund të arkëtohet me detyrim, gjë që do të çonte në një praktikë konsistente në zbatimin e dënimeve penale.

## 2.10. Zbatimi i dënimeve plotësuese

### Sfondi

Në Raportin e tij të Monitorimit të Drejtësisë 2022, EULEX-i e ka vlerësuar zbatimin e dënimeve plotësuese. Dënimet plotësuese kanë për qëllim forcimin e efektit të dënimeve kryesore (si ato kryesore ashtu edhe ato alternative) dhe mund të shqiptohen vetëm në lidhje me to. Sipas nenit 40 të Kodit Penal (KP), dënimet kryesore janë 1) dënimi me burgim të përjetshëm, 2) dënimi me burgim dhe 3) dënimi me gjobë. Lista e dënimeve alternative, sipas nenit 41 të KP, janë: 1) dënimi me kusht, 2) dënimi me gjysmë liri dhe 3) urdhri për punë në dobi të përgjithshme.

Neni 59 i KP<sup>42</sup> e përcakton një listë me tetë lloje të ndryshme të dënimeve plotësuese, duke përfshirë *ndalimin e ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik* (paragrafi 2.3.) dhe *ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës* (paragrafi 2.4.). Nenet 62 dhe 63 rregullojnë më tej këto dy dënime plotësuese. Për shembull, këto nene specifikojnë nëse dënimi plotësues është i detyrueshëm dhe përcaktojnë intervalin e periudhës kur një personi i ndalohet të ushtrojë funksione publike, në varësi të llojit të veprës dhe nëse kryerësit i është shqiptuar dënimi me burgim, dënimi me kusht ose gjoba. Në Kodin Penal të vitit 2019, u futën dispozita të reja në nenet 62<sup>43</sup>

42 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 59, paragrafi 2, [A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf \(rks-gov.net\)](#) (qasja e fundit më 20 shtator 2024): janë: 1) heqja e të drejtës për t'u zgjedhur; 2) urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit; 3) ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik; 4) ndalimi i ushtrimit të profesionit, i veprimtarisë ose detyrës; 5) ndalimi i drejtimit të automjetit; 6) marrja e lejes së vozitjes; 7) urdhri për publikimin e aktgjykimit dhe 8) dëbimi i të huajit nga Kosova.

43 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 62, paragrafi 3, [A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf \(rks-gov.net\)](#) (qasja e

dhe 63<sup>44</sup>, të cilat e bënin të detyrueshëm shqiptimin e dy dënimeve plotësuese të përmendura, *ndër të tjera, në rastet e korrupsionit.*

Duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj kategorive të veprave, EULEX-i e fokusoi monitorimin e tij në aplikimin dhe zbatimin e dënimeve plotësuese të shqiptuara në lidhje me aktgjykimet për rastet e korrupsionit.

Si konstatim i përgjithshëm, në vitin 2022, EULEX-i vërejti mospërputhje dhe mungesë të praktikave të standardizuara në zbatimin e këtyre dy kategorive të dënimeve plotësuese. Staf i në të gjitha gjykatat themelore kryesisht nuk e kuptonte këtë koncept as përgjegjësitë e tyre në lidhje me zbatimin. EULEX-i për më tepër konstatoi se zbatimi i sanksioneve penale nuk ishte trajtuar në mënyrë konsekuente si përgjegjësi e Zyrtarit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nëpër gjykatat themelore (shih gjithashtu gjetjet në lidhje me pozitën e Zyrtarit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale në kapitullin 2.9, 'Zbatimi i sanksioneve penale përfundimtare'). Për më tepër, shumica e gjykatave nuk i zbatuan dy dispozita specifike në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LEPS),<sup>45</sup> të cilat e adresojnë zbatimin e dy dënimeve plotësuese të lartpërmendura: *ndalimin e ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik dhe ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.* Ky ligj parashikon që aktgjykimet në lidhje me *ndalimin e ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik* duhet t'i dërgohen menjëherë nga gjykata Ministrisë së Administratës Publike<sup>46</sup> si institucioni i mandatuar për ta mbikëqyrë ekzekutimin e këtij dënimi plotësues. Aktgjykimet lidhur me *ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës*, gjykata duhet t'ia dërgojë menjëherë ndërmarrjes publike ose private ku ka qenë i punësuar personi i dënuar dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,<sup>47</sup> e cila duhet ta mbikëqyrë ekzekutimin e këtij lloji të dënimit plotësues. Megjithatë, EULEX-i në atë kohë vërejti se gjykatat ia komunikuan dënimin vetëm institucionit publik ose privat në të cilin ishte i punësuar personi i dënuar, por jo edhe Ministrisë përkatëse. Të dyja ministritë e informuan EULEX-in se nuk kishin marrë asnjëherë ndonjë aktgjykim nga gjykatat që i ngarkonin me mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve plotësuese në fushën e tyre përkatëse të kompetencës. EULEX-i gjithashtu vuri në dukje në atë kohë se dënimet plotësuese shpesh regjistroheshin në mënyrë të pasaktë në Sistemin Qendror të Evidencës Penale.

EULEX-i gjithashtu vërejti se nuk kishte sistem për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave përkatëse statistikore për aplikimin dhe zbatimin e dënimeve plotësuese nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) në nivelin qendror apo nga gjykatat themelore. Meqenëse këto lloje të dhënash nuk ishin të disponueshme, EULEX-i zgjodhi ta vlerësonte çështjen duke i identifikuar aktgjykimet e rasteve ku dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratë publike ose në shërbimin publik është dashur të shqiptohej në lidhje me aktgjykimet e lidhura me korrupsionin. Më pas u vu re se gjyqtarët nuk i aplikonin gjithmonë dënimet plotësuese të detyrueshme, ndërkohë që në shumë dënime gjykatat prireshin që dënimet me burgim t'i konvertonin në gjoba; krahas shmangies së dënimeve me burgim, shndërrimi në gjobë rezultoi në shmangien e aplikimit të dënimeve plotësuese, të cilat do të ishin të detyrueshme në rast të dënimit me burgim.

fundit më 20 shtator 2024): 'Gjykata ia ndalon një personi zyrtar ushtrimin e funksionit në administratë publike apo funksioneve të shërbimeve publike prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet pas mbajtjes së dënimit me burgim, nëse personi është dënuar për ndonjë nga veprat që përfshihen në Kapitullin XXXIII të këtij Kodi (Korrupsioni dhe vepra penale kundër detyrës zyrtare)'. Neni 62, paragrafi 4 i Kodit Penal, 06/L-074, [A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf \(rks-gov.net\)](#) (qasja e fundit më 20 shtator 2024): 'Gjykata ia ndalon një personi zyrtar ushtrimin e funksionit në administratë publike apo në shërbime publike prej një (1) deri në pesë (5) vjet, nëse i njëjti është dënuar për dhunë në familje, sipas nenit 248 të këtij Kodi'.

44 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 63, paragrafi 4, [A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf \(rks-gov.net\)](#) (qasja e fundit më 20 shtator 2024): 'Gjykata ia ndalon një personi zyrtar ushtrimin e profesionit, aktivitetit të pavarur, të detyrës menaxhuese apo administrative prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet, nëse personi është dënuar për ndonjë nga veprat në Kapitullin XXXIII të këtij Kodi (Korrupsioni dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare)'.

45 Emri i ligjit u ndryshua nga LESP në LESK (Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Kriminale). Neni 161 i LESP nga gushti i vitit 2022 është neni 156 i LESK.

46 Ministria e Administratës Publike u shkri me Ministrinë e Punëve të Brendshme në vitin 2020

47 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale tani quhet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.



## Rekomandimet e dhëna nga EULEX-i

- ✓ KGJK duhet të sigurojë që ekziston një sistem i unifikuar për zbatimin e dënimeve plotësuese. Për këtë qëllim, KGJK-ja duhet të qartësojë të gjitha aspektet relevante përmes akteve nënligjore, në të cilat të specifikohen qartë përgjegjësitë e secilit akter.
- ✓ KGJK duhet të krijojë një sistem të automatizuar të mbledhjes së të dhënave për dënimet plotësuese dhe zbatimin e tyre përmes Sistemit Informativ për Menaxhimin e Lëndëve (SIML). Për këtë qëllim, duhet të krijohet një fushë specifike e të dhënave në SIML që të përmbajë të gjitha informacionet përkatëse si datën përkatëse të komunikimit të dënimit plotësues, emrat e institucioneve të cilave iu është komunikuar dhe atë të nëpunësit që e ka lëshuar.
- ✓ KGJK-ja duhet të sigurojë që Sistemi Qendror i Evidencës Penale të përmbajë të dhënat e plota lidhur me dënimet plotësuese. Për ta lehtësuar këtë, duhet të krijohet një fushë specifike e të dhënave në këtë sistem për të përfshirë informacionin e detyrueshëm për ekzistencën e një dënimi plotësues, natyrën e tij dhe kohëzgjatjen specifike.
- ✓ KGJK-ja duhet t'i udhëzojë gjykatat që t'ua komunikojnë me kohë dënimet plotësuese institucioneve përkatëse në përputhje me nenet 160 dhe 161 të LESP-së (tani nenet 155 dhe 156 në LESP-në e ri) dhe duhet të përcjellin rregullisht zbatimin efektiv të neneve 62 dhe 63 të Kodit Penal.
- ✓ KGJK-ja duhet të krijojë një mekanizëm monitorues për të vlerësuar nëse gjyqtarët i zbatojnë dënimet e detyrueshme plotësuese sipas nenit 62 dhe 63 të KP dhe të vërtetojnë nëse në rastet e korrupsionit gjykatat priren që dënimet me burgim t'i konvertojnë në gjoba, duke çuar jo vetëm në shmangien e dënimeve me burgim, por edhe për shmangien e zbatimit të detyrueshëm të dënimeve plotësuese.

## Zbatimi

Që nga publikimi i Raportit të EULEX-it të Monitorimit të Drejtësisë 2022, nuk janë vërejtur ndryshime në asnjërin nga gjykatat themelore dhe vazhdon të ekzistojë mungesa e përgjithshme e të kuptuarit nga stafi i gjykatave themelore të konceptit të dënimeve plotësuese dhe përgjegjësitë e personelit në lidhje me zbatimin e tyre. Në këtë kuptim, EULEX-i konstatoi se ekzekutimi i sanksioneve penale nuk trajtohet në mënyrë të vazhdueshme si përgjegjësi e Zyrtarit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale në shumicën e gjykatave themelore dhe se kjo detyrë ka vazhduar të shpërndahet shpesh nëpër zyra apo personel të ndryshëm. Në Raportin e tij të Monitorimit të Drejtësisë 2021, EULEX-i tashmë kishte nënvizuar nevojën për ta përcaktuar më mirë rolin dhe përgjegjësitë e Zyrtarit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale për ekzekutimin e sanksioneve penale përfundimtare, përfshirë edhe dënimet plotësuese.

EULEX-i gjithashtu vuri në dukje se shumica e gjykatave ende nuk i kanë zbatuar dy dispozitat specifike në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP), i njohur më parë si LESP, të cilat e adresojnë zbatimin e dy dënimeve plotësuese të lartpërmendura.


EULEX-i vlerësoi se stafi i gjykatave themelore nuk ishte ende mjaft i informuar për këto dispozita ligjore. Megjithatë, në qershor 2024, asnjë nga ministritë nuk kishte marrë ende ndonjë vendim nga gjykatat për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve plotësuese. Po ashtu, EULEX-i përsëri përcaktoi se në disa raste, dënimet plotësuese nuk ishin regjistruar në mënyrë të duhur, ose ishin të regjistruar në mënyrë të pasaktë, në Sistemin Qendror të Evidencës Penale, përkundër përpjekjeve të bëra në këtë drejtim. EULEX-i gjithashtu nuk ka vërejtur progres në krijimin e një sistemi për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave përkatëse statistikore për aplikimin dhe zbatimin e dënimeve plotësuese nga KGJK-ja në nivelin qendror apo nga gjykatat themelore. Përveç kësaj, EULEX-i përsëri identifikoi aktgjykime të rasteve ku dënimet plotësues i ndalimit

të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik është dashur të shqiptohet sipas nenit 62, paragrafi 3 i Kodit Penal në aktgjykimet lidhur me korrupsionin. Ashtu si në Raportin e Monitorimit të Drejtësisë 2022, EULEX-i i më pas verifikoi nëse dënimet plotësuese, të detyrueshme në këto dënime për korrupsion në rast të dënimit me burgim, ishin shqiptuar vërtet ashtu siç kërkohet me ligj.

➤ Keqpërdorimi i pozitës zyrtare

Në bazë të vlerësimit të 32 aktgjykimeve fajësuese sipas nenit 414 të KP (keqpërdorimi i pozitës zyrtare), EULEX-i ka identifikuar se dënimet plotësuese janë shqiptuar në njëmbëdhjetë aktgjykime, ndërsa në pesë aktgjykime dënimi me burgim është pezulluar kurse në nëntë aktgjykime dënimi me burgim është konvertuar në gjobë me të cilën është shmangur dënimi plotësues i detyrueshëm. Për më tepër, në shtatë aktgjykime ka pasur detyrim për shqiptimin e dënimit plotësues, i cili megjithatë nuk është shqiptuar nga gjykata duke e shkelur ligjin. Vlen të përmendet se diapazoni i burgimit për këtë vepër është nga një deri në tetë vjet (nga gjashtë muaj deri në pesë vjet në Kodin Penal të mëparshëm), duke lënë të kuptohet se në shumë aktgjykime është shqiptuar dënimi minimal, madje edhe nën minimumin. Gjithashtu, dënimi me burgim prej gjashtë muajsh është periudha maksimale për të cilën lejohet konvertimi në gjobë. Si përfundim, në shumë vendime u shqiptuan dënime minimale me burgim dhe nëntë prej tyre më vonë u shndërruan në gjoba, duke shmangur kështu zbatimin e detyrueshëm të një dënimi plotësues.

**Aktgjykimet fajësuese - Neni 414 i Kodit Penal Keqpërdorimi i pozitës zyrtare - 32 aktgjykime fajësuese**



➤ Konflikti i interesit

Në bazë të vlerësimit të një aktgjykimi fajësues sipas nenit 417 të Kodit Penal (Konflikti i interesit), EULEX-i ka identifikuar se përkundër pezullimit të dënimit me burgim, dënimi plotësues i detyrueshëm është shqiptuar në përputhje me ligjin, ndërsa në një aktgjykim tjetër fajësues sipas nenit 420 të Kodit Penal (Shfrytëzimi i paautorizuar i pasurisë), me aktgjykim është shqiptuar një dënim plotësues me të cilin dënimi me burgim prej tre muajsh është konvertuar në gjobë.

➤ Marrja e ryshfetit

Në bazë të vlerësimit të katër aktgjykimeve fajësuese sipas nenit 421 të Kodit Penal (Marrja e ryshfetit), gjykata i ka shqiptuar tre dënime plotësuese për rastet me burgim, në njërin prej të cilave dënimi me burgim është pezulluar. Në rastin e katërt, dënimi me burgim është konvertuar në gjobë.


➤ Ushtrimi i ndikimit

Bazuar në vlerësimin e tre aktgjykimeve fajësuese sipas nenit 424 të Kodit Penal (Ushtrimi i ndikimit), EULEX-i ka identifikuar se fillimisht nuk ka pasur dënim plotësues në njërin prej rasteve. Me konvertimin e këtij dënimi me burgim gjashtëmuor u shmang aplikimi i detyrueshëm i dënimit plotësues. Megjithatë, Gjykata e Apelit (GJA) më vonë e ndryshoi atë dhe shqiptoi një dënim plotësues. Në një rast tjetër gjykata themelore ka shqiptuar dënim plotësues dhe në rastin e tretë dënimi me burgim prej gjashtë muajsh është konvertuar në gjobë.

➤ Mosdeklarimi ose deklarimi i rremë i pasurisë, të ardhurave/të hyrave, dhuratave, përfitimeve të tjera materiale ose detyrimeve financiare

Bazuar në vlerësimin e 21 aktgjykimeve fajësuese sipas nenit 430 të Kodit Penal (Mosdeklarimi ose deklarimi i rremë i pasurisë, të ardhurave/të hyrave, dhuratave, përfitimeve të tjera materiale ose detyrimeve financiare), EULEX-i ka identifikuar se në asnjë aktgjykim nuk janë shqiptuar dënime plotësuese, ndërsa në 11 aktgjykime është shqiptuar vetëm një gjobë si dënim. Në dhjetë aktgjykime, dënimi me burgim është pezulluar (pesë raste) ose është konvertuar në gjobë (pesë raste të tjera), me çka është shmangur dënimi plotësues i detyrueshëm. Si përfundim, në shumicën e aktgjykimeve u shqiptuan dënime minimale me burgim dhe gjysma e tyre u pezulluan ose u konvertuan në gjoba.

**Aktgjykimet fajësuese - Neni 430 Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, të hyrave/të ardhurave, dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare - 21 gjykime fajësuese**



### Konkluzione

EULEX-i vlerësoi se gjetjet e Raportit të tij të Monitorimit të Drejtësisë 2022 ishin ende të vlefshme pasi vazhdoi të vëzhgonte, në vitin 2023 dhe 2024, mospërputhje të ngjashme dhe mungesë të praktikave të standardizuara në aplikimin dhe zbatimin e dy kategorive të vlerësuara të dënimeve plotësuese. Të gjitha rekomandimet janë ende të aplikueshme dhe KGJK-ja duhet ta marrë rolin prijës për adresimin e tyre. Aktualisht, nuk ekziston një mekanizëm monitorues për të vlerësuar nëse gjyqtarët i aplikojnë dënimet plotësuese të detyrueshme. Si SIML-ja ashtu edhe Sistemi Qendror i Evidencës Penale mund të përdoren për të krijuar një sistem të unifikuar dhe gjithëpërfshirës për aplikimin e dënimeve plotësuese. Një mekanizëm i tillë monitorues do të ofronte një pasqyrë shumë më të mirë të dhënave për të përcaktuar nëse në rastet e korrupsionit gjykatat i aplikojnë dënimet plotësuese të detyrueshme dhe nëse gjykatat ende prirën të konvertojnë shumë dënime me burgim, duke çuar jo vetëm në shmangien e dënimeve me burgim, por edhe në shmangien e aplikimit të detyrueshëm të dënimeve plotësuese.

## 2.11. Caktimi i seancave gjyqësore

### Sfondi

Në Raportin e tij të Monitorimit të Drejtësisë 2022, EULEX-i e trajtoi praktikën e përsëritur të zgjatjes së tepruar të procedurave gjyqësore dhe ndikimin e saj në të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor siç garantohet me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Procedura e caktimit të seancave gjyqësore është një element i rëndësishëm në këtë kontekst, pasi ndikon ndjeshëm në mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore.

EULEX-i vërejti se ishte praktikë e zakonshme që të mos caktoheshin të gjitha seancat në fillim të gjykimit. Në shumicën e rasteve, data e seancave të ardhshme caktohej pas një seance gjyqësore, shpesh një deri në dy muaj pas seancës. Përveç kësaj, nuk ishte e zakonshme të caktoheshin disa seanca dëgjimore në data të njëpasnjëshme.

### Rekomandimet e dhëna nga EULEX-i

- ✓ Gjykatat duhet të caktojnë seancën e radhës brenda një muaji sa herë që kjo është e mundur.
- ✓ Në gjykimet që përfshijnë një numër të madh të pandehurish, gjykatat duhet të planifikojnë disa seanca një pas një gjatë ditëve të radhës, pasi kjo ka rezultuar se e rrit efikasitetin në zhvillimin e këtyre gjykimeve.
- ✓ Gjykatat duhet të miratojnë një plan për të caktuar tërë shqyrtimin gjyqësor në një fazë të hershme të procedurës.
- ✓ Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) duhet ta mbikëqyrë dhe monitorojë performancën e gjykatave dhe ta trajtojë aftësinë e gjykatës për t'i planifikuar dhe caktuar seancat e shqyrtimit gjyqësor si tregues të efikasitetit.

### Zbatimi

EULEX-i e ka përcjellë caktimin e seancave gjyqësore të monitoruara nga ekspertët e EULEX-it gjatë periudhës shtator 2022 deri në shtator 2023 (12 muaj). Nga 271 seanca në të cilat ishte caktuar seanca e radhës gjyqësore, seanca e radhës është caktuar brenda një muaji në 133 raste (49%), brenda dy muajve në 103 raste (38%) dhe brenda më shumë se dy muajve në 35 raste (13%).

EULEX-i kishte bërë një përcjellje të ngjashme gjatë përgatitjes së Raportit të Monitorimit të Drejtësisë 2022, duke analizuar periudhën nëntor 2021 deri në korrik 2022 (9 muaj). Seancat vijuese u caktuan brenda një muaji në 44% të rasteve, brenda dy muajve në 45% të rasteve dhe brenda tre muajve ose më shumë në 11% të rasteve.

Krahasimi tregon një përmirësim të ndjeshëm në përqindjen e seancave të ardhshme gjyqësore të planifikuara brenda një muaji.

*Plani Strategjik i KGJK-së për zgjidhjen efikase të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022-2024*,<sup>48</sup> si një nga masat që synojnë rritjen e produktivitetit dhe efikasitetit në trajtimin e rasteve, sugjeron që të caktohen seancat e njëpasnjëshme kurdo që këtë e lejojnë rrethanat. Në Planin Strategjik pritet që pasi gjykata të fillojë ta zbatojë praktikën e mbajtjes së seancave të

48 KGJK 'Plani Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022-2024' [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2022/11/KGJK\\_Plani\\_Strategjik\\_per\\_zgjidhjen\\_efikase\\_te\\_lendeve\\_te\\_korrupsionit\\_dhe\\_krimit\\_te\\_organizuar\\_2022\\_2024.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2022/11/KGJK_Plani_Strategjik_per_zgjidhjen_efikase_te_lendeve_te_korrupsionit_dhe_krimit_te_organizuar_2022_2024.pdf), uebfaqja e KGJK-së vetëm në versionin shqip, KGJK, tetor 2021 (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

njëpasnjëshme, ajo do të vazhdojë t'i përmbahet rreptësisht atij plani dhe të bëjë ndryshime në të vetëm në situata të jashtëzakonshme.

Në qershor të vitit 2023, KGJK e miratoi Planin e Punës 2023 të Departamentit Special në Gjykatën Themelore (GJTH) të Prishtinës. Një nga objektivat kryesore të Planit të Punës është rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në trajtimin e rasteve dhe ai i përshkruan, mes tjerash, dy masat e mëposhtme që synojnë arritjen e këtij qëllimi: 'caktimin e takimeve përgatitore dhe seancave statusore për planifikimin e rrjedhës së rastit' dhe 'caktimin e seancave të njëpasnjëshme'.

Këto zhvillime të përshkruara tregojnë se ekziston një vetëdijesim në rritje për nevojën e përmirësimit të menaxhimit të rasteve dhe një gatishmëri për t'i zbatuar masat e nevojshme për ta arritur këtë objektiv, si në KGJK ashtu edhe në mesin e gjyqtarëve.

EULEX-i e përcolli praktikën e caktimit të seancave të njëpasnjëshme dhe konstatoi se nga 271 seanca të monitoruara nga shtatori 2022 deri në shtator 2023, në 163 raste (60%), ishte caktuar vetëm një seancë vijuese, kurse në 108 raste (40%) u caktuan dy ose më shumë seanca vijuese. Ky është afërsisht i njëjti rezultat si në periudhën nëntor 2021 deri në korrik 2022, gjatë së cilës ishte caktuar vetëm një seancë vijuese në 61% të seancave.

Në rastet që kanë të bëjnë me një numër të madh të pandehurish, disa trupa gjykues caktuan më shumë se një dhe madje më shumë se dy seanca vijuese. Në rastin e profilit të lartë *Stenta II*, me 43 të pandehur të akuzuar për disa vepra penale të lidhura me korrupsionin, gjykata caktoi rregullisht deri në pesë seanca vijuese, nëse jo domosdoshmërisht në ditë të njëpasnjëshme, të cilat rezultuan në 20 seanca të zhvilluara për këtë rast në periudhën nga shtatori 2022 deri në shtator 2023. Në ish rastin e profilit të lartë të EULEX-it, *Grande II*, në të cilin 15 të pandehur akuzohen për aktivitete kriminale në lidhje me kontrabandimin e migrantëve, kryetari i ri i trupit gjykues, i cili rifilloi rastin në prill 2022, caktoi rregullisht dy ose tre seanca vijuese. Megjithatë, duhet pasur parasysh se, në shumicën e rasteve, jo të gjitha seancat vijuese të planifikuara zhvillohen ashtu siç janë planifikuar.

## Konkluzione

Si KGJK ashtu edhe Departamenti Special në GJTH të Prishtinës kanë ngritur vetëdijesimin për rëndësinë e menaxhimit të rasteve dhe për praktikën e planifikimit të seancave të ardhshme siç është pasqyruar në miratimin e *Planit Strategjik të KGJK-së për Zgjidhjen Efikase të Rasteve të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar 2022 -2024* dhe Planin e Punës 2023 të Departamentit Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Përderisa është vërejtur njëfarë përmirësimi në disa gjykime që përfshijnë një numër të madh të pandehurish, në përgjithësi, nuk mund të konstatohej asnjë përmirësim në lidhje me caktimin e seancave vijuese brenda një muaji dhe as në caktimin e seancave të njëpasnjëshme.

## 2.12. Konfiskimi dhe sekuestrimi (konfiskimi i përkohshëm) i pasurisë

### Sfondi

Në Raportin e tij të Monitorimit të Drejtësisë 2020, EULEX-i identifikoi nevojën për përmirësim në zbatimin e konfiskimit dhe konfiskimit të përkohshëm (sekuestrimin) e pasurisë, duke pasur parasysh se prokurorët dhe gjykatat nuk po e përdornin në mënyrë efektive kornizën ligjore në dispozicion. U konstatua se shumica e pasurisë së konfiskuar ishte shumë më e ulët se shumica e pasurisë së sekuestruar (me gjasë për shkak të numrit të madh të lirimeve nga akuza në rastet e korrupsionit), se shitja e pasurisë qysh gjatë procedurës, siç parashihet me ligj, ishte aplikuar rrallë, dhe se *Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë* nuk ishte duke u zbatuar.



## Rekomandimi i dhënë nga EULEX-i

- ✓ Të fillohet zbatimi i *Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë* dhe të përdoret më shpesh mundësia e shitjes së pasurive.

### Zbatimi

Pavarësisht se Kodi i ri i Procedurës Penale (KPP) (i cili ka hyrë në fuqi më 17 shkurt 2022) ka ndryshuar disa dispozita në lidhje me sekuestrimin dhe konfiskimin me qëllim lehtësimin e procedurës dhe harmonizimin e terminologjisë,<sup>49</sup> koncepti i sekuestrimit dhe konfiskimit ende nuk është duke u aplikuar dhe zbatuar mjaftueshëm në Kosovë.

Për më tepër, *Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë*, i cili ka hyrë në fuqi më 10 janar 2019<sup>50</sup> dhe i cili i rrit mundësitë për konfiskimin e pasurisë nga personat e dënuar dhe gjithashtu nga palët e treta nëse ata kanë blerë pasurinë me keqbesim, po thuhet nuk është duke u zbatuar ende. EULEX-i ka monitoruar se Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK) e ka iniciuar zbatimin e këtij ligji vetëm në dy raste deri në vitin 2023, më shumë se katër vjet pas hyrjes në fuqi të tij. Në nivel të Prokurorive Themelore (PTH), ligji është zbatuar vetëm pesë herë në tërë Kosovën.

Ndërkohë që këto raste kur ligji po zbatohet paraqesin progres të caktuar në zbatim, në përgjithësi, ky instrument ligjor ende nuk po përdoret sa duhet dhe në mënyrë efektive nga praktikuesit, pavarësisht faktit se ekziston një konsensus i përbashkët që ai duhet të zbatohet më rregullisht.

Sipas nenit 262, paragrafi 3.5 i KPP-së<sup>51</sup> lidhur me masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë së caktuar, prokurori mund të urdhërojë shitjen e pasurisë së caktuar gjatë fazës të hetimit të rastit. Kjo dispozitë ka të bëjë me pronën që, për shembull, kërkon kosto të lartë për t'u menaxhuar ose që do të humbet shpejt në vlerë. Shitja administrohet nga Agjencia për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar.<sup>52</sup> Megjithatë, duket se prokurorët hezitojnë të shesin pasuri të vlefshme si automjetet në fazat e hershme të fazës hetimore, sepse kanë frikë se rasti nuk është mjaft i fortë për të ngritur aktakuzë. Nga ana tjetër, gjyqtarët shpesh i konsiderojnë si prova pasuritë e sekuestruara, të cilat si të tilla nuk mund të shiten dhe duhet të qëndrojnë në sekuestrim të përkohshëm deri në vendimin përfundimtar, pavarësisht nga kohëzgjatja e procedurës penale.

Për më tepër, Ligji për *Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar* themeloi Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (AAPSK) në vitin 2009.<sup>53</sup> Roli i AAPSK është që të ndihmojë prokurorin dhe gjykatën në ekzekutimin e pasurisë të sekuestruar ose të konfiskuar dhe të mundësojë shitjen të pasurive të sekuestruara ose të konfiskuara. Megjithatë, Agjencia ende po përpiqet që t'i promovojë kompetencat dhe rolin e saj në këtë kornizë komplekse dhe mbetet e pashfrytëzuar nga entitetet përkatëse juridike.

Kjo mund të ilustruhet nga statistikat e mëposhtme. Nga viti 2021 deri në mesin e vitit 2023, sipas informatave të dhënë nga AAPSK, agjencia ka marrë nga gjykatat vetëm 164 urdhra për

49 Në Kodin e mëparshëm të Procedurës Penale, terminologjia e përdorur në kapituj të ndryshëm lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin nuk ishte konsistente. Disa nene i referoheshin sekuestrimit të përkohshëm, ndërsa të tjerë konfiskimit të përkohshëm. Në terma juridikë, sekuestrimi është procesi i heqjes së përkohshme të pronës nga pronari i saj, në pritje të një vendimi gjyqësor përfundimtar. Nga ana tjetër, konfiskimi është një konfiskim i përhershëm i pasurisë i urdhëruar me vendim të formës së prerë nga një gjykatë.

50 Ligji i Kompetencave të Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë, Nr. 06/L-087, 26 dhjetor 2018, [ActDocumentDetail.aspx \(rks-gov.net\)](#) (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

51 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, [ActDetail.aspx \(rks-gov.net\)](#) (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

52 Ligji për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, Nr. 05/L-049, 14 prill 2016, neni 4 paragrafi 1.3, [9D426AAD-DEB9-405D-8235-38FD1BC76C11.pdf \(rks-gov.net on20\)](#) las shtator 2024).

53 Ligji për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, Nr. 05/L-049, 14 prill 2016, [9D426AAD-DEB9-405D-8235-38FD1BC76C11.pdf \(rks-gov.net\)](#) (qasja e fundit më 20 shtator). Ky ligj është ndryshuar në vitin 2016 dhe në vitin 2022.

sekuestim dhe 169 urdhra për konfiskim. Kjo është mesatarisht pak më shumë se 100 raste në vit, që është një numër relativisht i ulët duke marrë parasysh numrin e përgjithshëm të rasteve gjyqësore në Kosovë.

### Konkluzioni

Korniza ligjore ekzistuese është e kënaqshme dhe gjithëpërfshirëse, por problemi vazhdon të jetë mungesa e zbatimit të mjaftueshëm dhe efikas të dispozitave. Rekomandimi i paraqitur në Raportin e Monitorimit të Drejtësisë 2020 nuk është zbatuar mjaftueshëm.

## 2.13. Institucionet publike, shtetërore dhe shoqërore si palë të dëmtuara

### Sfondi

Në rastet e korrupsionit, pala e dëmtuar shpesh është një institucion publik, shtetëror ose shoqëror. Duke qenë se këto lloj veprash sjellin dëme financiare për këto entitete, prania aktive e përfaqësuesit të tyre gjatë procedurës penale është e rëndësishme sepse si palë të dëmtuara ato kanë të drejtë të paraqesin prova dhe të thërrasin dëshmitarë. Gjithashtu, prania e tyre do t'u mundësonte atyre të shfrytëzonin të drejtën e tyre për kërkesa pronësore apo të parashtrojnë ankesa kundër vendimeve gjyqësore. Përfshirja në procedurën penale është e drejtë e palës së dëmtuar dhe duhet të garantohet nga të gjitha palët në procedurë (prokuroria, gjykatat). Në Raportin e tij të Monitorimit të Drejtësisë 2021, EULEX-i ka vërejtur se në një numër të madh të rasteve, institucioni i dëmtuar ose nuk është identifikuar si i tillë në fazën e ngritjes së aktakuzës ose në rast se është identifikuar ka hequr dorë nga pjesëmarrja në procedura.

### Rekomandimet e dhëna nga EULEX-i

- ✓ Prokurorët duhet të sigurojnë që pala e dëmtuar të identifikohet në aktakuzë.
- ✓ Institucionet shtetërore të identifikuara si palë të dëmtuara duhet të jenë më aktive në këtë rol gjatë shqyrtimit gjyqësor duke plotësuar punën e prokurorit me kallëzimin penal dhe duke mundësuar procesin e dëmshpërblimit. Kjo duhet të bëhet nga përfaqësuesit e tyre ligjor ose nëpërmjet Zyrës së Avokaturës Shtetërore.
- ✓ Roli i Zyrës së Avokaturës Shtetërore në procedurat gjyqësore duhet të rritet.

### Zbatimi


EULEX-i i ka vlerësuar aktakuzat e ngritura gjatë vitit 2022 dhe 2023 lidhur me veprën penale të *Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar*<sup>54</sup>. Një element i kësaj vepre, i cili duhet të provohet në gjykatë, është qëllimi i të pandehurit për të përfituar një dobi ose për të shkaktuar dëm financiar. Kur pretendohet se vepra penale ka shkaktuar dëm, pala e dëmtuar duhet të identifikohet dhe të specifikohet në aktakuzë<sup>55</sup>. Për të siguruar të drejtën e palës së dëmtuar për të marrë pjesë në procedurën gjyqësore nga fillimi i shqyrtimit gjyqësor, prokurori duhet të propozojë që edhe pala e dëmtuar të ftohet në shqyrtim. Një element tjetër thelbësor i një aktakuze të përgatitur mirë në këto raste është se vlera e dëmit të pretenduar të jetë e specifikuar në aktakuzë.

EULEX-i i ka vlerësuar 37 aktakuza të ngritura nga prokurori të ndryshme. Në 16 aktakuza, prokurori nuk ka pretenduar se vepra i ka shkaktuar dëme një institucioni; në disa raste, një

54 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 414, [A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf \(rks-gov.net\)](#) (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

55 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, neni 235, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, [ActDetail.aspx \(rks-gov.net\)](#) (qasja e fundit më 20 shtator 2024); Kodi i Procedurës Penale, 04/L-123, 1 janar 2013, neni 241, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, [NR PENALE. 04/L-123 KODI I PROCEDURËS \(rks-gov.net\)](#) (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

kompani private ose person fizik është identifikuar si palë e dëmtuar dhe në raste të tjera është pretenduar vetëm se qëllimi i të pandehurit/ve ka qenë përfitimi i dobisë. Nga 21 aktakuzat e mbetura, pala e dëmtuar është saktësuar dhe në 15 raste është propozuar që të ftohet në shqyrtim gjyqësor. Në tri raste pala e dëmtuar është saktësuar por nuk është propozuar që të ftohet në shqyrtim gjyqësor. Në një rast në aktakuzë është specifikuar një palë e dëmtuar, ndërsa me gjasë për shkak të gabimit teknik është propozuar që të ftohet një palë tjetër e dëmtuar në shqyrtimin gjyqësor. Në dy raste, pala e dëmtuar as nuk është propozuar që të ftohet në shqyrtimin gjyqësor dhe as nuk është specifikuar në aktakuzë, ndonëse vepra është pretenduar se i ka shkaktuar dëm buxhetit të Kosovës. Vlera e dëmit të pretenduar ndaj buxhetit të Kosovës ishte specifikuar në 14 nga 21 aktakuza. Në rastet e tjera, në aktakuza thuhej se ishte shkaktuar dëm, por jo edhe vlera e tij, ose nuk janë identifikuar fare institucionet si palë të dëmtuara.



Monitorimi njëvjeçar i EULEX-it i një numri të konsiderueshëm të rasteve të korrupsionit në të cilat palë të dëmtuara ishin institucionet, vërtetoi se në shumicën e rasteve, këto institucione dhe përfaqësuesit e tyre shfaqën një qasje pasive gjatë shqyrtimit gjyqësor. Rrallë herë ndodh që të paraqitet ndonjë kërkesë për dëmshpërblim dhe nuk është e pazakontë që asnjë përfaqësues të mos jetë i pranishëm në seancat gjyqësore. Kur një përfaqësues është i pranishëm, shumë e rrallë ndodh që ai ose ajo të ndër marrë ndonjë veprim, si p.sh. paraqitjen e provave ose marrjen në pyetje të dëshmitarëve gjatë marrjes në pyetje.

### Konkluzione

Vetëm dhjetë nga 21 aktakuza janë hartuar në mënyrë të rregullt ku janë identifikuar pala e dëmtuar dhe është specifikuar vlera e dëmit të pretenduar, së bashku me propozimin që pala e dëmtuar të ftohet në shqyrtimin gjyqësor, ndërsa në 11 aktakuzat tjera të mbetura janë identifikuar mangësi në njërin ose në të dy këto aspekte. Për më tepër, edhe kur janë identifikuar dhe ftuar siç duhet, palët e dëmtuara dhe përfaqësuesit e tyre kryesisht kanë hequr dorë nga ndërmarrja e çfarëdo veprimi për të mbrojtur interesat e tyre legjitime në procedurën penale.

Prandaj EULEX-i e përsërit rekomandimin që institucionet publike, shtetërore dhe shoqërore duhet të marrin një rol më aktiv gjatë shqyrtimit gjyqësor në mënyrë që të zvogëlohet sa më shumë që të jetë e mundur dëmi i shkaktuar nga korrupsioni ndaj buxhetit të Kosovës dhe pasurive tjera publike.



## 3. Gjetjet nga monitorimi tematik

### 3.1 Antikorrupsioni

#### Sfondi

Në raportin e EULEX-it të monitorimit të drejtësisë të vitit 2020 ishte theksuar bashkëpunimi dhe koordinimi i mangët ndërmjet policisë dhe prokurorisë për sa i përket trajtimit të antikorrupsionit. U vu re se një sërë hetimesh komplekse ishin kryer pa i eksploruar të gjitha pistat për grumbullimin e provave, çka ka rezultuar me raste të ndërtuara mbi prova të pamjaftueshme ose të paqarta. Parimi ‘ndiq paratë’, i cili parasheh hetime të gjurmëve financiare dhe jo vetëm të provave konkrete të krimit, në përgjithësi ishte neglizhuar.

EULEX-i vlerësoi se Task Forca Anti-Korrupsion (TFAK) e Policisë së Kosovës (PK), e cila më vonë u emërtua Njësia për Hetime Speciale (NJHS), duhet të luajë rol thelbësor në zbulimin, ndërmarrjen e hapave fillestarë dhe hetimin e korrupsionit. EULEX-i vërejti se NJHS kishte mungesë të bazës ligjore të duhur dhe bëri thirrje që kjo të përgatitej. Gjithashtu është vërejtur se entitetet e tjera brenda PK-së nuk i kishin ofruar NJHS-së informata relevante në mënyrë sistematike dhe të rregullt. Përveç kësaj, EULEX-i konstatoi se qasja e NJHS-së në informatat e mbajtura nga agjenci të tjera ishte e kufizuar dhe e penguar nga mungesa e bashkëpunimit.

EULEX-i gjithashtu vërejti se aktgjykimet në rastet e profilit të lartë shpesh ktheheshin për rigjykim në gjykatat themelore nga Gjykata e Apelit (GJA), me arsyetimin se raportet e ekspertëve në të cilat bazohej aktgjykimi i shkallës së parë nuk kishin qenë të hartuara saktë ose nuk ishin shqyrtuar në tërësi nga gjykata.

#### Rekomandimet e dhëna nga EULEX-i

- ✓ NJHS, e mbështetur nga agjenci të tjera të zbatimit të ligjit, duhet të avancojnë parimin ‘ndiq paratë’, pasi ky është vendimtar për hetimin e pastrimit të parave dhe krimeve të tjera financiare.
- ✓ Ministria e Brendshme, në koordinim me menaxhmentin e lartë të PK-së, duhet të marrë drejtimin për qartësimin e mëtejshëm dhe legalizimin e pozitës së NJHS-së në kuadër të PK-së. Kjo mund të arrihet duke propozuar ndryshime në *Ligjin për Policinë*.
- ✓ Menaxhmenti i lartë i PK-së duhet të rrisë kapacitetet e NJHS-së në lidhje me policimin e bazuar në inteligjencë dhe hetimet financiare. NJHS duhet të mbajë linja të drejtpërdrejta të komunikimit me Drejtorinë e Inteligjencës dhe Analizës dhe Agjencinë Kosovare të Inteligjencës në mënyrë që të pajiset me inteligjencë përkatëse.
- ✓ Menaxhmenti i lartë i PK-së duhet të rrisë bashkëpunimin ndërinstitucional të NJHS-së duke krijuar linja zyrtare të komunikimit me organet si Administrata Tatimore, Dogana dhe Njësia e Inteligjencës Financiare.
- ✓ Koordinatorin nacional për luftimin e krimeve ekonomike në bashkëpunim me Prokurorinë Speciale të Kosovës (PSRK) dhe të gjitha Prokuroritë Themelore (PTH) duhet të integrojë sistemin e themeluar të mbledhjes së të dhënave në lidhje me sekuestrimin dhe konfiskimin siç pasqyrohet në ‘Raportin mbi aktivitetet dhe rekomandimet e koordinatorit nacional për luftimin e krimit ekonomik’ në një sistem të krahasueshëm të mbledhjes së të dhënave. Sistemi gjithashtu duhet t’i japë qasje të drejtpërdrejte Koordinatorit nacional për luftimin e krimeve ekonomike.

- ✓ Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), në bashkëpunim me Këshillin Prokurorial të Kosovës (PKP), Zyrën e Kryeprokurorit, dhe Odën e Avokatëve duhet të bëjë analizimin e përdorimit të ekspertizës financiare në rastet e korrupsionit në mënyrë që të identifikohen arsyet e hartimit të pasaktë të ekspertizave apo të mosshqyrtimit të duhur të ekspertizave nga gjykatat, gjë që shpesh rezulton në kthimin e rasteve për rigjykim.

## Zbatimi

Përderisa rekomandimet e EULEX-it janë marrë parasysh dhe është vërejtur një nivel i progresit në zbatimin e tyre, rezultati i përgjithshëm i zbatimit është i kufizuar për sa i përket shkallës dhe efektivitetit.

Edhe pse NJHS-ja konsiderohet si një entitet kyç për hetimet antikorrupsion dhe të krimeve financiare, ekzistojnë pak prova që Njësia, në koordinim me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit dhe PSRK-në, është duke kryer hetime komplekse financiare dhe të udhëhequra nga intelijenca. Për më tepër, disa vendime për personelin kanë pasur ndikim negativ mbi kapacitetin e Njesisë.

Që nga viti 2023 (në lidhje me riorganizimin e vazhdueshëm brenda PK-së), numri i personelit është zvogëluar dhe disa pjesëtarë të stafit janë zëvendësuar me më shumë staf të rinj me më pak përvojë, shkathtësi dhe aftësi për të kryer hetime penale komplekse në fushën e korrupsionit, financave dhe pastrimit të parave. Këto zhvillime rezultuan në uljen e bashkëpunimit ndërmjet NJHS-së dhe PSRK-së në vitin 2024.

Nuk ka indikacione se NJHS dhe PSRK-ja janë duke e zbatuar aktualisht parimin 'ndiq paratë', që është një qasje kritike në hetime të tilla. Në rastet e monitoruara nga EULEX-i, në raporte hetimore apo aktakuza referimet që do të tregonin për kryerje të hetimeve mbi gjurmët financiare janë të pakta apo nuk ekzistojnë fare.

Në vitin 2020, PSRK-ja miratoi dy strategji që synojnë riorganizimin e strukturës së saj të brendshme dhe avancimin e sistemit prokurorial<sup>56</sup>. Ndërsa këto strategji mbështetën një kuptim më të mirë dhe një gatishmëri të shtuar për të zbatuar rekomandimet për përmirësimin e bashkëpunimit me NJHS-në dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, ato kanë pasur efekt të kufizuar në mënyrën e kryerjes së hetimeve për krimin e organizuar, korrupsionin dhe pastrimin e parave.

Në korrik 2022,<sup>57</sup> Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) u transformua në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (APK). Ndërkohë që mund të vërehet progres i caktuar, agjencisë ende i mungon kapaciteti për të përfunduar tranzicionin dhe për të vepruar në përputhje me mandatin e saj, i cili është më i gjerë dhe më i fokusuar në masa parandaluese sesa mandati i AKK-së. Mandati i ri përfshinë, ndër të tjera, vlerësimin e deklaramit të pasurisë, hetimin e rasteve të konfliktit të interesave, shqyrtimin e zbatimit të ligjeve të tjera antikorrupsion, vlerësimin e zbatimit të politikave nacionale antikorrupsion, hartimin e vlerësimeve të rrezikut antikorrupsion dhe ofrimin e ndihmës për zbatimin e planeve publike të integritetit dhe monitorimin e tyre. Përderisa APK-ja ka marrëdhënie pune me PK-në dhe autoritetet prokuroriale, kompetenca dhe mandati i saj hetimor do të ketë nevojë për sqarime të mëtejshme, pasi që mbivendosja e juridiksionit me organet e tjera, e cila veçse ekzistonte në mandatin e vjetër të AKK-së, mbeti e pazgjdhur. Si shembull, APK-së iu besua inicimi i hetimeve të rasteve të korrupsionit, që përfshinë kryerjen e hetimeve administrative paraprake, çka përbënë mbivendosje me kompetencat hetimore të PK-së. Një shqetësim tjetër i mundshëm që kërkon sqarim lidhet me rastet në të cilat APK shqipton gjoba ndaj ndonjë personi apo entiteti; sipas parimit 'no bis in idem'<sup>58</sup>, kjo do të nënkuptonte se kundër atij personi apo entiteti më nuk do

<sup>56</sup> Strategjia e riorganizimit të PSRK-së dhe plani strategjik për sistemin prokurorial 2022-2024.

<sup>57</sup> Ligji për agjencinë për parandalimin e korrupsionit, Nr. 08/I-017, 21 korrik 2022, [ActDetail.aspx \(rks-gov.net\)](https://rks-gov.net/ActDetail.aspx) (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

<sup>58</sup> Asnjë veprim juridik nuk mund të ndërmerret dy herë për të njëjtin shkak të veprimit.

të mund të inicohej asnjë procedurë penale për të njëjtën vepër. Për më tepër, një shqetësim tjetër është se ndërsa APK-ja është e autorizuar të paraqesë kallëzim penal në prokurori, ajo nuk mund të kundërshtojë ose të apelojë vendimin e prokurorisë në lidhje me çështjen, që do të thotë se nëse një prokuror vendosë të mos fillojë procedura penale, APK-ja nuk ka kompetencë të ndryshojë atë vendim.<sup>59</sup>

Plani i ristrukturimit të PK-së i vitit 2023, i cili është duke u zbatuar aktualisht, nuk arriti të qartësojë dhe zyrtarizojë pozitën, rolin dhe funksionin e NJHS-së brenda PK-së. Për më tepër, përderisa *Ligji për Policinë* lejon krijimin e njërive të përkohshme për detyra specifike, mosratifikimi i NJHS-së brenda strukturave zyrtare të PK-së jo vetëm që po e rrezikon NJSH-në si njësi specifike brenda PK-së, por po rrezikon edhe strukturën organizative të saj, objektivat e përcaktuara dhe kapacitetet operationale. Edhe pse NJHS përmendet si entitet në *Ligjin e fundit për Prokurorinë Speciale*, kjo nuk do të thotë se NJHS tani është e themeluar zyrtarisht pasi që ky ligj nuk ka autoritet dhe qëndrim mbi NJHS që konsiderohet të jetë entitet i PK-në.

Me kapacitetin e saj aktual dhe kornizën ekzistuese, NJHS nuk ka kualifikime eksperte për të avancuar kapacitetet e saj të policimit të udhëhequr nga intelijenca dhe të kryerjes së hetimeve financiare apo për të zhvilluar bashkëpunimin e saj me agjenci të tjera. Për shkak të kësaj, NJHS po ashtu ballafaqohet me probleme me mbajtjen e linjave zyrtare dhe të drejtpërdrejta të komunikimit me organet dhe entitetet e tjera, si Drejtoria e Inteligjencës dhe Analizës e Policisë së Kosovës, Agjencia Kosovare e Inteligjencës, Administrata Tatimore, Dogana dhe Njësia e Inteligjencës Financiare.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimit për shfrytëzimin e ekspertëve financiarë, problemi duket të jetë i dyfishtë. Një, paqartësia në lidhje me kualifikimin dhe ekspertizën e ekspertëve të zgjedhur, dhe dy, mundësia dhe vullneti i gjykatës për të vlerësuar siç duhet këto raporte. Përderisa përzgjedhja dhe metodologjia e punës së ekspertëve është e rregulluar me Kodin e Procedurës Penale (KPP) dhe është shqyrtuar nga KGJK në bashkëpunim me Zyrën e Kryeprokurorit dhe Odën e Avokatëve, çështjet e vërejtura lidhur me përzgjedhjen e ekspertëve shpesh kanë të bëjnë me aspektet e konfliktit të interesit, paragjyqimeve ose kriteret e ekspertizës. Në gusht të vitit 2023 ka hyrë në fuqi *Ligji për Ekspertët Gjyqësorë*, i cili rregullon procedurën për licencimin e ekspertëve. Kjo mund të korrigojë deri diku vështirësitë në lidhje me përzgjedhjen e ekspertëve.

## Konkluzione

EULEX-i ka vërejtur një nivel të caktuar të përmirësimit në zbatimin e rekomandimeve të tij që kanë të bëjnë me antikorrupsionin. Edhe pse ka një pëlqim të shprehur për nevojën për të avancuar luftën kundër korrupsionit, mungon qasja koherente për arritjen e këtyre qëllimeve. Theksi duket se kufizohet tek krijimi i rregulloreve dhe strukturave me vëmendje të pamjaftueshme ndaj zbatimit dhe aplikimit aktual të tyre. Mund të vërehet se ndonëse rregulloret dhe politikat janë në fuqi, qasja dhe mirëkuptimi i kufizuar dhe formalist është duke e penguar përdorimin e plotë të instrumenteve ligjore në dispozicion.

### 3.1. Krimet sipas të drejtës ndërkombëtare

#### Sfondi

Në raportet e tij të monitorimit të drejtësisë të viteve 2020, 2021 dhe 2022, EULEX-i theksoi sfidat e paraqitura në hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e krimeve sipas së drejtës

<sup>59</sup> Sipas raporteve vjetore të Agjencisë për parandalimin e korrupsionit në vitin 2022, 267 raste dhe në vitin 2023 59 lëndë janë përcjellë në prokurori ose polici për procedim të mëtutjeshëm.

ndërkombëtare. Këto sfida lidhen me shkallën e madhe të veprave në fjalë, të cilat mund të përfshijnë një numër të madh të viktimave dhe autorëve, dhe rëndësinë që ka përgjegjësia për këto krime në aspektin e proceseve të drejtësisë tranzicionale. Kalimi i kohës gjithashtu pakëson ndjeshëm provat e disponueshme, pasi që këto lloje të rasteve zakonisht zgjidhen bazuar vetëm në provat e deklaratave. Me kalimin e kohës, kujtesa e dëshmitarëve zbehet, disa vdesin dhe të tjerë zhvendosen, duke ua vështirësuar autoriteteve kryerjen e intervistave vijuese. Në këtë pamje dinamike të trajtimit të krimeve të luftës, EULEX-i ka nxjerrë një sërë rekomandimesh në lidhje me shpejtësinë dhe cilësinë e hetimeve dhe gjykimit të rasteve.

### Rekomandimet e dhëna nga EULEX-i

- ✓ Policia e Kosovës (PK) duhet të bëjë përpjekje për të vazhduar hetimin dhe analizimin e të gjitha rasteve të krimeve të luftës të kategorizuara me prioritet të lartë.
- ✓ Bashkëpunimi ndërmjet Departamentit për krime luftime të Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK) dhe PK-së duhet të përmirësohet.
- ✓ Departamenti për krime luftime i PSRK-së duhet të zgjerohet.
- ✓ Autoritetet e Kosovës inkurajohen të kërkojnë mënyra për të përmirësuar bashkëpunimin rajonal për hetimin e rasteve të krimeve të luftës me prioritet të lartë, veçanërisht me Serbinë, ku shumë të dyshuar dhe dëshmitarë banojnë.
- ✓ PSRK-ja duhet t'i japë prioritet hetimeve paraprake në rastet kur të dyshuarit janë në paraburgim.
- ✓ Gjykata Themelore (GJTH) e Mitrovicës duhet të përshpejtojë rigjykimin e *rastit Drenica I* dhe *rasteve* të mbetura *Vukotić*, ndërsa GJTH e Prizrenit duhet t'i japë prioritet rigjykimit të *rastit Remzi Shala*.
- ✓ Akademia e Drejtësisë duhet të ofrojë masa trajnimi për gjyqtarët mbi specifikat e arsytimit të aktgjykimeve në lidhje me krimet nga e drejta ndërkombëtare.

### Zbatimi

Lista e dhjetë rasteve me prioritet të lartë është përpiluar nga PSRK-ja në fillim të vitit 2018. Këto raste janë krime që përfshijnë shumë viktime (si vrasjet masive), dhunë të konsiderueshme dhe aktivitete kriminale të koordinuara e komplekse. PK ka avancuar në hetimin e rasteve të krimeve të luftës me prioritet të lartë. Deri në fillim të vitit 2024, rreth gjysma e dhjetë hetimeve ose ishin përfunduar ose ishin shumë afër përfundimit, ndërsa një aktakuzë u ngrit në dhjetor 2023. Gjykimet në mungesë tani mund të zhvillohen sipas Kodit të ri të Procedurës Penale (KPP), megjithatë vetëm në kushte të caktuara dhe pasi të jenë ndërmarrë hapa të caktuar<sup>60</sup>. Kjo ka rezultuar në një rritje të numrit të hetimeve të përfunduara me sukses. Që nga miratimi i KPP-së së re janë ngritur nëntë aktakuza në mungesë. Një zhvillim i rëndësishëm gjatë kësaj periudhe është ngritja e aktakuzës së parë në një nga rastet me prioritet të lartë (*Rasti i Mejës*) në fillim të dhjetorit 2023. Ky rast përfshinë 53 të pandehur dhe vepra penale të shumta, përfshirë doktrinën e ndërlikuar ligjore të përgjegjësisë komanduese. Për herë të parë trajtohet edhe shfarosja e fshatrave të tëra, duke ia shtuar kompleksitetin.

Si Njësia e PK për hetimin e krimeve të luftës (NJHKL PK) ashtu edhe Departamenti i PSRK për krimet e luftës ndajnë mendimin se bashkëpunimi i tyre është përmirësuar. Në vitin 2022, NJHKL e PK u përball me mungesë të konsiderueshme të personelit, pengesë kjo për përgjigje të shpejta ndaj kërkesave të prokurorëve. Kjo u përmirësua në mars 2023, kur, si pjesë e

<sup>60</sup> Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, neni 303, [ActDetail.aspx \(rks-gov.net\)](#) (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

rikonfigurimit të brendshëm të PK-së, NJHKL pati rritje domethënëse në aspektin e kapacitetit dhe statusit të saj, duke përfshirë ngritjen e saj në nivelin e Drejtorisë së Policisë.

Ka plane për ta rritur numrin e zyrtarëve policorë në NJHKL deri në gjithsej 41. Megjithatë, sipas të dhënave të prillit 2024, numri efektiv është 31. Çështjet logjistike, duke përfshirë hapësirën e kufizuar për zyra për shkak të vendosjes së vazhdueshëm të Njesisë në lokacionin e saj të mëparshëm, paraqesin pengesë për akomodimin e pjesëtarëve shtesë të stafit. Pavarësisht kësaj, ka pasur një rritje të stafit të caktuar për rastet e krimeve të luftës, duke u rritur nga 18 në korrik 2022 në 31 aktualisht, shenjë e një trajektoreje pozitive në forcimin e aftësive hetimore të Njesisë.

Në vitin 2022, numri i prokurorëve në Departamentin e PSRK për krimet e luftës shënoi një rritje të caktuar në katër dhe zbriti në tre në mesin e dhjetorit 2023, me pensionimin e një prej prokurorëve të tij më me përvojë. Në fillim të qershorit 2024, dy prokurorë shtesë iu bashkuan departamentit. Disa prokurorë janë ende të angazhuar në gjykime në lidhje me rastet që ata i kanë pasur nën menaxhim para kalimit të tyre në Departamentin e krimeve të luftës, andaj nuk kanë trajtuar ekskluzivisht vetëm rastet e krimeve të luftës. Kjo tregon një mangësi në zbatimin e ndryshimeve të rekomanduara. Pavarësisht funksionimit me vetëm tre prokurorë për një kohë të gjatë, ka pasur një rritje të numrit të aktakuzave,<sup>61</sup> duke nënvizuar qëndrueshmërinë e Departamentit në arritjen e rezultateve edhe me burime të kufizuara. Një dinamikë tjetër është praktika e herëpashershme e prokurorëve të departamenteve të tjera që me përjashtime ngritin aktakuza *ad hoc* për krime ndërkombëtare. Edhe pse jo konvencional, ky fleksibilitet mund të ofrojë një zgjidhje pragmatike për tejkalimin e kufizimeve të burimeve.

Autoritetet e Kosovës kanë qenë të pasuksesshme në përmirësimin e bashkëpunimit rajonal me Serbinë. Pavarësisht sfidave aktuale, prokurorët kanë bërë përpjekje të konsiderueshme në këtë drejtim. Në një rast që përfshinë procedurat në mungesë, prokurori kërkoi ndihmë juridike nga autoritetet serbe për të njoftuar të pandehurin ndaj të cilit ishte ngritur aktakuza, por pa ndonjë sukses. Një tjetër pengesë ndodhi në fillim të vitit 2023 kur, në përgjigje të një kërkesë për ekstradim të dërguar nga Kosova në Hungari (në kuadër të një marrëveshjeje dypalëshe), autoritetet hungareze e ekstraduan të dyshuarin në Serbi. Kjo kthesë e paparashikuar e ngjarjeve komprometoi ndjeshëm hetimin në vazhdim.

Për më tepër, kërkesat e Kosovës për ekstradim për individë nga Mali i Zi gjithashtu u përballën me vështirësi. Ndërsa bashkëpunimi ka qenë i mirë përgjatë viteve, në fund të vitit 2023, Ministri i Drejtësisë refuzoi të zbatojë një vendim të nxjerrë nga një gjykatë në Mal të Zi për ekstradimin e një personi në Kosovë, duke nënvizuar ndikimin e elementeve politike në raste të tilla.

Në periudhën para publikimit të raportit të EULEX-it për monitorimin e drejtësisë të vitit 2022, paraburgimi para ngritjes së aktakuzës (që shënon përfundimin e hetimeve paraprake) zakonisht ka zgjatur rreth një vit, ku aktakuzat shpesh ishin ngritur pak para skadimit të afatit 12-mujor (i përcaktuar nga neni 187 i KPP). EULEX-i ka vërejtur një përmirësim të lehtë në prioritizimin e hetimeve paraprake për të dyshuarit e paraburgosur. Nga nëntori 2022 deri në qershor 2024, periudha mesatare e paraburgimit para ngritjes së aktakuzës është ulur nga rreth një vit në katër deri në nëntë muaj dhe ka kaluar nëntë muaj vetëm në pak raste të jashtëzakonshme. Në përgjithësi, ka shenja të progresit në shkurtrimin e kohës së paraburgimit në pritje të ngritjes së aktakuzës, por përmirësimi ende nuk është konsistent në të gjitha rastet.

EULEX-i nxori rekomandime në vitin 2021, të cilat u përsëritën në vitin 2022, që kishin për qëllim përshtetimin e gjykimeve që ishin tejzgjatur. Konkretisht, GJTH të Mitrovicës i është kërkuar që të përshtetojë procedurat në *rastin Drenica I* dhe *rastet* e mbetura *Vukotić*, ndërsa GJTH të Prizrenit i është këshilluar që t'i japë prioritet rigjyqimit të *rastit Remzi Shala*. Zbatimi i këtyre rekomandimeve ka hasur në sfida si dhe suksese. Fillimisht, rigjykimi i *rastit Remzi*

61 Në vitin 2023, PSRK-ja paditi rreth 70 persona, që është një numër më i madh se vitet 2018-2022 së bashku.



*Shala* përfundoi në mesin e vitit 2023 në shkallën e parë, dhe aktgjykimi u vërtetua nga Gjykata e Apelit (GJA) në dhjetor 2023. Kjo zgjidhje e suksesshme shënoi një progres të rëndësishëm në adresimin e një prej rasteve të gjata në lidhje me krimet sipas së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, GJTH e Mitrovicës nuk e përshpejtoi gjykimin e *rastit Drenica I* dhe rasteve të shumta *Vukotić*. Në anën pozitive, si rezultat i kësaj inercie, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka ndërhyrë duke i bartur këto, dhe raste të tjera në pritje të cilat ishin ish-raste të EULEX-it, në GJTH të Prishtinës<sup>62</sup>. Ky transferim u konsiderua i nevojshëm nga KGJK për të ndërprerë bllokimin dhe për të mundësuar fillimin e gjykimeve që kishin stagnuar që nga viti 2018. *Rasti Drenica I*, i cila u ri caktua për 12 prill 2024, u përfundua pas vetëm dy seancave, me një aktgjykim që liroi nga akuza të pandehurit i shpallur më 25 prill 2024. Ky rezultat, megjithëse kontrovers, përfaqëson një moment historik të rëndësishëm në zgjidhjen e një rasti që kishte mbetur i pazgjidhur për një periudhë të gjatë kohore. Ndryshe prej kësaj, GJTH e Prishtinës nuk ka caktuar asnjë seancë në *rastet Vukotić*, indikacion i sfidave të vazhdueshme në ndarjen e drejtësisë me kohë.

Janë ndërmarrë përpjekje për të rritur kompetencën gjyqësore për trajtimin e rasteve të krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe çështjeve të ndërlidhura. Akademia e Drejtësisë dhe Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë organizuan së bashku sesione trajnimi gjithëpërfshirëse për krimet ndërkombëtare në vitin 2022 dhe 2023. Këto sesione ishin të përshtatura për gjyqtarët dhe prokurorët nga nivele të ndryshme të gjyqësorit, ku përfshiheshin gjykatat themelore dhe shkallët më të larta. Programi i trajnimit u fokusua në krimet ndërkombëtare, përmes ofrimit të informacionit mbi elementet që përbëjnë këto krime, sigurimit të një kuptimi të plotë të nevojshëm për gjykimin e rasteve të tilla komplekse dhe ofrimit të analizave të thella të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit. Temat si gjykimet në mungesë dhe përgjegjësia komanduese u trajtuan gjithashtu në mënyrë gjithëpërfshirëse. Duke nxitur një mjedis mësimor bashkëpunues, gjyqtarët dhe prokurorët patën mundësinë të avanconin të kuptuarit e tyre për parimet ligjore dhe aplikimin e tyre në praktikë.

## Konkluzione

Progres i konsiderueshëm është arritur, me përparime të dukshme në punën hetimore të PK-së dhe ristrukturimin e NJHKL në drejtori të dedikuar. Problemi me rastet e stagnuara në GJTH të Mitrovicës është adresuar me transferimin e tyre në GJTH të Prishtinës. Përveç kësaj, Akademia e Drejtësisë ka organizuar seminare trajnimi mbi krimet ndërkombëtare për gjyqtarë dhe prokurorë, dhe hetimet që përfshijnë të dyshuarit në paraburgime kanë shënuar një përshpejtim, edhe pse jo në mënyrë uniforme. Megjithatë, ende mbeten sfida thelbësore. Ndërsa ulja e kohës mesatare që të pandehurit e kalojnë në paraburgim është një zhvillim pozitiv, është shumë herët për të përcaktuar nëse kjo paraqet trend të qëndrueshëm. Vlen të përmendet se është e pamundur të shihet i njëjti përmirësim në të gjitha rastet, pasi disa janë sfiduese si për nga aspekti faktik ashtu edhe ai juridik. Qëllimi nuk është t'i jepet përparësi shpejtësisë para cilësisë, por të gjendet ekuilibri i duhur ndërmjet të siguarit që periudhat e paraburgimit në pritje të ngritjes së aktakuzave të zgjasin sa më shkurt që është e mundur dhe të sigurohet që hetimet të kryhen në tërësi. Monitorimi i vazhdueshëm dhe respektimi më i rreptë i rekomandimit janë të domosdoshme për të siguruar që PSRK të arrijë rezultatet e dëshiruara në shkurtimin e kohës së kaluar në paraburgim. Përshpejtimi i mëtejshëm i hetimeve dhe gjykimeve, veçanërisht ato që përfshijnë të pandehurit në paraburgim, është jetik për të siguruar një gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme. Zgjerimi i Departamentit të krimeve të luftës në PSRK dhe rritja e bashkëpunimit rajonal me Serbinë janë fusha kritike që ende kanë nevojë për vëmendje.

PSRK së fundmi ka zgjidhur çështjen e mungesës së personelit të Departamentit të Krimeve të Luftës me emërimin e dy prokurorëve shtesë. Me numrin aktual prej pesë prokurorëve,

<sup>62</sup> Vendimi i KGJK-së GJA nr. 28/06.02.2024.

Departamenti pritet të përforcojë kapacitetin e tij për trajtimin më efektiv të rasteve të krimeve të luftës.

Përprojekjet e vazhdueshme janë thelbësore për të vazhduar me këtë momentum dhe për të arritur progres të mëtejshëm. Rruga përpara nuk kërkon vetëm adresimin e sfidave logjistike dhe operacionale të menjëhershme, por kërkon edhe nxitjen e një mjedisi më të gjerë të bashkëpunimit rajonal dhe vullnetit politik.

## 3.2. Dhuna në baza gjinore

### Sfondi

Përprojekje të konsiderueshme për të shtyrë përpara luftën kundër dhunës në baza gjinore (DHBGJ) janë ndërmarrë nga institucione të ndryshme në Kosovë. Kodi i ri Penal (KP) ka hyrë në fuqi në vitin 2019. Ai e kategorizon dhunën në familje si vepër penale të veçuar dhe gjithashtu përcakton që kur një vepër është kryer brenda një marrëdhënieje familjare, kjo konsiderohet një rrethanë rënduese për caktimin e dënimit<sup>63</sup>. Për më tepër, në vitin 2019, është krijuar një databazë ndër-institucionale për dhunën në familje me qëllim të përmirësimit të trajtimit të rasteve të dhunës në familje, përmirësimit të mbledhjes së të dhënave dhe sigurimit të llogaridhënies, duke pasur parasysh se institucionet përkatëse në Kosovë janë të obliguara të regjistrojnë informacionin e nevojshëm në bazën e të dhënave. Në vitin 2019, Gjykata Kushtetuese dha mundësinë për të ndryshuar Kushtetutën e Kosovës për të njohur zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të *Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje*, e njohur si *Konventa e Stambollit*. Në shtator të vitit 2020, pas votimit unanim nga Kuvendi i Kosovës, *Konventa e Stambollit* u përfshi në nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës. Pas kësaj, *Strategjia nacionale për mbrojtjen kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave 2022-2026* u miratua në janar 2022 dhe *Ligji i ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhunën ndaj grave dhe dhunën në baza gjinore*<sup>64</sup> u miratua në vitin 2023 me qëllim harmonizimin e kornizës ligjore të brendshme me kërkesat e përcaktuara në *Konventën e Stambollit*.

EULEX-i ka monitoruar zbatimin e rekomandimeve të përmendura në Raportet e monitorimit të drejtësisë të viteve 2020, 2021 dhe 2022. Rekomandimet mund të ndahen në shtatë kategori të ndryshme: (1) legjislacioni; (2) funksionimi i databazës ndër-institucionale të dhunës në familje; (3) bashkëpunimi ndërmjet policisë dhe prokurorisë për rastet e dhunës në familje/rastet e dhunës seksuale; (4) nxjerrja e një protokolli shtetëror për rastet e dhunës seksuale; (5) prezantimi i një linje ndihmëse SOS; (6) trajtimi i rasteve të bashkësive jashtëmartesore; dhe (7) përdorimi i qasjes të bazuar në viktima në rastet e DHBGJ.

Përcjellja e shumicës së rekomandimeve të EULEX-it bazohet në nivelin e efikasitetit gjatë hetimeve të rasteve të DHBGJ, vlerësimit të legjislacionit përkatës, procedurave standarde të operimit, dhe përmes diskutimeve me hetues dhe prokurorë.

### Rekomandimet e dhëna nga EULEX-i

- ✓ Të gjitha institucionet relevante duhet të kontribuojnë në bazën e të dhënave të rasteve të dhunës në familje siç është paraparë; burimet teknike dhe njerëzore të nevojshme për realizimin e kësaj detyre duhet të vihen në dispozicion.

63 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 248, [A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf](https://rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2691&langid=2) (rks.gov.net) (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

64 Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna kundër grave dhe dhuna me bazë gjinore, Nr. 08/L-185, 12 tetor 2023, <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2691&langid=2> (qasja e fundit më 20 shtator 2024).



- ✓ Komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet policisë dhe prokurorisë duhet të përmirësohet.
- ✓ Qeveria e Kosovës dhe palët e tjera përkatëse (Policia e Kosovës, prokuroria, gjykatat, Zyrat për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave, Qendrat për mirëqenie sociale) duhet të vazhdojnë me zbatimin e *Strategjisë nacionale për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026*.
- ✓ Grupi punues i ngarkuar me hartimin e *Protokollit për referimin e rasteve të dhunës seksuale* duhet të sigurojë finalizimin me kohë të tij dhe të gjitha masat duhet të vihen në vend nga institucionet përkatëse (Policia e Kosovës, prokuroritë, gjykatat, Zyrat për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave, Qendrat për mirëqenie sociale, Instituti i mjekësisë ligjore, Ministria e drejtësisë, Ministria e shëndetësisë dhe Ministria e punëve të brendshme) për zbatimin e menjëhershëm të tij.
- ✓ Autoritetet e zbatimit të ligjit dhe ato gjyqësore duhet të përfshijnë më tej qasjen e bazuar në viktima dhe të minimizojnë numrin e intervistave nga ofruesit e ndryshëm të shërbimeve të viktimave të veprave të shkeljeve të integritetit seksual, gjë që mund të përforcojë traumën e përjetuar nga viktimat.
- ✓ Nën mbikëqyrjen e Zyrës së koordinatorit nacional kundër dhunës në familje, ofruesit e shërbimeve të përgjithshme dhe të specializuara (Policia e Kosovës, Zyrat për mbrojtje dhe ndihmë viktimave dhe OJQ-të) duhet të rrisin shtrirjen e shërbimeve online në dispozicion të viktimave, si linja aktuale telefonike e ndihmës.
- ✓ Komisioni i Kuvendit të Kosovës për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, persona të zhdukur dhe peticione duhet të finalizojë draftin e *Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhunën ndaj grave dhe dhunën në baza gjinore*.
- ✓ Ministria e punëve të brendshme, Ministria e drejtësisë, Zyra e koordinatorit nacional kundër dhunës në familje dhe Qendrat për mirëqenie sociale duhet të organizojnë fushata informuese për të trajtuar bashkësinë jashtëmartesore me personat nën moshën 16 vjeçare. Fushatat duhet të synojnë popullatën e re dhe prindërit e tyre, veçanërisht në rajonet e thella të Kosovës dhe me komunitetet me më pak qasje në informacione me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit për fenomenin dhe pasojat e mundshme si për viktimat ashtu edhe për kryerësit e veprave.
- ✓ Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet të zhvillojë dhe zbatojë udhëzues të unifikuar për Policinë e Kosovës veçanërisht për hetimin e krimit të bashkëjetesës jashtëmartesore me persona nën moshën 16 vjeçare.
- ✓ Policia e Kosovës duhet të hetojë dhe ndjekë përgjegjësinë penale sipas dispozitave ligjore të prindërve të përfshirë në bashkësinë jashtëmartesore të fëmijëve të tyre.

## Zbatimi


Në shumë mënyra, zbatimi i *Konventës së Stambollit* ka pasur një ndikim pozitiv jo vetëm në legjisllacionin përkatës në Kosovë, por edhe në hetimet e rasteve të DHBGJ.

*Strategjia nacionale për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026* është miratuar në janar 2022, dhe *Protokollit për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale* në nëntor 2022. Në tetor 2022, një draft i *Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore* i është propozuar Kuvendit të Kosovës dhe përfundimisht është miratuar dhe ka hyrë në fuqi në tetor 2023. Ai mbulon aspekte të ndryshme të rekomandimeve të bëra më parë nga EULEX-i dhe pasqyron frymën e *Konventës së Stambollit*. Faza tjetër për Qeverinë e Kosovës, e cila në momentin e shkrimit të këtij raporti tashmë ka filluar me hartimin e akteve nënligjore përkatëse, është rishikimi i politikave përkatëse dhe procedurave standarde të operimit që duhet të përditësohen për të qenë në përputhje me ligjin e ri.

Statistikat e mëposhtme, të ofruara për EULEX-in nga Policia e Kosovës (PK), ilustrojnë trendin e rasteve të dhunës në familje në Kosovë (PK-ja nuk mban të dhëna të ndara sipas gjinisë për viktimat e mitura). Shifrat tregojnë se rastet e raportuara janë rritur në mënyrë të qëndrueshme nga viti 2019 deri në vitin 2022, për të dëshmuar më pas një rënie në vitin 2023. Ky raport përfshin të dhëna deri në maj 2024. Në periudhën janar – maj 2024, numri i viktimave të dhunës në familje ishte 1287, nga i cili 1010 ishin femra dhe 277 ishin meshkuj nga gjithsej 1224 raste të dhunës në familje. Meqenëse dhuna në familje mbetet lloj i krimit të nën-raportuar në mbarë botën, është e vështirë të formohet një opinion për arsyet e sakta të këtyre lëvizjeve. Rritja apo ulja e besimit të qytetarëve tek policia dhe institucionet e tjera ofruese të shërbimeve mund të jetë një arsye, si dhe ndërjegjësimi i shtuar për mekanizmat ekzistues të raportimit, por edhe mundësia e uljes *de facto* të ndodhjes së rasteve të dhunës në familje.



## Numri i viktimave femije te moshes 0-18 - Trendi



Siç është thënë nga EULEX-i në të kaluarën, regjistrimi i të dhënave në databazën ndërinstitucionale të rasteve të dhunës në familje nuk ka qenë plotësisht efektiv. Më parë, kërkesa për regjistrimin e të dhënave në databazë bazohej në një memorandum mirëkuptimi ndërmjet palëve të ndryshme<sup>65</sup>. Përdorimi i bazës së të dhënave është i rregulluar me nenin 61 të *Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore* dhe Ministria e drejtësisë ka për obligim financimin, mirëmbajtjen dhe analizimin e të dhënave. Edhe pse të dhënat e futura janë rritur ndjeshëm falë numrit të përdoruesve që fusin të dhëna dhe masave dhe aktivitetet e trajnimit të organizuara pas miratimit të strategjisë, jo të gjitha institucionet përkatëse po kontribuojnë aktualisht me të dhëna në të<sup>66</sup>. Vlen të theksohet se gjatë gjithë ekzistencës së bazës së të dhënave, Policia e Kosovës ka qenë i vetmi institucion që ka futur plotësisht të dhënat siç kërkohet.

Në një aspekt pozitiv, EULEX-i pranon se si baza e të dhënave ka krijuar themelet për përmirësimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet policisë dhe prokurorisë. Sipas nenit 71 të Kodit të Procedurës Penale (KPP)<sup>67</sup>, sapo policia të merr kërkesën për ndjekje penale nga pala e dëmtuar ose të njoftohet se një vepër penale që mund të ndiqet penalisht sipas detyrës zyrtare (pa kërkesë nga pala e dëmtuar) është kryer, tentuar, është duke ndodhur ose do të kryhet së shpejti, policisë i kërkohet që menjëherë të njoftojë prokurorinë dhe ajo ka për detyrë të japë raportin policor brenda 72 orëve, duke e shënuar këtë në bazën e të dhënave. Hetuesit në njësitë rajonale të policisë për hetimin e dhunës në familje, të cilët janë përdoruesit faktikë të bazës së të dhënave, u konfirmuan ekspertëve të EULEX-it, gjatë monitorimit të

65 Memorandumi i mirëkuptimit është nënshkruar mes Ministrit të drejtësisë, Ministrit të punës dhe mirëqenies sociale, Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Drejtorit të Policisë së Kosovës.

66 Në Raportin vjetor 2023 për zbatimin e strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit, Ministria e Drejtësisë ka deklaruar se numri i përdoruesve të bazës së të dhënave është rritur në 497 dhe se Ministria është në proces të ndërlidhjes së bazave të të dhënave, për qëllim të mundësisë për gjenerimin e të dhënave për rastet e dhunës në familje nga sistemi gjyqësor (SIML).

67 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, neni 71, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759> (qasja e fundit më 20 shtator 2024).



thuktë të hetimeve, se bashkëpunimi me prokurorinë ishte bërë automatik dhe rrjedhimisht i drejtpërdrejtë, për shkak të detyrimeve prej bazës së të dhënave.

Në vitin 2022, me mbështetjen e EULEX-it, *Protokolli për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale* u finalizua dhe u prezantua. Niveli i zbatimit të tij është ende duke u vlerësuar.

Sipas nenit 23 të *Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore*<sup>68</sup> duhet të ekzistojë një linjë telefonike emergjente e cila ofron informacion të saktë, në kohë, konfidencial për mbrojtjen e viktimave, shërbimet në dispozicion të viktimave dhe këshillimin telefonik për viktimat të dhunës në familje, dhunës në baza gjinore dhe dhunës ndaj grave në çdo kohë të ditës. Në momentin e shkrimit të këtij raporti, EULEX-i është duke mbështetur grupin punues të krijuar nga Ministria e drejtësisë për hartimin e aktit nënligjor përkatës për funksionalizimin e linjës telefonike emergjente. Aktualisht, burimet në dispozicion janë të njëjta si para miratimit të ligjit të ri: si PK ashtu edhe Zyra për mbrojtje dhe ndihmë viktimave mund të kontaktohet falas me telefon në çdo kohë<sup>69</sup>.

EULEX-i në raportet e mëparshme ka bërë thirrje që policia të jetë më e trajnuar dhe e pajisur për të qenë në gjendje të zbatojë një qasje gjithëpërfshirëse të bazuar në viktimat. Raporti i EULEX-it i monitorimit të drejtësisë i vitit 2021 përcaktoi se organet e zbatimit të ligjit dhe autoritetet gjyqësore duhej të përfshinin më tej qasjen e bazuar në viktimat dhe të minimizonin numrin e intervistave të viktimave të veprave të shkeljeve të integritetit seksual nga ofruesit e ndryshëm të shërbimeve, pasi kjo mund të përforcojë traumën e përjetuar nga viktimat (riviktimizimi). Mund të vërehet një përmirësim i caktuar. Në stacionet policore anembanë Kosovës u krijuan më shumë dhoma intervistimi me viktimën në qendër. Ndërmjet viteve 2022 dhe 2023, dhjetë dhoma të tilla u themeluan nga KFOR-i, në përputhje me standardet e zhvilluara bashkërisht nga OSBE-ja dhe EULEX-i. Pas themelimit, PK-së iu ofruan sesione të përbashkëta trajnimit nga OSBE-ja dhe EULEX-i për shfrytëzimin efektiv të këtyre dhomave të intervistave. Këto dhoma synojnë të ofrojnë një hapësirë të sigurt për viktimat e dhunës intime (DHBG), abuzim të fëmijëve, vepra seksuale dhe dhunë në familje) duke u mundësuar atyre të japin deklaratat e tyre në mënyrë private, brenda një mjedisi jo kërcënues. Deri në mesin e tetorit 2024, numri i përgjithshëm i dhomave të intervistimit me viktimën në qendër u rrit në 28 (nga gjithsej 41 stacione policore në mbarë Kosovën). Në të njëjtën kohë, megjithatë, kërkesat e nenit 56(1)(i) të *Konventës së Stambollit*<sup>70</sup> nuk janë vënë në praktikë në sistemin gjyqësor të Kosovës. Shumë, nëse jo shumica, nga gjykatat nuk kanë pajisje të mjaftueshme për atë lloj procesi gjyqësor. Nga monitorimi i seancave gjyqësore, EULEX-i ka vërejtur se viktimat, madje edhe të miturit, po silleshin në gjykatë për të dëshmuar në prani të kryerësit (kryerësve) të veprave. Kjo shpeshherë është justifikuar me mungesën e pajisjeve audio/video.

Në raportin e tij të monitorimit të drejtësisë 2022, EULEX-i trajtoi çështjen e bashkësisë jashtëmartesore në Kosovë. Sipas Kodit Penal (KP), bashkësia jashtëmartesore me një person nën moshën 16 vjeçare konsiderohet vepër penale dhe dënohet me burgim nga pesë deri në 20 vjet. Nëse viktimat janë nën moshën 14 vjeçare, dënimi është së paku 10 vjet burgim<sup>71</sup>. Përveç kësaj, marrëdhëniet seksuale me një person nën moshën 16 vjeçare konsiderohen dhunim seksual; moshja e pëlqimit për marrëdhënie seksuale është 16 vjeç<sup>72</sup>. Në KP të ri të vitit 2019, neni që ka të bëjë me bashkësinë jashtëmartesore nuk është modifikuar ndjeshëm

68 Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore, Nr. 08/L -185, 12 tetor 2023, neni 23, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2691&langid=2> (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

69 Numri i telefonit të PK-së: 192. Numri i telefonit të Zyrës për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave: 080011112

70 Viktimat duhet të mbrohen duke u mundësuar atyre që 'të dëshmojnë, sipas rregullave të parashikuara nga ligjet dhe rregulloret e vendit, në sallën e gjyqit pa qenë të pranishëm ose të paktën pa praninë e autorit të supozuar, veçanërisht duke përdorur teknologjitë e duhura të komunikimit, kur është e mundur'.

71 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 240, [A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf](https://rks-gov.net/A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf) (rks-gov.net) (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

72 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 225, paragrafi 1 nën paragrafin 1.1. dhe 1.2., [A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf](https://rks-gov.net/A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf) (rks-gov.net) , (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

në krahasim me versionet e mëparshme<sup>73</sup>. Sipas KP të vjetër dhe atij të ri, prindërit që lejojnë ose nxisin lidhjen jashtëmartesore me një të mitur janë penalisht përgjegjës. I vetmi ndryshim i paraqitur në KP të ri ka të bëjë me dënimin: në KP të ri, dënimi minimal për prindin ose prindin adoptues, kujdestarin ose personin tjetër që ushtron autoritetin prindëror që lejon ose nxit një person nën moshën 14 vjeçare për të bashkëjetuar në bashkësi jashtëmartesore, është dënimi me burgim me kohëzgjatje dhjetë vjet<sup>74</sup>, krahasuar me dënimin me burgim me kohëzgjatje me pesëmbëdhjetë vjet burgim në Kodin Penal të mëparshëm<sup>75</sup>.

Si KP i vjetër ashtu edhe ai i ri përcaktojnë se prindërit, prindërit adoptues, kujdestarët ose personat e tjerë që ushtrojnë autoritetin prindëror, të cilët lejojnë ose nxisin një person nën moshën 14 vjeçare të bashkëjetojë në bashkësi jashtëmartesore, janë penalisht përgjegjës. I vetmi ndryshim midis dy versioneve të KP në këtë fushë është dënimi minimal, i cili në KP të ri është burgim me dhjetë vite, krahasuar me burgimin me 15 vite në KP të vjetër.

Në raportet e mëparshme të monitorimit të drejtësisë EULEX-i rekomandoi krijimin e udhëzuesve të unifikuar për policinë për të hetuar krimin e bashkëjetesës jashtëmartesore me personat nën moshën 16 vjeçare. Një rekomandim tjetër ishte hetimi dhe ndjekja e përgjegjësive penale të prindërve të përfshirë në bashkësinë jashtëmartesore të fëmijëve të tyre në përputhje me nenin 240 paragrafi 2 të Kodit Penal. EULEX-i gjithashtu rekomandoi që të zhvillohen fushata informuese për të trajtuar bashkësinë jashtëmartesore me një person nën moshën 16 vjeçare, duke rritur ndërgjegjësimin për natyrën e paligjshme të këtij fenomeni. Këto rekomandime nuk janë zbatuar. Nuk ka pasur asnjë fushatë informuese, as nuk janë krijuar udhëzues në përputhje me rekomandimet e EULEX-it. Prindërit janë ndjekur penalisht në përputhje me nenin 240, paragrafi 2 të KP-së vetëm në shumë pak raste.

### Konkluzione

Në Kosovë është bërë shumë për luftimin e dhunës ndaj grave dhe DHBGJ që nga publikimi i raportit të EULEX-it nga monitorimi i drejtësisë i vitit 2020. Kosova ka bërë përpjekje të konsiderueshme për zbatimin e kërkesave në përputhje me *Konventën e Stambollit*. Një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse tashmë është krijuar. Faza tjetër është përgatitja dhe aplikimi i akteve të nevojshme nëligjore dhe procedurave standarde të operimit, si dhe ndarja e fondeve dhe burimeve të nevojshme për zbatimin efektiv të *Strategjisë nacionale për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026* dhe *Ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore*.

### 3.3 Privatizimi dhe likuidimi

#### Sfondi

Në raportet e tij të monitorimit të drejtësisë 2020, 2021 dhe 2022, EULEX-i ka monitoruar punën e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (DHPGJS), e cila vepron në kuadër të Gjykatës Supreme dhe ka juridiksion ekskluziv mbi të gjitha rastet që kanë të bëjnë me vendimet, aktivitetet dhe performancën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP). DHPGJS gjithashtu ka juridiksion në procesin e privatizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve apo korporatave,

73 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 240, [A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf \(rks-gov.net\)](#) (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

74 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 240 paragrafi 3, [A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf \(rks-gov.net\)](#) (qasur për herë të fundit më 20 shtator 2024).

75 Kodi Penal, Nr. 04/L-082, 13 korrik 2012, neni 247, paragrafi 3, 2. [FAQET ANGLISHT.cdr \(rks-gov.net\)](#) (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

duke përfshirë paditë e ish-punonjësve dhe në lidhje me pronat nën administrimin e AKP-së. Shqetësimi kryesor i vërejtur gjatë viteve ishte numri i lëndëve të pazgjdhura në pritje pranë DHPGJS-së, dhe të gjitha Rekomandimet e dhëna nga EULEX-i kishin për qëllim zvogëlimin e këtij numri. Një shqetësim specifik i raportuar në raportin e monitorimit të drejtësisë të vitit 2021 kishte të bënte me faktin shqetësues se DHPGJS-ja ishte ende duke u marrë me rastet në të cilat AKP-ja si paditëse kishte kërkuar anulimin e aktgjykimeve të formës së prerë të gjykatave të rregullta. Kjo e ekspozon DHPGJS-në para një barre të panevojshme, pasi që këto raste veçse ishin gjykuar dhe nuk mund të ndiqeshin më tej (*'res judicata'*), duke çuar në refuzimin e padive nga DHPGJS si të pabazuara.

### Rekomandimet e dhëna nga EULEX-i

- ✓ Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) duhet të vendosë një normë që përcakton numrin minimal të lëndëve që duhet të finalizohen nga secili gjyqtar brenda një afati kohor të caktuar.
- ✓ DHPGJS duhet të miratojë një strategji afatgjatë për të zvogëluar numrin e lëndëve të pazgjdhura në pritje. Strategjia, për shembull, duhet të përcaktojë kritere prioritare dhe të identifikojë burimet e nevojshme për pastrimin e lëndëve të pazgjdhura në pritje.
- ✓ Duhet të merret parasysh punësimi i zyrtarëve shtesë për mbështetje ligjore.
- ✓ KGJK-ja duhet të fuqizojë kapacitetin e DHPGJS për përkthim dhe interpretim në gjuhën serbe, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se shumica e rasteve gjyqësore kanë palë serbe të përfshira.
- ✓ DHPGJS-ja duhet të instalojë, si të gjitha gjykatat e tjera në Kosovë, Sistemin Informativ të Menaxhimit të Lëndëve (SIML) për të qenë më efikase.
- ✓ AKP-ja duhet të ndërpresë praktikën e kërkesës për anulimin e aktgjykimeve të formës së prerë të gjykatave të rregullta, duke mos marrë parasysh faktin se paditë e tilla janë të pabazuara për shkak të faktit se janë *res judicata*.

### Zbatimi

Një normë që përcakton numrin minimal të lëndëve që duhet të finalizohen nga çdo gjyqtar brenda një afati të caktuar kohor shërben për të zvogëluar numrin e lëndëve të pazgjdhura në pritje dhe për të përmirësuar cilësinë e planifikimit dhe planifikimit kohor në gjykata. Ajo mund të përdoret gjithashtu si një mjet për vlerësimin e gjyqtarëve.

Në aspektin pozitiv, KGJK-ja më 6 prill 2023 ka nxjerrë në këtë drejtim Rregulloren nr. 03/2023 për ngarkesën e lëndëve (normat) për gjyqtarë, e cila është e aplikueshme për gjyqtarët në të gjitha gjykatat e Kosovës. Vlerat numerike janë 100 pikë në muaj ose 1100 pikë në vit, ndërsa pikët jepen sipas kompleksitetit të lëndës, duke pasur parasysh natyrën e rastit dhe kohën mesatare të nevojshme për zgjidhjen e saj. Ndërsa sistemi i dhënies së pikëve ngriti disa shqetësime nga gjyqtarët e DHPGJS-së (për shembull, gjyqtarëve të DHPGJS-ve u ndahen tetë pikë për një lëndë pronësore, ndërsa gjyqtarët në gjykatat themelore dhe në Gjykatën Ekonomike marrin 12 respektivisht 15 pikë për të njëjtin lloj rasti), në përgjithësi është një mjet i mirë për të nxitur gjyqtarët që të jenë më produktiv. Gjithashtu, ky mund të jetë një mjet i dobishëm për monitorimin e vonësive të paarsyeshme në gjykime dhe, në përgjithësi, të mbështesë përmirësimin e funksionimit të administrimit gjyqësor dhe perceptimin e sistemit gjyqësor në tërësi. Megjithatë, ishte shumë herët për të vlerësuar ndikimin në një kohë relativisht të shkurtër pas fillimit të aplikimit të kësaj rregulloreje.

Rekomandimi për miratimin e një strategjie gjithëpërfshirëse afatgjatë për pastrimin e lëndëve të pazgjdhura në pritje nuk u ndoq. DHPGJS-ja ende zbaton një strategji shumë të thjeshtë për zgjidhjen e lëndëve të pazgjdhura duke i dhënë përparësi kryesisht rasteve të vjetra (çdo

rast i paraqitur para datës 31 dhjetor 2014 konsiderohet i vjetër). Hapat e prioritizimit janë verifikimi i pronësisë, rastet e privatizimit dhe së fundi rastet e statusit dhe rastet e kthyer për rigjykim. Një strategji gjithëpërfshirëse duhet të kishte përfshirë më shumë kriteret prioritizimi dhe gjithashtu të identifikonte burimet e nevojshme për zgjidhjen e lëndëve të pazgjidhura në pritje.

Sa i përket rekomandimit për të punësuar më shumë staf ndihmës ligjor, DHPGJS-së i është siguruar më shumë staf mbështetës në vitin 2023 dhe për këtë arsye ky rekomandim mund të konsiderohet i zbatuar. Me mbështetjen e KGJK-së, DHPGJS-së iu siguruan edhe 16 zyrtarë të rinj ligjor. Këta zyrtarë ligjor janë të vendosur kryesisht në zyrat e gjyqtarëve, katër janë të angazhuar në shkrimore. Po ashtu, KGJK-ja miratoi edhe punësimin e më shumë gjyqtarëve në DHPGJS për vitin 2024.

Rekomandimi për fuqizimin e kapacitetit të përkthimit dhe interpretimit në gjuhën serbe nuk është zbatuar dhe DHPGJS aktualisht ka vetëm dy përkthyes/interpretë, gjë që është e pamjaftueshme.

Sa i përket SIML-it, regjistrimi i lëndëve të Kolegjit të Apelit ka filluar, ndërsa regjistrimi i lëndëve të shkallës së parë është duke shkuar mirë. Është ende shumë herët për të vlerësuar nivelin e zbatimit dhe për të nxjerrë përfundime se deri në çfarë mase është përmirësuar efikasiteti i DHPGJS-së si rezultat i këtyre masave.

Sa i përket rekomandimit që AKP-ja të ndërpresë praktikën e kërkesës për anulimin e aktgjykimeve të formës së prerë të gjykatave të rregullta, EULEX-i vërejti se raste të tilla ende ndodhin, gjë që u confirmua nga shkrimorja e DHPGJS-së dhe nga disa gjyqtarë të DHPGJS-së.

## Konkluzione

Në aspekt pozitiv, DHPGJS-ja ka marrë mbështetjen e kërkuar nga KGJK-ja në drejtim të punësimit të më shumë stafit mbështetës ligjor. Gjithashtu, SIML është prezantuar në DHPGJS dhe ka filluar të funksionojë. Megjithatë, është ende herët për të vlerësuar ndikimin e tij. Një zhvillim tjetër pozitiv ka qenë aplikimi i një norme për gjyqtarët, e cila është e zbatueshme për të gjithë gjyqtarët dhe gjykatat, jo vetëm për DHPGJS-në. Megjithatë, nuk është zhvilluar një strategji afatgjate për zgjidhjen e lëndëve të pazgjidhura në pritje dhe DHPGJS-së ende i mungojnë burimet e nevojshme për përkthim/interpretim. Është shqetësuese që AKP-ja ende zbaton praktika të cilat krijojnë ngarkesë të panevojshme mbi DHPGJS.

### *3.4. Të drejtat pronësore – Mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë dhe detyruese në kundërshtim me të drejtat pronësore*

#### Sfondi

Në raportin e tij të monitorimit të drejtësisë të vitit 2021, EULEX-i raportoi për çështjen e mosekzekutimit të vendimeve dhe aktgjykimeve të nxjerra nga (1) Komisioni i Kosovës për Kërkesa Pronësore (KKKP); (2) Kolegji i ankesave i Gjykatës Supreme për ish-Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) dhe (3) Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Këto raste kishin të bënin me paditësit të cilët kishin të drejtë të kërkonin nga Agjencia Kosovare e Krahasimit dhe Verifikimit të Pronës (AKKVP) rrënimin e objekteve të paligjshme që janë ndërtuar në tokën e tyre, pasi të kenë marrë vërtetimin e titullarit ligjor në pronat e paluajtshme.

Në vitin 2016, Gjykata Kushtetuese konstatoi se mosekzekutimi nga AKP-ja i vendimeve të KKKP-së dhe Kolegjit të ankesave të AKP-së përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës, lidhur me nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Si Kushtetuta ashtu edhe KEDNJ-ja njohin të drejtën për gjykim të drejtë, e cila nuk ishte siguruar,

duke qenë se mosekzekutimi i këtyre vendimeve përbënte dështim për ekzekutim të vendimeve të formës së prerë dhe detyruese<sup>76</sup>. Prandaj, Gjykata Kushtetuese në atë kohë pati qëndrimin se të gjitha vendimet në pritje duhej të ekzekutoheshin nga AKP-ja, paraardhësi i AKKVP. Në kohën e raportimit, në vitin 2021, AKKVP kishte arritur të finalizojë me sukses vetëm një rast në të cilin është kërkuar rrënimi. Në këtë rast, u deshëm 11 vite nga fillimi i procedurës së ekzekutimit deri në ekzekutimin përfundimtar të aktgjykimit. Një numër prej 54 rasteve të tjera, kryesisht të lidhura me tokën në pronësi të serbëve të Kosovës, ishin ende në pritje të rrënimit në vitin 2021. AKKVP e informoi EULEX-in në atë kohë se një nga arsyt kryesore për këtë vonesë ishte mungesa e buxhetit për të kryer rrënimet dhe se i gjithë buxheti i AKKVP për qëllime të rrënimeve u absorbua vetëm nga rrënimi i lartpërmendur në vitin 2021.

### Rekomandim i nxjerrë nga EULEX-i

- ✓ Më shumë fonde duhet t'i ndahen AKKVP-së qëllime të rrënimit të ndërtimeve pa leje, të cilat përbëjnë pengesën kryesore që bartësit e të drejtave pronësore të gëzojnë të drejtat e tyre.

### Zbatimi

EULEX-i është informuar se AKKVP-së nuk i janë ndarë fonde të tjera për qëllime të rrënimit dhe se rrjedhimisht nuk ka pasur asnjë rrënim gjatë gjithë këtyre viteve përveç një në Prizren. Në kohën e publikimit të raportit të monitorimit të drejtësisë të EULEX-it të vitit 2021, numri i rrënimeve në pritje ishte 54. Aktualisht numri i rrënimeve në pritje është 53. Sipas AKKVP, përveç mungesës së fondeve të dedikuara, arsye të tjera janë se palët janë ende në procedurë të ndërmjetësisimit apo se aplikuesit për prishje nuk kanë përmbushur detyrimin e tyre ligjor në bazë të Udhëzimit Administrativ për përcaktimin e procedurave për rrënimin e strukturave pa leje.

### Konkluzione

Është shqetësues fakti se kaq shumë individë të cilët kanë siguruar, me vendime të formës së prerë dhe detyruese, të drejtën për pronat e tyre ende nuk janë në gjendje të gëzojnë pronat e tyre për shkak të vonesave të vazhdueshme në rrënimin e strukturave të paligjshme në tokën e tyre. Për fat të keq, shqetësimi për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe detyruese ende qëndron në vitin 2024.

## 3.5. Drejtësia për të miturit: aplikimi i 'masave të diversitetit' për shkelësit e mitur

### Sfondi

Raporti i monitorimit të drejtësisë i EULEX-it i vitit 2022 vlerësoi zbatimin e 'masave të diversitetit' ndaj shkelësve të mitur. *Kodi i Drejtësisë për të Miturit (KDM)* ofron një sërë 'masash të diversitetit' që zgjidhen nga prokurori<sup>77</sup>. Raporti theksoi se përdorimi i 'masave të diversitetit' kishte pasur rënie të vazhdueshme nga viti 2019 në 2022. Bazuar në të dhënat e ndara sipas gjinisë të ofruara nga Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHSK), EULEX-i ka mundur të bënte një vlerësim të masave të aplikuara ndaj vajzave dhe djemve. Duke u bazuar në gjetjet, EULEX-i ka nxjerrë rekomandimet e paraqitura më poshtë.

<sup>76</sup> Aktgjykimi në lëndën nr. K 165/15 i datës 25 tetor 2016.

<sup>77</sup> Sipas nenit 20 të Kodit të drejtësisë për të mitur, masat e diversitetit që mund t'i shqiptohen të miturit janë pajtimi, kompensimi i dëmit, vijimi i rregullt i shkollës, pranimi i punësimit apo aftësisimit, kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme, edukimi për rregullat e trafikut, këshillimi, aktivitete bamirësie ose pagesë, angazhim në aktivitete sportive dhe rekreative, të përmbahen nga çdo kontakt me individë të caktuar, të mos vizitojnë vende të caktuara, të përmbahen nga përdorimi i drogës dhe alkoolit, ose vërejtja policore. Shih Kodin e drejtësisë për të miturit, Nr. 06/L-006, 18 tetor 2018, [B5AFE545-3908-4F63-98E0-A8DD593B499.pdf \(rks-gov.net\)](#) (qasja e fundit më 20 shtator 2024).



## Rekomandimet e dhëna nga EULEX-i

- ✓ Për të penguar efektet negative të procedurave pasuese në administrimin e drejtësisë për të mitur (për shembull, stigma e ndëshkimit dhe dënimit të shqiptuar), prokurorët dhe policia duhet të përdorin maksimalisht ‘masat e diversitetit’ siç parashikon ligji.
- ✓ ‘Masa e diversitetit’ e ‘vërejtjes policore’ duhet të aplikohet më shpesh në rastet që i plotësojnë kriteret e nevojshme.
- ✓ Duke marrë parasysh rezultatet e mira të arritura në vitet e kaluara, puna plotësuese aktuale e prokurorëve për të mitur dhe Shërbimit Sprovues të Kosovës (SHSK) duhet të vazhdojë të zhvillohet.
- ✓ Për të përfshirë çështjen gjinore në sistemin e drejtësisë për të miturit, përfshirë në aplikimin e ‘masave të diversitetit’, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) duhet të ndjekë shembullin e dhënë nga SHSK-ja dhe të përfshijë të dhëna të ndara sipas gjinisë në raportet e tij vjetore.

## Zbatimi

EULEX-i thekson pozitivisht se disa masa trajnimi për drejtësinë për të miturit dhe specifiku për masat e diversitetit janë organizuar nga akademia e drejtësisë. Përveç kësaj, EULEX-i ka organizuar disa punëtori për prokurorët për të mitur, gjatë të cilave si temë kryesore ishin shkëmbimi i përvojave dhe diskutimet në lidhje me aspekte të ndryshme të ‘masave të diversitetit’<sup>78</sup>.

Ndërsa një nga amendamentet kryesore të paraqitura në KDM të ri ishte zgjerimi i gamës së ‘masave të diversitetit’ në dispozicion, tetë masat shtesë nuk kanë pasur efektin e planifikuar në shqiptimin e ‘masave të diversitetit’. Siç është përcaktuar në raportin e monitorimit të drejtësisë 2022, shifrat për aplikimin e ‘masave të diversitetit’ kishin shënuar rënie me kalimin e viteve, trend i cili vazhdoi në vitin 2022 dhe 2023. Sipas raporteve vjetore të SHSK-së, 387 ‘masa të diversitetit’ janë aplikuar nga prokurorët për shkelësit e mitur në vitin 2022, krahasuar me vetëm 181 në 2023.

EULEX-i ka vërejtur se masa e preferuar e aplikuar nga prokurorët për të mitur ishte ndërmjetësimi<sup>79</sup>. Prandaj, zvogëlimi i numrit të ‘masave të diversitetit’ nuk nënkupton se prokurorët për të mitur nuk përdorin masa alternative ndaj të të miturve, por se ata shpesh zgjedhin një mjet tjetër efektiv të disponueshëm në KDM për të shmangur procedurat gjyqësore.

Me qëllim të promovimit të përdorimit të masës ‘vërejtja policore’ në përputhje me rekomandimet e paraqitura në raportin e monitorimit të drejtësisë 2022, EULEX-i ka punuar me prokurorët për të mitur për të zhvilluar një model standard. Një nga arsytet pse kjo masë specifike nuk u aplikua ishin shqetësimet e shprehura nga profesionistët në lidhje me aftësitë e pamjaftueshme ligjore të supozuara dhe mungesën e trajnimit të zyrtarëve policorë për aplikimin e masës. Për të adresuar këtë, u krijua një grup punues i përbërë nga prokurorë për të mitur nga departamente të ndryshme për të miturit për të krijuar një model që mund të përdoret nga policia. Ky projekt, i udhëhequr nga departamenti për të mitur në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës dhe EULEX-i, u ndërpre për një periudhë kohore për shkak të valës masive të dorëheqjeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë të Kosovës në vitin 2022. Projekti ka rifilluar dhe është ende në vazhdim. Deri më tani ka rezultuar me disa modele, të krijuara nga prokurorët për të mitur në Pejë. Një model është përdorur vetëm nga Policia e Kosovës në Deçan, pas marrëveshjes së tyre me prokurorinë në Pejë, pasi që në grupin punues ende nuk është arritur konsensus për modelet.

EULEX-i ka vërejtur se bashkëpunimi në mes të SHSK-së dhe prokurorëve për të mitur po funksionon mirë dhe se në shumicën e rasteve, prokurorët ndjekin masat e rekomanduara nga SHSK-ja.

<sup>78</sup> Në vitin 2023 u zhvilluan këto aktivitete: Tryezë: Harmonizimi i ndryshimeve të reja të Kodit të Procedurës Penale me dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Miturit, punëtori: Zbatimi i masave të diversitetit. Sfidat dhe pengesat në zbatimin e tyre, tryezë e rrumbullakët: vërejtja e policisë, procedura dhe formularët, trajtimi i rasteve nga policia.

<sup>79</sup> Kodi i Drejtësisë për të Miturit, Nr. 06/L-006, 18 tetor 2018, kapitulli II ‘Ndërmjetësimi’, [B5AFE545-3908-4F63-98E0-0A8DD593B499.pdf](https://www.rks-gov.net/B5AFE545-3908-4F63-98E0-0A8DD593B499.pdf) (rks-gov.net) (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

Si vlerësim më pak pozitiv është se, ende ka mungesë konsistence në raportet vjetore të SHSK-së. Ndërsa kjo e fundit filloi të përfshinte të dhëna të ndara sipas gjinisë në vitin 2020, gjë që vazhdoi në vitin 2021, informacioni nuk është më i disponueshëm në raportet vjetore të 2022 dhe mesit të 2023. Prandaj, është e vështirë të përdoren dhe të analizohen të dhënat për të bërë krahasime apo vlerësime përkatëse mbi perspektivën gjinore.

## Konkluzione

Trendi i rënies së përdorimit të ‘masave të diversitetit’, i theksuar në raportin e monitorimit të drejtësisë të EULEX-it 2022, ka vazhduar në vitet 2022 dhe 2023. Përderisa vërehet pozitivisht se ndërmjetësimi përdoret shpesh në drejtësinë për të miturit, EULEX-i u bënë thirrje policisë dhe prokurorëve që të përdorin në tërësi ‘masat e diversitetit’ në dispozicion. Për të mos anashkaluar perspektivën gjinore brenda drejtësisë për të mitur, si KPK ashtu edhe SHSK duhet të përfshijnë të dhëna të ndara sipas gjinisë në raportet e tyre vjetore përkatëse.

## 3.6 Administrata e gjykatës – Sistemi Informativ i Menaxhimit të Lëndëve (SIML)

### Sfondi

Pa Sistemin Informativ të Menaxhimit të Rasteve (SIML) nuk ka funksionim të mirëfilltë të administratës së gjyqësorit në Kosovë. SIML është bërë pjesë integrale e veprimtarisë së përditshme të gjykatave dhe administrata është mësuar të punojë me SIML në baza ditore. Të gjithë aktorët vendas dhe ndërkombëtarë kanë punuar shumë gjatë viteve të fundit për të funksionalizuar SIML në të gjitha nivelet. Policia, prokuroria, gjykatat themelore, si dhe të gjitha institucionet më të larta të drejtësisë, përfshirë Gjykatën Ekonomike, e cila u lidh me SIML kohëve të fundit, luajtën rol vendimtar në këtë proces, të mbështetur në thelb nga EULEX-i. Me qëllim të zhvillimit dhe përmirësimit të mëtejshëm të zbatimit të sistemit, EULEX-i nxori rekomandimet e mëposhtme në raportet e tij të monitorimit të drejtësisë 2021 dhe 2022.

### Rekomandimet e dhëna nga EULEX-i

- ✓ Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) duhet të sigurojë lidhje më të qëndrueshme të internetit në të gjitha gjykatat dhe degët.
- ✓ KGJK-ja, përmes ekipit të SIML, duhet të ofrojë trajnime shtesë për SIML të përshtatura për përdorues të caktuar.
- ✓ KGJK-ja duhet të konsiderojë krijimin e një sistemi të mbikëqyrjes së normave minimale të performancës për gjyqtarët duke përdorur SIML.
- ✓ Me mbështetjen e KGJK-së, gjykatat themelore duhet të sigurojnë një sistem të kujdestarisë gjatë fundjavave me staf të aftë për përdorimin e SIML.
- ✓ KGJK-ja dhe gjykatat duhet të sigurojnë që shërbimet e përkthimit dhe interpretimit të jenë më të organizuara dhe të disponueshme për palët në të gjitha gjykatat.
- ✓ KGJK-ja duhet të përmirësojë proceset e punësimit për gjykata, duke përfshirë planifikimin me kohë të zëvendësimit të gjyqtarëve që pensionohen.

### Zbatimi

Funksionimi i SIML varet nga lidhja e qëndrueshme e internetit. Një lidhje joadekuate e bën të vështirë funksionimin e këtij sistemi dhe shkakton vonesa të konsiderueshme gjatë ngarkimit të dokumenteve. Kjo është sfida kryesore për funksionimin e duhur të SIML pasi çdo komplikim i rrjetit të internetit ndikon drejtpërdrejt në punën e gjyqtarëve dhe stafit administrativ me

SIML. KGJK-ja mbikëqyr sigurimin e lidhjes me internet për gjykatat themelore përmes ofruesve të disponueshëm në treg<sup>80</sup>. Në disa raste, interneti në gjykatat themelore sigurohet nga KGJK nga dy ofrues të shërbimeve<sup>81</sup> dhe lidhjet rezervë ofrohen përmes teknologjisë wireless, sipas KGJK-së në 80% të gjykatave. Shumica e gjykatave themelore kanë gjithashtu një sistem të furnizimit me energji të pandërprerë (UPS) në rast se ndodhin ndërprerje të rrymës.

EULEX-i ka vërejtur një trend të përmirësimit, ku KGJK ka ndërmarrë veprime për të zvogëluar problemet e rrjetit. Një çështje sistemike mund të vërehet vetëm në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore (GJTH) të Prizrenit, ku lidhja me internet shpesh ndërpritet, dhe herë pas here zgjatë me ditë. KGJK-ja vazhdimisht ofron mbështetje për përmirësimin e lidhjes në internet dhe gjykatat mund të mbështeten në ndihmën e vazhdueshme nga stafi i TI-së dhe trajnerët e SIML-it. Megjithatë, qasja në internet në fund varet nga ofruesit e shërbimeve të internetit.

Në fillim të zbatimit të SIML, stafi i gjykatave trajnohej në baza ditore nga trajnerë të përhershëm të KGJK-së për mënyrën e punës me SIML. Në disa gjykata, përdorimi i SIML filloi vetëm disa muaj më vonë dhe një pjesë e stafit kryesisht kishte harruar se si të punohej me sistemin. Këta trajnerë nuk janë më në dispozicion dhe stafi i gjykatës që ka më shumë përvojë ofron mbështetje kur nevojitet. Në disa gjykata, u ofruan trajnime shtesë për stafin e ri dhe ata që dëshironin të merrnin pjesë. Masat e tilla shtesë të trajnimeve të përshtatura janë projektuar në përputhje me nevojat dhe kërkesat e stafit dhe zakonisht kanë zgjatur një deri në dy ditë. Numri i pjesëmarrësve ndryshonte nga dhjetë në GJTH të Pejës, 19 në GJTH të Gjilanit dhe 90 në GJTH të Prishtinës. Ndihma e ofruar nga stafi i TI-së ishte e kënaqshme dhe e duhur.

Në pjesën e parë të vitit 2023, KGJK ka kryer një vlerësim të nevojave për trajnim për përdorimin e SIML. Nga 1139 punonjës administrativ që morën pjesë në vlerësimin e nevojave të trajnimit, 234 u identifikuan për trajnim të plotë, 460 kishin nevojë për ritrajnim dhe 445 rezultuan se nuk kishin nevojë për trajnim, sepse ata tashmë ishin përdorues të pavarur të SIML. Gjithashtu, 34 gjyqtarë, të cilët i ishin bashkuar sistemit gjyqësor të Kosovës pak më parë, janë trajnuar për përdorimin e SIML-it.

SIML ofron mundësinë për të marrë informacion mbi ecurinë e lëndëve dhe punën e përditshme të gjyqtarëve. Ai u ndihmon kryetarëve të gjykatave themelore pasi u mundëson atyre të monitorojnë vazhdimisht punën e të gjithë gjyqtarëve dhe ofron një pasqyrë të shpejtë të raporteve dhe të dhënave të ndryshme, si dhe statistika të besueshme dhe një pasqyrë të statusit të lëndëve.

Në prill të vitit 2023, KGJK nxori një rregullorë<sup>82</sup> për kriteret e normës së punës së gjyqtarëve, e cila përcakton udhëzimet dhe kriteret për ngarkesën e punës së gjyqtarëve. Të dhënat për përcaktimin e normës së punës së gjyqtarëve nxirren direkt nga SIML. Qëllimi i rregullores është të motivojë gjyqtarët për të dhënë rezultate dhe për të rritur efikasitetin. Është ende herët për të vlerësuar se deri në çfarë mase kjo do ta rrisë performancën dhe cilësinë e punës së gjyqtarëve dhe nëse do të jetë efektive në reduktimin e numrit të lëndëve të pazgjidhura në gjykata.

Shumica e gjykatave kanë një sistem të rregullt të kujdestarisë gjatë fundjavave, i cili përfshin një gjyqtar kujdestar dhe një zyrtar të caktuar të gjykatës. Zakonisht të dy janë të trajnuar për përdorimin e SIML-it dhe regjistrimi i lëndëve bëhet në mënyrë të rregullt gjatë fundjavës. Vetëm në rastet e pengesave teknike të sistemit gjatë ditëve të kujdestarisë, dokumentet regjistrohen ditën e nesërme. Praktika e kujdestarive nuk aplikohet në të gjitha gjykatat, për shembull GJTH e Prishtinës nuk ka staf kujdestar për të pranuar dokumente gjatë fundjavave apo festave zyrtare. Në vend të kësaj, prokurori kujdestar e sjell dosjen fizike të lëndës në seancë dhe lëndët regjistrohen në SIML ditën punuese të radhës. Ngjashëm, në GJTH të Prizrenit, lëndët regjistrohen manualisht

80 Kryesori është Telekom i Kosovës.

81 Gjykata Themelore e Gjakovës siguron lidhje në internet nga dy burime, Posta e Kosovës dhe Art Motion. Gjykata Themelore e Prishtinës dhe Gjykata Themelore e Pejës kanë pasur gjithashtu lidhje rezervë me operatorin IPKO.

82 Rregullorja për normën e punës së gjyqtarëve, nr. 03/2023, botuar në gjuhën shqipe, [Imazhi i skanuar \(gjyqesori-rks.org\)](https://www.lmazhi.org) (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

në librin amzë gjatë fundjavave apo festave zyrtare dhe më pas regjistronen në SIML në ditën punuese të radhës. Sipas zyrtarëve të gjykatës, kjo nuk ka shkaktuar ndonjë pengesë dhe nuk janë vërejtur probleme në regjistrimin e lëndëve apo procedurat e tjera.

Në gjykatat e Kosovës, numri i përkthyesve/interpretëve është i pamjaftueshëm. Homologët e EULEX-it në gjykatat themelore argumentuan se arsyeja shpesh ishte mungesa e kandidatëve për pozitat, duke pasur parasysh pagën e ulët të ofruar. Për shkak të mungesës së aplikantëve të mjaftueshëm për pozitat e përkthyesve/interpretëve në gjykatat themelore, KGJK po planifikon të ulë kriteret për punësimin e kandidatëve. Një nga ndryshimet e diskutuara është heqja e kriterit për diplomë universitare. KGJK-ja do të iniciojë më tej diskutimet dhe do ta adresojë këtë çështje, megjithatë mungesa e diplomës universitare mund të paraqesë zbehje të aftësive gjuhësore të përkthyesve/interpretëve. Thënë kështu, kryetarët e gjykatave themelore dhe administrata e gjykatave e përshkruajnë cilësinë e përkthimeve me shkrim, përfshirë në gjuhët joshumicë, si të kënaqshme në shumicën e gjykatave. KGJK-ja ende duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë GJTH të Prishtinës, pasi që numri i përkthyesve/interpretëve është i pamjaftueshëm, po ashtu edhe në GJTH të Prizrenit, ku numri i përgjithshëm është i pamjaftueshëm dhe mungesa e një përkthyesi/interpreti për gjuhën turke duhet të adresohet<sup>83</sup>. Në pranverë të vitit 2023, KGJK filloi një projekt për zhvillimin e një sistemi të centralizuar të përkthimit, i cili synon të optimizojë përdorimin e burimeve të përkthimit në gjykata dhe të zvogëlojë vonesat e shkaktuara nga mungesa e përkthimit në kohë duke shpërndarë detyrat e përkthimit nëpër gjykata sipas nevojave.

Të gjitha proceset e punësimit në gjykata janë nën mbikëqyrjen dhe autoritetin e KGJK-së, i cili synon të bëjë zëvendësimin e stafit në gjykata, veçanërisht zëvendësimin e gjyqtarëve që pensionohen. Kryetarët e gjykatave themelore e informojnë KGJK-në për pensionimin e gjyqtarëve apo për pozitat e lira, si dhe bëjnë propozime për plotësimin e pozitave të lira me stafin aktual. Vërehet se proceset e punësimit të bashkëpunëtorëve profesionalë të gjyqtarëve kanë avancuar dhe më nuk janë të gjata si më parë. Zyra e burimeve njerëzore e KGJK-së i planifikon të gjitha zëvendësimet me kohë, por problemet qëndrojnë tek punësimi për shkak të procedurave burokratike dhe joefektive të ankesës. Trembëdhjetë gjyqtarë të rinj iu bashkuan GJTH të Prishtinës, dhe një grup tjetër i gjyqtarëve është duke vijuar trajnime. Ka pasur procese të vazhdueshme të punësimit të bashkëpunëtorëve profesionalë ku janë bërë përpjekje që secili gjyqtar të ketë një bashkëpunëtor në zyrë. Kjo nuk është zbatuar ende, për shkak të mungesës së kandidatëve.

KGJK ka hartuar rregullore të posaçme për punësimin e gjyqtarëve<sup>84</sup> dhe bashkëpunëtorëve<sup>85</sup>, të cilat parashikojnë afate për secilën fazë të procesit të punësimit, në mënyrë që proceset të mos zgjaten pafundësisht. Kjo ua lehtëson planifikimin kryetarëve të gjykatave.

## Konkluzione

SIML është elementi thelbësor i një administrate të drejtësisë që funksionon siç duhet në Kosovë. Shumica e rekomandimeve të mëparshme të EULEX-it janë adresuar mirë nga autoritetet përkatëse. Në veçanti, KGJK-ja ka vepruar për të siguruar lidhjet në rrjet dhe e ka përmirësuar efikasitetin e procesit të punësimit të gjyqtarëve. Në disa fusha, si trajnimi për SIML, numri i përkthyesve/interpretëve gjyqësorë dhe përdorimi i SIML si mjet i performancës, ende ka vend për përmirësim. Progresi që është bërë duhet të vazhdojë dhe duhet të sigurohet koordinimi ndërmjet të gjitha palëve të interesuara.

83 Aktualisht, procesi i punësimit të një përkthyesi për gjuhën turke është në proces.

84 Rregullorja Punësimi, provimi, emërimi dhe riemërimi i gjyqtarëve, nr. 03/2021, botuar në gjuhën shqipe [66244\\_Rregullore\\_Nr\\_03\\_2021\\_per\\_rekrutimin\\_provimin\\_emerimin\\_dhe\\_riemerimin\\_gjyqtareve.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/66244_Rregullore_Nr_03_2021_per_rekrutimin_provimin_emerimin_dhe_riemerimin_gjyqtareve.pdf) (gjyqesori-rks.org) (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

85 Rregullore për procedurën e rekrutimit dhe përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve profesionistë, Nr. 04/2021, botuar në gjuhën shqipe, [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/Igsl/92220\\_Rregullore\\_nr\\_04\\_2021\\_per\\_proceduren\\_rekrutim-it\\_dhe\\_perzgjedhjes\\_se\\_bashkepunetoreve\\_profesioanl.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/Igsl/92220_Rregullore_nr_04_2021_per_proceduren_rekrutim-it_dhe_perzgjedhjes_se_bashkepunetoreve_profesioanl.pdf) (qasja e fundit më 20 shtator 2024).

## Shtojcë – Lista e rasteve të monitoruara dhe të referuara

Pas themelimit të tij në vitin 2008, EULEX-it iu caktua mandat ekzekutiv në fushën e drejtësisë, që do të thotë se prokurorët dhe gjyqtarët ndërkombëtarë të EULEX-it kanë udhëhequr hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të krimeve të luftës, krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimeve tjera të rënda. Që nga qershori i vitit 2018, EULEX-i nuk e ka më këtë mandat dhe deri në dhjetor të vitit 2018, EULEX-i ka përfunduar transferimin e dosjeve përkatëse të rasteve tek autoritetet vendase të policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit. Rastet e përmendura në këtë raport, të cilat janë trajtuar nga EULEX-i gjatë mandatit të tij ekzekutiv, quhen ish-raste të EULEX-it.

### Ish rastet e EULEX-it<sup>86</sup>

#### Rasti Olympia (PKR 236/2017)

Më 21 korrik 2017, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore (GJTH) të Prishtinës kundër Alban Dezdarit (në paraburgim që nga data 7 korrik 2017) dhe Bedri Krasniqit (në vuajtje të dënimit për një rast tjetër), me akuzë për vrasje të rëndë. Ata akuzohen se kanë marrë pjesë në vrasjen e një zyrtari të UNMIK-ut dhe një zyrtari të Policisë së Kosovës në Podujevë në mars 2004, së bashku me katër autorë të tjerë, përfshirë dëshmitarin Shkumbin Mehmeti, i cili tashmë ishte dënuar me 30 vjet burgim në një gjykim tjetër për këtë vrasje më 9 nëntor 2007. Nga prilli 2019 në vazhdim, gjykata zhvilloi rregullisht seanca deri në mbylljen për shkak të COVID-19 në mes të marsit 2020. Rasti ka qenë joaktiv që atëherë. Kryetari i trupit gjykues doli në pension në maj 2021 dhe rasti u ricaktua. Rasti u transferua në Departamentin Special të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe në pranverë të vitit 2022 iu caktua një tjetër kryetar i trupit gjykues. Që nga vera e vitit 2022 ka pasur seanca të rregullta. Aktgjykimi është shpallur më 13 shtator 2023. Bedri Krasniqi është liruar nga akuza dhe Alban Dezdari është dënuar me tetë vjet burgim për ndihmë në kryerjen e veprës penale. Ai u lirua nga akuza për vrasje të rëndë në tentativë.

#### Rasti Enver Sekiraqa (PKR 170/2020)

Në këtë ish-rast të EULEX-it, i akuzuari është dënuar (nga një trup gjykues me shumicë të EULEX-it, pra shumica e gjyqtarëve në trupin gjykues ishin gjyqtarë ndërkombëtarë të EULEX-it) në shkallë të parë për shtytje në vrasjen e zyrtarit policor Triumf Riza në gusht të vitit 2007. Aktakuza ishte ngritur më 24 prill 2014 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë. Aktgjykimi është nxjerrë nga GJTH e Prishtinës më 17 maj 2016, e cili e ka shpallur fajtor për shtytje në kryerjen e vrasjes së rëndë dhe zhatje dhe e ka dënuar me dënim unik prej 37 vjet burgim. Gjykata e Apelit (GJA) vendosi, më 19 tetor 2017, kthimin e rastit në rigjykim për shkak të natyrës rrethimore të provave kundër të pandehurit dhe vështirësive në vërtetimin e shtytjes për kryerjen e vrasjes. Pas një rigjykimi para trupit gjykues të Kosovës, më 16 shtator 2019, GJTH e Prishtinës edhe një herë e shpalli fajtor të pandehurin për vrasje të rëndë dhe e dënoi me 30 vjet burgim.

Më 6 mars 2020, Gjykata e Apelit edhe një herë e prishi aktgjykimin e GJTH të Prishtinës dhe e dërgoi rastin në rigjykim të dytë. Ai filloi më 12 janar 2021 dhe përfundoi më 3 maj 2024 me

<sup>86</sup> Përrjashtuar rastet e krimeve të luftës të cilat janë të mbuluara në pjesën vijuese.



dënimin e të pandehurit me 25 vjet burgim, pasi është shpallur fajtor për shtytje në vrasjen e policit Triumf Riza. Pas shpalljes së dënimit, kryetari i trupit gjykues e liroi të pandehurin nga arresti shtëpiak, masë kjo e ankimuar nga prokurori i Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK). Pas aktvendimit të GJA për miratimin e ankesës së prokurorisë dhe vendimit për caktimin e masës së paraburgimit deri në fillimin e vuajtjes së dënimit nga i pandehuri, zyrtarët e PK-së vazhduan me zbatimin e aktvendimit deri në konstatimin se i pandehuri ishte larguar nga Kosova për të kërkuar trajtim mjekësor jashtë vendit, siç deklaroi avokati i tij mbrojtës.

### **Rasti City Club (P 100/2018- P 253/2016 - PAKR 434/2018 - PKR 191/2020)**

Më 21 korrik 2017, prokuroria ngriti aktakuzë pranë Gjykatës Themelore të Pejës kundër Granit Elshanit (në paraburgim që nga tetori 2016). Ai akuzohej se në janar të vitit 2010, në City Club në Pejë, kishte vrarë një person dhe kishte plagosur dy persona, duke përfshirë edhe Valdet Kelmendin, që ishte shënjestra. Ky sulm u pa si i lidhur me një gjakmarrje në mes të familjeve Elshani dhe Kelmendi, e cila kishte vazhduar për 15 vjet dhe gjatë së cilës ishin vrarë rreth njëzetë e katër persona nga të dyja familjet. Më 30 maj 2018, GjTH Pejë (P 253/2016) e dënoi të pandehurin me dënim unik prej 25 vjet burg për vrasje të rëndë, tentativë për vrasje të rëndë, shkaktim të rrezikut të përgjithshëm dhe armëmbajtje pa leje dhe përdorim të paligjshëm. I pandehuri u ankua kundër aktgjykimit dhe më 16 tetor 2018, Gjykata e Apelit (PAKR 434/2018) e anuloi aktgjykimin e shkallës së parë. Rigjykimi filloi në janar 2019. Shpallja e aktgjykimit ishte caktuar për 21 shtator 2020, por në vend të kësaj, kryetari i trupit gjykues rihapi shqyrtimin gjyqësor kryesor, me arsyetimin se procedura e provave nuk ishte ezauruar. Ai doli në pension në tetor të vitit 2020, dhe më pas GjTH e Pejës e transferoi rastin në Gjykatën Themelore (GjTH) të Gjakovës, pasi që e para nuk kishte mjaft gjyqtarë në Departamentin e Krimeve të Rënda. Rasti duhej të rifillonte në nëntor 2020 (PKR 191/2020) dhe seancat u zhvilluan rregullisht. Rigjykimi u përmbyll me shpalljen e aktgjykimit më 14 mars 2022. I pandehuri u dënua me dënim unik prej 24 vitesh burg për vrasje të rëndë, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm dhe armëmbajtje pa leje. Të dyja palët e apeluan vendimin dhe GJA e la në fuqi vendimin. Në korrik të vitit 2023, Gjykata Supreme hodhi poshtë akuzën për armëmbajtje pa leje, ndërsa për akuzat e mbetura, e anuloi aktgjykimin dhe e ktheu lëndën në GjTH të Gjakovës për rigjykim. Gjykimi filloi në shtator të atij viti dhe aktgjykimi u shpall më 30 nëntor 2023. Granit Elshani u lirua nga të gjitha akuzat e mbetura. Aktgjykimi është apeluar nga prokurori dhe rasti është në pritje në GJA.

### **Rasti Medicus (PKR 315/2018)**

Më 15 tetor dhe më 20 tetor 2010, prokuroria ngriti dy aktakuza në Gjykatën Themelore (GjTH) të Prishtinës (të bashkuara në një aktakuzë të vetme në nëntor 2010) kundër shtatë personave të akuzuar për trafikim të organeve njerëzore, krim të organizuar dhe krime të tjera të rënda. Aktakuza pretendon për dhjetëra transplantime ilegale të veshkave që ishin bërë në Klinikën Medicus gjatë vitit 2008. Të pandehurit kryesorë ishin urologu Lutfi Dervishi, i cili ishte pronar i klinikës, dhe djali i tij, Arban Dervishi, i cili e menaxhonte atë. Më 29 prill 2013, GjTH Prishtinë (trupi gjykues me shumicë nga EULEX, d.m.th. shumica e gjyqtarëve në trupin gjykues ishin gjyqtarë ndërkombëtarë të EULEX-it) i shpalli të pandehurit fajtorë për trafikim me njerëz dhe krim të organizuar dhe dënoi Lutfi Dervishin me tetë vjet burgim dhe Arban Dervishin me shtatë vjet e tre muaj. Një tjetër i pandehur në këtë rast, Sokol Hajdini, kryeanestezilog i klinikës, ishte dënuar me tre vjet burgim. Më 6 nëntor 2015, Gjykata e Apelit (GJA) (trupi gjykues me shumicë të EULEX-it) e vërtetoi aktgjykimin.

Në datën 8 mars 2016 Arban Dervishi dhe më 5 prill 2016 Lutfi Dervishi parashtuan kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimit të GJA. Në datën 7 mars 2016, edhe Sokol Hajdini ka bërë ankesë kundër të njëjtit aktgjykim të GJA. Më 20 shtator 2016, Gjykata Supreme

(GjS) (trupi gjykues me shumicë të EULEX-it) e liroi të pandehurin Sokol Hajdini nga akuzat për krim të organizuar dhe e shpalli fajtor për veprën penale të lëndimit të rëndë trupor. Më 15 dhjetor 2016, GjS, me një trup gjykues tashmë të përbërë me shumicë të gjyqtarëve vendas, nxori aktvendimin për kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruara nga Arban dhe Lutfi Dervishi. Vendimi i anuloi dënimet për Lutfi dhe Arban Dervishin dhe Sokol Hajdinin dhe e ktheu rastin në GjTH për rigjykim. Të pandehurit e tjerë ose ishin liruar më parë nga akuzat ose akuzat ishin hedhur poshtë. Më 11 janar 2017, GjTH e Prishtinës caktoi masën e paraburgimit ndaj Lutfi Dervishit, si dhe lëshoi një fletarrest ndërkombëtar kundër Arban Dervishit, i cili ishte në arrati.

Më 24 maj 2018, GjTH e Prishtinës (trup gjykues me shumicë të EULEX-it) e shpalli Lutfi Dervishin fajtor për trafikim me njerëz dhe krim të organizuar dhe shqiptoi një dënim prej shtatë vjet e gjashtë muaj burgim, gjobë prej 8000 euro dhe ndalim të ushtrimit të profesionit të mjekut urolog për një periudhë dyvjeçare duke filluar nga dita e vuajtjes së plotë të dënimit me burg. Sokol Hajdini ishte shpallur fajtor për lëndim të rëndë trupor dhe është dënuar me një vit burgim.

Pasi Lufti Dervishi dhe Sokol Hajdini e apeluan aktgjykimin e GjTH të Prishtinës të datës 24 maj 2018, GJA, më 6 nëntor 2018, e anuloi aktgjykimin dhe e dërgoi lëndën sërish për rigjykim të dytë. Aktgjykimi i Sokol Hajdinit u anulua pasi vepra kishte arritur parashkrimin absolut. Arban Dervishi u kthye në Kosovë në vitin 2019 dhe ndaj tij u pezullua urdhërarresti ndërkombëtar. Më 20 janar 2020 seanca e parë në rigjykimin e dytë ndaj Lutfi dhe Arban Dervishit u shty. Seanca u caktua më 2 mars 2020 por nuk u mbajt për shkak të kufizimeve të lidhura me pandeminë. Seanca e radhës u mbajt më 27 tetor 2020, pas së cilës gjykimi u shty për një kohë të pacaktuar për të ofruar kohë për gjetjen e dëshmitarëve/të dëmtuarve. Pas më shumë se një viti pasiviteti për shkak të vështirësisë në zbulimin e vendndodhjes të një numri të konsiderueshëm të këtyre të fundit, plani ishte që një seancë të zhvillohej më 1 mars 2022, por ajo u anulua për shkak të grevës së stafit administrativ në gjykatë. Po ashtu, gjyqtari kishte bërë disa kërkesa për përjashtim nga rasti për arsye të ndryshme, të gjitha të refuzuara nga kryetari i GjTH të Prishtinës. Një seancë e re ishte caktuar për 9 shtator 2022, kur rigjykimi duhej të fillonte nga fillimi për shkak se seanca e fundit produktive ishte mbajtur në vitin 2020. Më 16 qershor 2023, GjTH e Prishtinës nxori aktgjykimin e saj në rigjykimin e dytë duke i liruar nga akuza të dy të pandehurit. Apeli është aktualisht në pritje pranë GJA.

### **Rasti Grande I (PKR 305/2016) dhe Rasti Grande II (PKR 254/19)**

Më 16 dhjetor 2016, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore të Prishtinës kundër një grupi prej 20 të pandehurve, ku përfshihej Ukë Rugova, djali i ish-Presidentit Rugova. Të pandehurit u akuzuan për organizim dhe pjesëmarrje në grup kriminal, kontrabandë të migrantëve dhe mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve. Në aktakuzë pretendohet se të pandehurit kanë përdorur mjete mashtruese për të marrë viza Schengen për qytetarët e Kosovës nga Ambasada e Italisë në Kosovë, duke përvetësuar kështu përfitime të konsiderueshme materiale për veten e tyre. Gjyqtari e ndau lëndën në korrik 2019 në dy të raste të ndara për ta bërë procedurën më efikase. Rasti *Grande I* përfshinë pesë të pandehur, përfshirë Ukë Rugovën, ndërsa 15 të pandehurit e mbetur ishin grupuar në rastin *Grande II*. Gjykata zhvilloi rregullisht seanca për rastin *Grande I*, deri në mbylljen e lidhur me pandeminë COVID-19 në mesin e marsit 2020. *Grande I* ishte pothuajse në përfundim të procedurës së provave të shqyrtimit gjyqësor, pasi pothuajse të gjithë dëshmitarët (kishte dhjetëra dëshmitarë) ishin dëgjuar. *Grande II* po përparonte me një ritëm të arsyeshëm duke filluar nga janari 2020 deri në masat e mbylljes për shkak të pandemisë. Të dyja rastet ishin udhëhequr nga i njëjti kryetar i trupit gjykues, i cili u ulë në pozitë nga Departamenti i Krimeve të Rënda në shtator 2020, kështu që të dyja rastet u desh të rifillonin dhe iu caktuan një kryetari

të ri të trupit gjykues. *Grande I* rifilloi më 16 prill 2021, me seanca gjyqësore të rregullta. Gjatë seancës së fundit, më 10 maj 2022, të pandehurit dhanë deklaratat e tyre përfundimtare dhe njëri prej tyre njoftoi gjykatën se ai ishte liruar nga akuza nga një gjykatë italiane për të njëjtat vepra penale. Aktgjykimi ishte dërguar më vonë në GJTH të Prishtinës. Më 30 qershor 2023, GJTH e Prishtinës nxori aktgjykim për lirim nga akuza për të gjithë të pandehurit. Megjithatë, ky rast është ende në pritje pranë GJA për gjykimin e ankesës së parashtruar nga prokuroria. Në Rastin *Grande II*, GJTH e Prishtinës nxori aktgjykim më 19 nëntor 2023. Të gjithë 15 të pandehurit u liruan nga akuza e krimit të organizuar dhe kontrabandimit të migrantëve. Tre prej tyre u dënuan për armëmbajtje pa leje. Më 31 korrik 2024, GJA urdhëroi rigjykim për këtë rast, i cili tani është në proces pranë GJTH të Prishtinës.

#### **Rasti Toka 4 (PKR 130/2016)**

Më 3 mars 2016, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore (GJTH) të Prishtinës kundër 24 personave, përfshirë një numër gjyqtarësh. Rasti ka të bëjë me fitimin e paligjshëm të pronësisë të një sipërfaqe të madhe të tokës në pronësi shoqërore. Akuzat ishin për krim i organizuar, pastrim parash, nxjerrje e vendimeve gjyqësore të kundërligjshme dhe keqpërdorim të pozitës zyrtare në lidhje me reregjistrimin e tokës në pronësi shoqërore. Tashmë më 27 nëntor 2014, gjyqtari i procedurës paraprake kishte urdhëruar konfiskimin e përkohshëm të parcelave të tokës në vlerë rreth 20 milionë euro. Më 26 tetor 2017, u mbajt seanca e parë fillestare e ndjekur nga dy seanca të tjera në prill dhe maj 2019. Rasti ishte në fazën e gjykimit kryesor, megjithatë nuk u caktuan seanca gjyqësore deri më 20 maj 2022, kur disa pjesëmarrës, duke përfshirë një nga gjyqtarët, nuk ishin të pranishëm dhe seanca u shty. Seanca e caktuar më 20 korrik 2022 u anulua për shkak se kryetari i trupit gjykues ishte i sëmurë. Gjyqi tani është në fazën e fundit të provave dhe po ecën përpara shumë ngadalë, me seancën e ardhshme të caktuar për në tetor 2024.

#### **Rasti Olympus I (PKR 610/2016)**

Më 24 tetor 2016, prokuroria ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore (GJTH) të Prishtinës kundër Azem Sylës dhe të tjerë. Bëhet fjalë për 19 të pandehur të mbetur që janë aktualisht në procedurë gjyqësore. Rasti ka të bëjë me pronësinë e kundërligjshme të një pjese të madhe të pronës shoqërore në periudhën nga viti 2006 e deri më tani. Grupi dyshohet se ka arritur të regjistrojë pronësinë e pronave në favor të tyre përmes veprimeve korruptive duke shfrytëzuar personat në pozita kyçe në gjykata, zyrën kadastrale dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP). Vlera e përgjithshme e tregut e pronave është mbi 25 milionë euro. Nga nëntori 2018, GJTH e Prishtinës zhvilloi rregullisht seanca deri në mbylljen lidhur me COVID-19 në mesin e marsit 2020. Pasi kryetari i trupit gjykues u zhvendos në Gjykatën e Apelit në fund të vitit 2020, lënda u caktua te një kryetar i ri i trupit gjykues në fillim të vitit 2021 dhe gjykimi duhej të fillonte nga fillimi për shkak të kalimit të kohës që nga seanca e mëparshme. Dy të pandehur kishin qenë në paraburgim të procedurës paraprake për një kohë të gjatë, derisa në fund u liruan në arrest shtëpiak në qershor 2022. Aktakuzë u ngrit edhe kundër një të pandehuri tjetër dhe ai u vendos në paraburgim në gusht 2022. Pas dy vite e gjysmë në paraburgim ai ishte liruar në arrest shtëpiak dhe, në gusht 2024, ai u lirua nga arresti shtëpiak dhe u detyrua të paraqitet në polici një herë në javë. Hapi tjetër që pritet janë deklaratat përmbyllëse. Ky rast ka pasur një ritëm shumë të ngadalhtë, për çka Misioni e ka raportuar disa herë.

### **Rasti Olympus II (PKR 611/2016)**

Më 24 tetor 2016, prokuroria ngriti dy aktakuza në Gjykatën Themelore (GJTH) të Prishtinës në lidhje me rastet *Olympus I* dhe *Olympus II* që kishin të bënin me një grup të madh të supozuar të organizuar kriminal që në mënyrë të paligjshme kishte fituar pronësinë e një pjese të madhe të pronës shoqërore gjatë periudhës nga viti 2006 deri në vitin 2016. Akuzat e aktakuzës së rastit *Olympus II* kundër Baki Abdullahut, Hali Hysenit dhe 15 të pandehurve të tjerë ishin të kufizuara në pastrim parash. Më 3 shkurt 2020, gjykata tentoi të zhvillonte seancën e parë, por kushtet ligjore nuk u plotësuan për shkak të mungesës së pesë të pandehurve, ku njëri prej tyre pretendohet se jetonte jashtë vendit. Seanca e 17 marsit 2020 u pezullua për shkak të pandemisë. Pas vonesave të gjata, seanca fillestare për këtë rast më në fund u mbajt më 31 maj 2021. Pas shqyrtimit të dytë, gjyqtari lëshoi aktvendim për hedhjen poshtë të aktakuzës, më 22 korrik 2021. Ky aktvendim ishte ankimuar nga Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK) dhe u rrëzua nga Gjykata e Apelit (GJA) më 20 tetor 2021, e cila e ktheu rastin përsëri në gjykatën e shkallës së parë. Më 7 nëntor 2022, GJTH e Prishtinës i liroi të gjithë të pandehurit nga të gjitha akuzat dhe urdhëroi lirimin e të gjitha pronave të konfiskuara. Më 25 shtator 2023, GJA la në fuqi aktgjykimin e gjykatës themelore. Më 25 mars 2024, Gjykata e Supreme (GJS) refuzoi mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga prokuroria kundër lirit të 16 të pandehurve të mbetur (njëri prej tyre kishte ndërruar jetë ndërkohë).

### **Rasti Naser Kelmendi (PPS 42/2013, PKR 32/19, APS 30/2023)**

Më 4 korrik 2014, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore (GJTH) të Prishtinës kundër Naser Kelmendit për krim të organizuar, vrasje të rëndë, posedim, shpërndarje ose shitje të paautorizuar të narkotikëve dhe prodhim dhe përpunim të paautorizuar të narkotikëve. Më 1 shkurt 2018, gjykata e shpalli fajtor të pandehurin për veprën penale të posedimit, shpërndarjes ose shitjes së paautorizuar të narkotikëve dhe e dënoi me gjashtë vite burgim dhe e liroi nga të gjitha akuzat e tjera. Të dyja palët e apeluan vendimin. Më 2 gusht 2018, Gjykata e Apelit ktheu rastin për rigjykim të kufizuar në veprën penale të posedimit, shpërndarjes ose shitjes së paautorizuar të narkotikëve, vërtetoi lirimin nga akuza nga GJTH e Prishtinës për akuzat e tjera dhe urdhëroi pushimin e paraburgimit të Naser Kelmendit. Më 6 nëntor 2019, më shumë se një vit pas këtij vendimi të GJA, u zhvillua seanca fillestare e rigjyimit dhe seanca e dytë u zhvillua më 29 dhjetor 2019. Rasti kaloi nga Departamenti i Krimeve të Rënda në Departamentin e Posaçëm të GJTH të Prishtinës dhe seanca e re u mbajt më 26 janar 2022, e para pas asaj të datës 29 dhjetor 2019. Që atëherë, gjykimi përparoi, pasi kishte qëndruar joaktiv për gati tre vjet, dhe më 18 maj 2023, i pandehuri u shpall fajtor dhe u dënua nga GJTH e Prishtinës me katër vite e tetë muaj burgim. Aktgjykimin u apelua dhe më 3 tetor 2023, GJA rrëzoi vendimin e shkallës së parë dhe liroi të pandehurin nga akuza.

### **Rasti Salih Qitaku e të tjerë (PKR 591/16)**

Më 15 shtator 2014, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore (GJTH) të Prishtinës kundër Salih Qitakut, Fatmir Kastratit, Luan Miftarit dhe Sahit Sadriut për 'pjesëmarrje ose organizim të grupit të organizuar kriminal' dhe 'kontrabandim me migrantë'. Më 15 tetor 2015, GJTH e Prishtinës dënoi Salih Qitakun, Fatmir Kastratin dhe Luan Miftarin me katër vite burgim dhe me gjobë prej 1000 euro secilin, ndërsa Sahit Sadriun me tri vite burgim dhe 500 euro gjobë. Më 9 shtator 2016 Gjykata e Apelit anuloi vendimin e shkallës së parë dhe ktheu rastin për rigjykim. Më 12 korrik 2017 u zhvillua seanca fillestare e rigjyimit por u shty pa u caktuar një datë e re. Që nga ajo kohë, çështja ka mbetur joaktive për shkak të numrit të lëndëve të pazgjidhura në pritje që i janë caktuar gjyqtarit, i cili përfundimisht doli në pension në maj 2021. Gjyqtari i ri i caktuar në këtë rast së fundi ka parashtruar një urdhërarrest ndërkombëtar



kundër tre prej të pandehurve që ndodhen jashtë vendit, e që deri më tani pa ndonjë rezultat. Në korrik të vitit 2024, GJTH e Prishtinës e informoi Ministrinë e Drejtësisë se ende nuk kishte arritur të përfundojë përkthimin e disa dokumenteve relevante për rastin.

### **Rasti Touareg (P 176/2015)**

Më 23 tetor 2015, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore (GJTH) të Mitrovicës kundër tre vëllezërve Albert, Mentor dhe Arianit Beqiri dhe Vesat Imeri, duke i akuzuar për shmangie tatimore në shumë prej rreth 1.69 milionë euro. Ndërmjet viteve 2011 dhe 2012, vëllezërit, pronarë të biznesit NTP Oil Kosova, dyshohet se i kishin dhënë Administratës Tatimore informacione të rreme në lidhje me të hyrat e krijuara nga biznesi i tyre me qëllimin e shmangjes së pjesërishme apo të plotë të pagesës së tatimeve, tarifave ose kontributeve të parapara me ligj. Në këtë kontekst, të katër të pandehurit dyshohet se ishin të përfshirë në pastrim parash. Kjo lëndë ka qenë joaktive që nga korriku i vitit 2017, pasi kërkesa e palëve për hedhjen poshtë të aktakuzës ishte refuzuar nga GJTH Mitrovicë. Kryetari i trupit gjykues doli në pension në maj 2021 dhe lënda iu ricaktua një gjyqtari tjetër, i cili nuk ka ndërmarrë asnjë veprim që atëherë. Lënda u transferua në GJTH të Prishtinës në vitin 2024. Një përpjekje për të mbajtur një seancë dështoi dhe që atëherë nuk është mbajtur asnjë seancë.

### **Rasti Bill Clinton I (P. Nr. 459/2009) & Rasti Bill Clinton II (PKR 139/17)**

Më 12 gusht 2008, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën e atëhershme të Qarkut në Prishtinë kundër tre të pandehurve për vrasje të rëndë dhe tentimvrasje të rëndë (*Rasti Bill Clinton I*). Më 30 shtator 2013, prokuroria ngriti aktakuzë pranë Gjykatës Themelore (GJTH) të Prishtinës kundër pesë të pandehurve për vrasje të rëndë, tentimvrasje të rëndë dhe shkaktim të rrezikut të përgjithshëm, dhe më 13 dhjetor 2013, kundër dy të pandehurve të tjerë u ngrit aktakuzë për të njëjtat akuza. Më 20 shkurt 2014, të dy rastet u bashkuan (*Rasti Bill Clinton II*). Të dy rastet, *Bill Clinton I dhe II*, kanë të bëjnë me *Rastin Enver Sekiraqa*. Menjëherë pas vrasjes së zyrtarit policor të Policisë së Kosovës, Triumf Riza, në gusht të vitit 2007, PK-ja dyshoi në Enver Sekiraqën për orkestrimin e vrasjes. Në shtator të vitit 2007, kolegët e Rizës nga policia, në një akt hakmarrjeje, dyshohet se vendosën një bombë në objektin ku ndodhej një lokal në pronësi të Enver Sekiraqës, e cila vrau dy persona dhe plagosi disa të tjerë. Në *rastin Bill Clinton I*, dy të pandehurit (Shpend Qerimi dhe Besnik Hasani) u dënuan me 25 vjet burgim, ndërsa i treti (Nysret Cena) u lirua nga akuza nga GJTH e Prishtinës më 22 shtator 2009. Në *Rastin Bill Clinton II* kundër shtatë të pandehurve të tjerë, konkretisht Bejtullah Mehmeti dhe të tjerëve, në qershor të vitit 2016, GJTH e Prishtinës i hodhi poshtë të gjitha akuzat në bazë të mungesës së provave. Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK) e apeloj vendimin dhe në prill të vitit 2017, Gjykata e Apelit e ktheu rastin në rigjykim. Ky rast nuk ka pasur përparim për një kohë të gjatë. Në fillim të vitit 2020 u caktuan disa seanca, por procedurat u ndërpre në shkak të pandemisë dhe rasti mbeti joaktiv gjatë pjesës tjetër të vitit 2020, që vazhdoi në vitin 2021. Pati një ndryshim në përbërjen e trupit gjykues, më 26 mars 2021, dhe u emërua një kryetar i ri i trupit gjykues. Pas një periudhe të gjatë pasiviteti, një seancë u caktua në shtator 2024, por ishte joproductive. Rasti është ende në vazhdim.

### **Rasti Blu (Vrasja e Audrius Šenavičius) (PPP12/2016)**

Më 19 shtator 2013, autorë të panjohur hapën zjarr mbi një autokolonë që ishte nisur për në pikën e përbashkët të kalimit në Rudnica/Jarinje, duke vrarë pjesëtarin e stafit të EULEX-it, Audrius Šenavičius. Rasti fillimisht u hetua ekskluzivisht nga prokurorët e EULEX-it, dhe iu transferua gjyqësorit të Kosovës në vitin 2018, pas ndryshimeve në mandatin e EULEX-it. Rasti është ende duke u hetuar dhe nuk ka asnjë zhvillim të ri.



## Ish-rastet e EULEX-it të krimeve të luftës

### Rasti Drenica I (PPS 88/11, PKR 74/2018, SP nr.12/2024)

Më 6 nëntor 2013, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore (GJTH) të Mitrovicës kundër shtatë të pandehurve (Sabit Geci, Ismet Haxha, Sahit Jashari, Avni Zabeli, Sami Lushtaku, Sylejman Selimi dhe Jahir Demaku) të akuzuar për krime të luftës kundër popullatës civile ndërmjet qershorit dhe shtatorit 1998 në lidhje me qendrën e paraburgimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Likoc të Skenderajt. Më 27 maj 2015, gjykata e shkallës së parë i lroi nga akuzat të pandehurit Sabit Geci, Ismet Haxha, Sahit Jashari, Avni Zabeli dhe Jahir Demaku. Prokuroria u ankua në Gjykatën e Apelit (GJA), e cila më 15 shtator 2016 e shpalli Jahir Demakun fajtor dhe vërtetoi aktgjykimin aktvendimet të gjykatës së shkallës së parë për lirim nga akuza në katër rastet e mbetura. Sami Lushtaku në aktgjykimin e shkallës së parë është shpallur fajtor për vrasje të rëndë dhe përgjegjësi komanduese për cenim të integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të pidentifikuar të civilëve dhe ai u ankua kundër këtij aktgjykimi. Ai u lirua nga akuza për vrasje në shkallë të dytë përmes aktgjykimit të lartpërmendur të 15 shtatorit 2016 të GJA. Më vonë, së bashku me Sylejman Selimin, ai po ashtu u lirua nga akuza për pikën tjetër të përgjegjësisë komanduese me aktgjykimin e datës 3 korrik 2017 të GJS, pas çka ai u lirua. Në atë aktgjykim të GJS-së u vërtetua dënimi i GJA-së, i dhënë më 15 shtator 2016, të Jahir Demakut dhe Sylejman Selimit për shkelje të integritetit trupor dhe shëndetit të një mashkulli të pidentifikuar nga zona e Shipolit në Mitrovicë duke e rrahur vazhdimisht.

Më 11 qershor 2018, GJS e ktheu rastin për rigjykim në GJTH të Mitrovicës dhe të dy të pandehurit e dënuar (Jahir Demaku dhe Sylejman Selimi) u liruan nga vuajtja e dënimit, por mbetën në burg për të vuajtur dënimin e shqiptuar në lidhje me aktgjykimin e *rastit Drenica II*, deri kur u liruan me kusht me vendimet e panelit për lirim me kusht të datës 24 tetor 2018 dhe 25 janar 2019. Pas krijimit të departamentit special në GJTH të Prishtinës, GJTH e Mitrovicës e dërgoi lëndën në departamentin special të GJTH të Prishtinës, duke konsideruar se më nuk ishte nën juridiksionin e saj. Në prill të vitit 2019, departamenti special e kishte kthyer lëndën në GJTH të Mitrovicës, me arsyetimin se kjo e fundit tashmë kishte filluar gjykimin e këtij rasti dhe prandaj duhet ta përfundonte atë. Më 6 nëntor 2019, u caktuan dy anëtarë të trupit gjykues në GJTH të Mitrovicës, por seanca fillestare e caktuar për 26 dhjetor 2019 ishte shtyrë për më 25 mars 2020, me kërkesë të prokurorit. Për shkak të kufizimeve të lidhura me pandeminë, seanca dëgjimore e datës 25 mars 2020 nuk u zhvillua. Seanca e caktuar për 7 dhjetor 2020 u anulua gjithashtu pasi u konfirmua se kryetari i trupit gjykues ishte infektuar me COVID-19. Dalja në pension e gjyqtarit, në fund të prillit 2021, shkaktoi vonesa shtesë. Lënda mbeti joaktive derisa përfundimisht u transferua, në shkurt të vitit 2024, nga GJTH e Mitrovicës në GJTH të Prishtinës, së bashku me lëndët tjera, pasi gjyqtarët në GJTH të Mitrovicës kishin kërkuar me vite që këto lëndë të transferoheshin. Më 25 prill 2024, të dy të pandehurit në këtë rigjykim, Sylejman Selimi dhe Jahir Demaku, u liruan nga akuza nga gjykata e shkallës së parë.

### Rasti Fahredin Gashi e të tjerë (PKR 143/15)

Më 5 nëntor 2010, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën e atëhershme të Qarkut në Prishtinë kundër Fahredin Gashit nën dyshime për kryerjen e veprës penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile, dhe kundër Hysri Ramës për dhënien e ndihmës autorëve pas kryerjes së veprave penale. Gjyqtari i caktuar e informoi EULEX-in në atë kohë se rasti ishte pezulluar, si rastet e tjera të Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK), derisa të mund të transferohej në juridiksionin e departamentit special. Lënda u transferua nga EULEX-i në gjyqësorin vendas në gusht të vitit 2015 dhe më pas ishte joaktive për një periudhë të gjatë, derisa më në fund procedurat rifilluan në vitin 2022, kur rasti iu caktua një paneli të departamentit special. Trupi gjykues caktoi disa seanca gjyqësore në të cilat ishte i pranishëm i pandehuri. Para gjykatës

u dëgjuan ekspertë vendorë, të cilët deklaruan se i pandehuri Fahredin Gashi nuk ishte më në gjendje të gjykohej. Kryetari i trupit gjykues ka analizuar mundësinë për të dëgjuar edhe një ekspert ndërkombëtar. Aktualisht, rasti është joaktiv, në pritje të vendimit për pushimin e shqyrtimit gjyqësor në bazë të pamundësisë së të pandehurit për t'u gjykuar.

## Rastet jo-EULEX<sup>87</sup>

### Rasti i vrasjes së Oliver Ivanović (PS 54/2019)

Më 16 janar 2018, lideri i 'Iniciativës qytetare serbi, demokraci, drejtësi (GI SDP)', Oliver Ivanović, u vra jashtë objektit të partisë në Mitrovicë. Autori nuk u identifikua. Më 3 dhjetor 2019, Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK) ngriti aktakuzë pranë Gjykatës Themelore (GJTH) të Prishtinës kundër gjashtë të pandehurve. Aktakuza pretendon se vrasësi u ndihmua nga tre zyrtarë policorë të PK-së, Nedeljko Spasojević, Marko Rošić (të dy në paraburgim) dhe Silvana Arsović (nën detyrim për t'u paraqitur në polici) dhe se dy zyrtarë policorë të tjerë të PK-së, Dragiša Marković dhe Žarko Jovanović (të dy nën detyrimin për t'u paraqitur në polici), kishin manipuluar provat pas vrasjes. Aktakuza gjithashtu pretendon se ka zbuluar një rrjet të organizuar kriminal, i cili kishte vepruar që nga viti 2014 dhe në të cilin dyshohet se ishin pjesë zyrtarët policorë të PK-së Spasojević dhe Rošić, së bashku me të pandehurin e gjashtë, Rade Basara (në paraburgim). Në prill të vitit 2021, kryetari i trupit gjykues refuzoi kërkesat për hedhjen poshtë të aktakuzës dhe kundërshtimeve të parashtruara nga mbrojtja ndaj provave të propozuara nga prokuroria, pas çka të pandehurit u ankuan në Gjykatën e Apelit (GJA). Më 6 korrik 2021, GJA e refuzoi kërkesën dhe filloi shqyrtimi gjyqësor. Më 28 qershor 2024, gjykata shpalli aktgjykimin. Nedeljko Spasojević u dënua me katër vite e gjashtë muaj burg për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe 4500 euro gjobë për armëmbajtje pa leje. Marko Rošić u dënua me dhjetë vite burgim dhe 10,000 euro gjobë për 'pjesëmarrje ose organizim të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale' në lidhje me vrasjen. Kryetari i trupit gjykues njoftoi se Rošić do të caktohet në paraburgim (i arrestuar), por më vonë u bë e qartë se ai ishte larguar nga Kosova. U lëshua një fletarrest i brendshëm dhe ndërkombëtar. Dragiša Marković u shpall fajtor për 'keqpërdorim të detyrës zyrtare' dhe u dënua me katër vite burgim, por u shpall i pafajshëm për zbulimin e informacionit konfidencial. Žarko Jovanović u shpall fajtor për bashkëpunim në shpërdorim të detyrës zyrtare dhe u dënua me katër vite burgim dhe 1500 euro gjobë për armëmbajtje pa leje. Silvana Arsović, ish-sekretare e Ivanoviçit, u lirua nga akuza. Prokurori ka pushuar hetimet penale ndaj Rade Basaras. Aktgjykimi ende nuk është hartuar.

### Rasti 3% (P. 2022/17)

Më 28 prill 2017, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore të Prishtinës kundër Bujar Bukoshit (ish-kryeministër i Kosovës), Naser Osmanit (ish-deputet i LDK) dhe Atdhe Gashit (ish-këshilltar i Bujar Bukoshit). Të pandehurit dyshohet se kanë keqpërdorur para nga buxheti i 'donacioneve 3%' për Kosovën (kontribut vullnetar, kryesisht nga diaspora për mbështetjen e Kosovës gjatë viteve 1990) gjatë periudhës 2006-2015 (Bujar Bukoshi dyshohet për rreth 91,000 euro, Naser Osmani dhe Atdhe Gashi së bashku dyshohen për rreth 154,000 euro). Rasti ndaj Bujar Bukoshit më pas është veçuar për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore të tij, ku ai po trajtohet jashtë vendit. Më 3 dhjetor 2018, gjykata hodhi poshtë kërkesën e Naser Osmanit dhe Atdhe Gashit për hedhjen poshtë të aktakuzës. Gjykata e Apelit (GJA) refuzoi ankesat e tyre

<sup>87</sup> Me përjashtim të rasteve të krimeve të luftës të cilat janë të mbuluara në pjesën vijuese.

më 17 janar 2019. Më 15 gusht 2019, gjykimi filloi me seanca të rregullta deri në fund të tetorit 2019. Rasti vazhdoi me vonesa, më 31 janar 2020, dhe vazhdoi më tej vetëm në korrik 2020 për shkak të vonesës në dorëzimin e një raporti nga një ekspert financiar. Rasti pati vonesa të mëtejshme për shkak të gjendjes me pandeminë COVID-19 në GJTH të Prishtinës dhe mungesës së prokurorit për një kohë për shkaqe të ndërlidhura me COVID-19. Më 11 nëntor 2020, gjykata shpalli aktgjykimin, me shpalljen fajtorë të Naser Osmanit dhe Atdhe Gashit për veprën penale të keqpërdorimit të parave. Të pandehurit u dënuan me nga tri vitet burgim dhe janë urdhëruar që të kthejnë në buxhetin e Kosovës shumën prej 154,132,47 euro. Sa i përket veprës penale të evazionit fiskal, gjyqtari ka refuzuar nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të parashkrimit absolut të veprës penale. Më 15 shtator 2021, GJA ktheu rastin për rigjykim pas ankesës së mbrojtjes. Rigjykimi filloi në janar 2022 dhe vazhdoi me seanca të rregullta. Në vendimin e saj të datës 13 korrik 2023, gjykata i shpalli fajtorë të pandehurit dhe i dënoi me tri vite burgim. Me vendimin e shpallur më 19 dhjetor 2023, GJA uli dënimet me burg për të dy të pandehurit në 18 muaj. Më në fund, Gjykata Supreme vendosi, më 30 maj 2024, se veprat penale kishin arritur parashkrimin absolut qysh më datën 20 maj 2022. Prandaj, rasti penal kundër dy të pandehurve duhet të kishte përfunduar në atë datë, me rezultat se nuk kishte më rast penal kundër të pandehurve.

### **Rasti i të Turqve të dëbuar (PPS 33/2019, PS nr 8/21, APS 50/2023)**

Në këtë rast, gjashtë shtetas turq ishin deportuar brenda natës në Turqi në fund të marsit 2018, në bazë të një kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë të Turqisë, e cila i ishte përcjellë Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës përmes Ambasadës së Turqisë në Kosovë. Më 21 tetor 2019, Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK) hapi hetim zyrtar kundër 22 zyrtarëve policorë (të gradave të ulëta) dhe tre civilëve nën dyshimin e përfshirjes në deportimin e gjashtë shtetasve turq. Më 23 shkurt 2021, PSRK ngriti aktakuzë pranë Gjykatës Themelore (GJTH) të Prishtinës kundër ish-shefit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës (AKI), Driton Gashi, drejtorit të Departamentit për shtetësi, azil dhe migrim në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës, Valon Krasniqi, dhe drejtorit të Drejtorisë për migrim dhe të huaj të policisë kufitare, Rahman Sylejmani. Të pandehurit Driton Gashi dhe Valon Krasniqi u akuzuan për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, ndërsa i pandehuri Rahman Sylejmani për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar dhe veprën penale të privimit të kundërligjshëm të lirisë. Seanca fillestare u mbajt më 24 mars 2021, ndërsa aktakuza u konfirmua më 21 maj 2021. Mirëpo, pas ankesës së mbrojtjes, më 11 gusht, Gjykata e Apelit (GJA) vendosi të anulojë këtë vendim dhe ta kthejë këtë rast në gjykatë themelore për rishqyrtim me arsyetimin se ka pasur shkelje esenciale të procedurës penale. Gjykata themelore refuzoi hedhjen poshtë të aktakuzës, duke çuar në rishqyrtimin e serishëm të rastit nga GJA, e cila përfundimisht konfirmoi aktakuzën më 18 dhjetor 2021. Aktgjykimi u shpall më 19 korrik 2023. Gjykata shpalli ish-shefin e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës (AKI), Driton Gashi, fajtor dhe e dënoi me katër vite e tetë muaj burgim, si dhe i shqiptoi dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik në kohëzgjatje prej katër vitesh pas lirit nga burgju. Valon Krasniqi dhe Rahman Sylejmani u liruan nga akuza. Aktualisht rasti është në pritje para GJA pas ankimimit të mbrojtjes.

### **Rasti Syri i Popullit (PKR 46/2018)**

Më 27 shkurt 2018, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore (GJTH) të Prishtinës kundër Sadri Ramabajës, Murat Jasharit, Ragip Sallova, Avni Llumnica, Sabit Berisha, Bexhet Luzha, Halim Halimi, Bajrush Konjusha, Lirije Luzha dhe Rexhep Topllana. Ata akuzoheshin për

hakmarrje, përgatitje të veprave terroriste apo penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës, për vrasje të rëndë në tentativë dhe vepra të tjera penale. Ky grup pretendohet se kishte nxjerrë një listë të shqiptarëve të Kosovës që duhej të ekzekutoheshin si tradhtarë. Ish-zyrtari i lartë komunist, Azem Vllasi, i mbijetoi një atentati nga ana e anëtarit të dyshuar të grupit, Murat Jashari, në mars të vitit 2017. Tre të pandehur ishin në paraburgim, ndërsa një në arrest shtëpiak. I pandehuri Jashari ishte në paraburgim në institucion mjekësor për shkak të problemeve të rënda mendore. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor pranë gjykatës themelore, prokurori ka tërhequr akuzat ndaj të pandehurve Sabit Berisha dhe Lirije Luzha. Në janar 2020, të gjithë, me përjashtim të dy të pandehurve, u shpallën fajtorë. Të pandehurit kryesorë morën këto dënime me burgim: Avni Llumnica 12 vjet; Sadri Ramabaja pesë vjet; Murat Jashari 10 vjet. Më 21 korrik 2020, Gjykata e Apelit anuloi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e ktheu rastin në GJTH të Prishtinës për rigjykim, si dhe udhëzoi Prokurorinë Speciale të Kosovës (PSRK) që të ndryshojë aktakuzën lidhur me të pandehurin Murat Jashari me propozim për mjekim të detyrueshëm psikiatrik. Pas ndarjes së rastit, GJTH e Prishtinës, më 11 nëntor 2022, shpalli aktgjykimin për rigjykimin lidhur me dy të pandehurit e mbetur, duke e dënuar Avni Llumnicën me katër vite e gjashtë muaj burgim dhe duke e liruar nga aktakuza Sadri Ramabajën. Në ankesë, aktgjykimi është ndryshuar dhe Avni Llumnica është dënuar me katër vite burgim.

### **Rasti Gjyqtari Sali Berisha (PS.nr.10/20, APS nr.45/2023)**

Më 5 shkurt 2020, Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK) ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore (GJTH) të Prishtinës kundër Sali Berishës për dy akuza për marrje ryshfeti dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve. Gjyqtari i GJTH të Pejës Sali Berisha ishte arrestuar fillimisht për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe mbajtje në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve. Ai u akuzua në lidhje me një rast në të cilin i pandehuri ishte dënuar me dënim të butë. Dyshohet se i pandehuri në fjalë, i akuzuar për dy pika të kontrabandimit të migrantëve, vepër e dënueshme me deri në 12 vjet burgim, kishte marrë një dënim me kusht prej tre vjetësh burgim në këmbim të pagesës prej 10 mijë eurosh. Seanca fillestare, e caktuar më 23 mars 2020, u shty për shkak të pandemisë dhe përfundimisht u zhvillua më 18 shtator 2020. Sali Berisha kërkoi që aktakuza të hudhej poshtë, të cilën GJTH e refuzoi, dhe më 23 shtator 2021 u mbajt seanca e parë. Më 28 prill 2023, GJTH e Prishtinës e shpalli fajtor për të dyja akuzat dhe e dënoi me dy vjet e gjashtë muaj burgim dhe 5000 euro gjobë. Atij i është ndaluar edhe ushtrimi i funksioneve të administratës publike ose të shërbimit publik për tre vjet. Më 29 shkurt 2024, Gjykata e Apelit vërtetoi aktgjykimin fajësues, por e ndryshoi dënimin në lidhje me burgimin dhe gjobën, përkatësisht në dy vjet dhe 3500 euro.

### **Rasti Autostrada e Shkupit (PPS 40/2019)**

Më 4 shkurt 2022, Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK) ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore (GJTH) të Prishtinës kundër tre të pandehurve të akuzuar për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar. Të pandehurit ishin Pal Lekaj, ish-ministri i infrastrukturës, ish-shefi i kabinetit të tij, Eset Berisha, dhe Nebih Shatri, ish-sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës. PSRK kishte nisur një hetim kundër tre të pandehurve në gusht të vitit 2019 në lidhje me një kërkesë nga konsorciumi Bechtel-Enka, që kërkonte nga Qeveria e Kosovës pagesën e 53 milionë eurove shtesë për punimet ndërtimore në autostradën e Shkupit. Një konsulencë e jashtme, me detyrë mbikëqyrjen e ekzekutimit të kontratës së ndërtimit, ka nxjerrë një raport ku thuhet se qeveria nuk duhet të paguajë më shumë se 14 milionë euro, duke vlerësuar se kërkesa e konsorciumit për t'u paguar 53 milionë euro nuk ishte legjitime. Tre të

pandehurit dyshohet se e injoruan këtë raport dhe siguruan që Qeveria të vendoste t'i paguante Bechtel-Enka të gjithë shumën që kishte kërkuar (53 milionë euro). Më vonë, gjykata e zgjeroi aktakuzën, duke shtuar edhe të pandehurin tjetër, Besim Tahirin, punonjës në departamentin e prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës. Shqyrtimi gjyqësor filloi më 16 dhjetor 2022, pasi gjykata kishte refuzuar kundërshtimet e të pandehurve ndaj provave të propozuara nga prokuroria në mbështetje të aktakuzës dhe kërkesave të tyre për hedhjen poshtë të aktakuzës. Më 31 janar 2024, GJTH e Prishtinës shpalli aktgjykimin me të cilin të gjithë të pandehurit u shpallën fajtorë. Ata u dënuan me burgim si në vijim: Pal Lekaj - tri vite e tetë muaj, Nebih Shatri - një vit e tetë muaj, Eset Berisha - tri vite e tre muaj dhe Besim Tahiri - një vit e tetë muaj. Mbrojtja e apeloj aktgjykimin dhe rasti aktualisht është në pritje të ankimimit në Gjykatën e Apelit.

### **Rasti i Autostradës së Gjilanit (PPS 34/2019)**

Në janar të vitit 2021, prokuroria ngriti aktakuzë kundër disa zyrtarëve të Ministrisë së Infrastrukturës në Gjykatën Themelore (GJTH) të Prishtinës për shkelje në lidhje me një proces tenderimi për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Gjilan. Të pandehur ishin Betim Reçica (ish-sekretar i Ministrisë së Infrastrukturës), Isa Berisha, Leonora Limani dhe Mirdit Emini (zyrtarë në Ministrinë e Infrastrukturës). Betim Reçica akuzohej për disa vepra penale, duke përfshirë ushtrimin e ndikimit, keqpërdorimin e pozitës apo autoritetit zyrtar dhe pastrimin e parave. Tre të pandehurit e tjerë akuzohen për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar. Në gusht të vitit 2021, Gjykata e Apelit (GJA) konfirmoi aktakuzën e nxjerrë nga GJTH e Prishtinës dhe filloi shqyrtimi gjyqësor. Më 7 maj 2024, GJTH e Prishtinës nxori aktgjykimin dhe liroi nga akuza të gjithë të pandehurit. Prokuroria e apeloj vendimin dhe rasti aktualisht është në pritje në GJA.

### **Rasti Hidrocentrali (PS 17/2020)**

Më 10 prill 2020, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore (GJTH) të Prishtinës kundër 19 të pandehurve, ku përfshiheshin katër ish-ministrat Besim Beqaj, Mimoza Kusari-Lila, Dardan Gashi dhe Nenad Rašić. Të pandehurit akuzoheshin për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar në lidhje me pretendimet për bartjen e gabuar, në vitin 2013, të katër hidrocentraleve nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) tek Kompania e Shpërndarjes së Energjisë së Kosovës (KEDS) me qëllim që ato hidrocentrale të përfshihen në procesin e privatizimit të KEDS-it në një konsorcium turk, Limak-Calik. Vlera e hidrocentraleve llogaritet në 12 milionë euro. Seanca fillestare u mbajt më 28 tetor 2020, dhe më 4 mars 2021, GJTH e Prishtinës vendosi të hedhë poshtë aktakuzën kundër 13 të pandehurve të paditur. Shqyrtimi kryesor kundër gjashtë të pandehurve të mbetur, përfshirë katër ish-ministrat, filloi më 1 korrik 2021. Më 7 nëntor 2023, GJTH e Prishtinës shpalli aktgjykimin për këtë rast, ku të gjithë të pandehurit u liruan nga të gjitha akuzat.

### **Rasti Infrakos (PP / I nr.60 / 2018)**

Më 31 dhjetor 2019, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore (GJTH) të Prishtinës kundër Sadik Paqarizit, Nijazi Kryeziut dhe Visar Islamajt, zyrtarë në drejtorinë për urbanizëm dhe planifikim hapësinor në Komunën e Prizrenit, kundër Bujar Nerjovajt, drejtor i inspeksionit në Komunën e Prizrenit, dhe ndaj Bashkim Krasniqit, inspektor ndërtimor në drejtorinë për inspektim në Komunën e Prizrenit, për keqpërdorim të detyrës zyrtare ose tejkalim të kompetencave zyrtare me qëllim të përfitimit pasuror për një person tjetër (në shumën prej 104



674,61 euro). Përfitues ishin pronarët e objekteve të ndërtuara rreth hekurudhës pa respektuar infrastrukturën hekurudhore. Agron Thaqi, kryeshef ekzekutiv i Infracos – Hekurudhat e Kosovës dhe Naim Avdyli, bashkëpunëtor profesional në Infracos – Hekurudhat e Kosovës, dyshohej se i kishin shkaktuar dëme Infracosit për shkak se nuk kishin kryer detyrat e tyre zyrtare për mbikëqyrjen dhe menaxhimin e pronave hekurudhore. Të gjithë ata akuzoheshin për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare. Më 20 janar 2023, të gjithë të pandehurit u liruan nga akuza nga GJTH e Prizrenit. Apelimi është aktualisht në pritje në GJA.

### Rastet Stenta (PKR 40/2018)

Prokuroria ka ngritur aktakuzë më 14 qershor 2016 në Gjykatën Themelore (GJTH) të Prishtinës kundër 60 të pandehurve dhe dy personave juridikë për veprat penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, marrje dhe dhënie ryshfeti, trajtim i papërgjegjshëm mjekësor, ushtrim i kundërligjshëm i aktivitetit mjekësor apo farmaceutik dhe evazion fiskal.

GJTH e Prishtinës vendosi ta ndajë rastin për shkak të numrit të madh të të pandehurve të përfshirë.

Ferid Agani, ish-ministër i shëndetësisë dhe Gani Shabani, ish-sekretar i përgjithshëm i ministrisë, janë akuzuar në *rastin Stenta I* për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Atyre iu ishinqiptuar 2.5 vite dhe 2 vite burgim përkatësisht me aktgjykimin e shkallës së parë të 24 prillit 2019. Megjithatë, pas ankesës së mbrojtjes, Gjykata e Apelit (GJA) e ktheu rastin në GJTH të Prishtinës për rigjykim. Në vitin 2020 nuk ka pasur seanca të planifikuara, por në qershor 2021, rasti ka nisur me një ritëm mjaft efikas deri në fund të korrikut, kur edhe ka përfunduar rigjykimi. Prokurorja para se të prezantojë fjalën përfundimtare ka ndryshuar aktakuzën, duke theksuar se dëmi i pretenduar i buxhetit të Kosovës është zvogëluar nga rreth 4.5 milionë euro në 11 mijë euro. Aktgjykimi u shpall më 1 gusht 2022 dhe të dy të pandehurit u liruan nga akuzat. GJA e konfirmoi vendimin më 23 qershor 2023.

Në *rastin Stenta II*, 45 të pandehur, pothuajse të gjithë mjekë, u akuzuan për keqpërdorim të pozitës zyrtare në bashkëkryerje dhe për marrje ryshfeti. Më pas, ky rast u nda në dy pjesë: *Rasti Stenta II.1*, me shumicën e të pandehurve dhe *Rasti Stenta II.2*, me vetëm gjashtë të pandehur, të cilët gjatë gjyqimit kanë munguar pjesërisht për shkak të problemeve shëndetësore. *Rasti Stenta II.1* rifilloi me një seancë produktive në dhjetor 2021 dhe vazhdoi deri në maj 2022, megjithëse me një ritëm të ngadaltë me seanca të shumta që shtyheshin për shkak të mungesës së të pandehurve. Gjithashtu, për këtë rast është dashur të caktohet një kryetar i ri për shkak të problemeve shëndetësore të të parit, gjë që ka shkaktuar vonesa të mëtejshme. Rasti përfundimisht përfundoi në shkallë të parë në shtator 2023, kur të gjithë të pandehurit u liruan nga akuzat. Në *rastin Stenta II.2* seancat u shtynë vazhdimisht për një kohë të gjatë, kryesisht pasi të pandehurit mungonin për arsye shëndetësore. Gjykimi rifilloi në pranverë të vitit 2024 dhe aktgjykimi u shpall më 24 korrik. Të gjithë të pandehurit u liruan nga akuzat.

Së fundi, *Rasti Stenta III* lidhet me 14 të pandehur (persona fizikë dhe juridikë). Ata përballen me akuzat për dhënie ryshfeti, trajtim të pandërgjegjshëm mjekësor, ushtrim të paligjshëm të veprimtarisë mjekësore dhe evazion fiskal, individualisht dhe në bashkëkryerje. Disa nga të pandehurit janë shtetas të huaj (p.sh. Turqia dhe Maqedonia e Veriut). Pas një periudhe të gjatë për vërtetimin e aktakuzës, seanca hapëse e shqyrtimit gjyqësor ishte dashur të mbahej në tetor të vitit 2020, por ajo u ricaktua dhe u shty për shkak se mbrojtja pretendoi se nuk kishte qasje në shkresat e lëndës. Në nëntor 2021, seancat u caktuan përsëri, por u shtynë për shkak të çështjeve që kishin të bënin me përkthimin e dokumenteve të çështjes për të pandehurit e huaj. Shqyrtimi kryesor ka rifilluar në vitin 2024 dhe është ende në vazhdim, me progres të ngadaltë.

### Rasti Veteranët (PKR 230/2018)

Në shtator të vitit 2018, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore (GJTH) të Prishtinës kundër 12 personave në rastin e njohur në opinion si “Veteranët”, nën akuzën e keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar. Të pandehur ishin Agim Çeku, Nuredin Lushtaku, Sadik Halitjaha, Shkumbin Demaliaj, Qelë Gashi, Shukri Buja, Ahmet Daku, Rrustem Berisha, Faik Fazliu, Smajl Elezaj, Fadil Shurdhaj dhe Xhavit Jashari. Ata akuzoheshin se kanë keqpërdorur pozitën e tyre si anëtarë të komisionit shtetëror duke u mundësuar pothuajse 20 mijë personave të përfitojnë beneficione për veteranë që nuk u takojnë, duke i shkaktuar një dëm buxhetit të Kosovës në vlerë mbi 68 milionë euro. Shqyrtimi gjyqësor u shty për shkak të pandemisë. Më 19 janar 2021, GJTH e Prishtinës shpalli aktgjykimin, duke i liruar të 12 të pandehurit nga të gjitha akuzat. Prokuroria u ankua në Gjykatën e Apelit, e cila, në prill të vitit 2022, e anuloi aktgjykimin dhe e ktheu lëndën në Gjykatën Themelore të Prishtinës për rigjykim. Pas pesë përpjekjeve të dështuara, sëra e parë e rigjykimit u mbajt më 31 tetor 2023. Shqyrtimi gjyqësor është ende në vazhdim me progres të ngadalë.

### Rasti Avanci (PPS 19/19)

Më 6 tetor 2020, Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK) ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore (GJTH) të Prishtinës kundër dy të pandehurve, njëri zyrtar i Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale (AKMP), tjetri punonjës i Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), për veprat e dyshuara penale të përvetësimit në detyrë dhe ndërhyrje në sistemet kompjuterike. Sipas prokurorit, dëmi i supozuar i buxhetit kap vlerën e mbi një milion eurove të marra nga keqpërdorimi i avanceve për udhëtime zyrtare jashtë vendit. Shqyrtimi gjyqësor aktualisht është në fazën e administrimit të provave dhe aktualisht rasti është në ngërç që nga data 21 maj 2024, kur shqyrtimi gjyqësor është shtyrë për një kohë të pacaktuar derisa ekspert i cili është urdhëruar nga gjykata për kryerjen e ekspertizës shtesë ta finalizojë dhe të sigurojë konkluzionet e tij/saj. Deri në datën e raportimit, janë mbajtur sëra të shumta, ku janë thirrur shumë dëshmitarë për të dëshmuar, shumica prej tyre kanë qenë të dyshuar në fillim të hetimeve, por më vonë janë liruar nga akuzat pasi nuk u gjetën prova kundër tyre.

### Rasti Brezovica I (PP/I 99/17– PKR 160/20)

Më 6 nëntor 2020, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore (GJTH) të Ferizajt kundër tre të pandehurve për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe tetë të pandehurve për ndotje, degradim apo shkatërrim të mjedisit në Parkun Kombëtar të Brezovicës. Pas 12 seancave fillestare të dështuara, sëra fillestare përfundimisht u mbajt më 26 qershor 2023. Më 9 gusht 2023, prokurori tërhoqi akuzat kundër dy të pandehurve (Dimitrije Racicević dhe Sanije Geci), dhe më 1 shkurt 2024, tre të pandehit (Blerim Imeri, Naser Kelmendi dhe Arian Idrizaj) janë dënuar me gjobë totale prej 55.000 euro së bashku për veprën penale të ndotjes, degradimit dhe shkatërrimit të mjedisit, pas marrëveshjes së tyre për pranimin e fajësisë. Më 6 shkurt 2024, si dhe si rezultat i marrëveshjes për pranimin e fajësisë, edhe i pandehuri tjetër (Riad Hasani) është dënuar me 15 mijë euro gjobë për këtë vepër penale dhe 10 mijë euro si dëmshpërblim. Në mënyrë të ngjashme, më 15 shkurt 2024, një i pandehur tjetër (Fatmir Grainc) gjithashtu u dënuar me 15,000 euro gjobë dhe 10,000 euro si kompensim për dëmin për të njëjtën vepër penale. Më 4 korrik 2024, GJTH e Ferizajt dënoi edhe dy të pandehur të tjerë (Dragomir Milosavljević dhe Hysni Bajrami) me një vit burgim dhe 500 euro gjobë për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, ndërsa Labinot Vitija është dënuar me një vit burgim me kusht dhe 20,000 euro gjobë. Më 19 korrik 2024, GJTH e Ferizajt liroi nga akuza

Gentian Sulon, shtetas shqiptar i akuzuar për degradim të mjedisit, për të cilin lënda ishte veçuar, më 6 shtator 2023, për shkak të lëndimeve që kishte pësuar në një aksident, duke e lejuar atë të marrë pjesë në seancat përmes videokonferencës. Aktualisht, rasti është në pritje të ankimimit në GJA pas ankimimit të prokurorit.

### **Rasti Brezovica II (PP/L.nr.138/20, PKR 239/22)**

Më 9 dhjetor 2022, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore (GJTH) të Pejës kundër 12 të pandehurve, përfshirë ish-kryetarin e komunës së Shtërpcës, ish-drejtorin e departamentit të urbanizmit të komunës, dy inspektorë komunalë, shefin e kadastrës komunale, ish-sekretarin e përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe kryeinspektorin e MMPH-së, së bashku me disa investitorë privatë. Më 3 prill 2023, pas disa përpjekjeve të dështuara, përfundimisht u zhvillua seanca fillestare. Të pandehurit akuzohen për keqpërdorim të pozitës zyrtare, marrje ryshfeti, ushtrim të ndikimit dhe armëmbajtje pa leje. Më 2 nëntor 2023 ishte paraparë të fillojë shqyrtimi gjyqësor, por tre të pandehur kanë munguar dhe ai është shtyrë për më 13, 14 dhe 18 dhjetor 2023. Mirëpo, më 13 dhjetor 2023, fillimi i shqyrtimit gjyqësor është shtyrë edhe një herë për shkak të mungesës së njërit prej të pandehurve, për shkak të gjendjes së tij shëndetësore. Seancat e 14 dhe 18 dhjetor 2023 dhe 24 janar 2024 gjithashtu u anuluan. Më 15 maj 2024, u bë një shtyrje e re e shqyrtimit gjyqësor. Gjykimi ka nisur sërish me kryetar të ri, pas transferimit të kryetarit të mëparshëm në Gjykatën Supreme. Prokurori i rastit ka paraqitur kërkesë për largimin e kryetarit të ri të trupit gjykues në atë rast, bazuar në faktin se një nga avokatët mbrojtës ka qenë edhe avokat i djalit të saj në një rast tjetër, por kryetari i GJTH të Pejës e refuzoi kërkesën e tij, për të cilën prokurori u ankua. Më shumë se një vit e tetë muaj pas ngritjes së aktakuzës, rasti është ende në vazhdim.

### **Rasti Transporti (PKR 147/2016)**

Më 11 nëntor 2016, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore (GJTH) të Mitrovicës kundër 21 të pandehurve të akuzuar për udhëheqje dhe pjesëmarrje në grup të organizuar kriminal, shmangie nga pagesa e detyrimeve doganore, kontrabandë me mallra (kryesisht karburant dhe cigare mes Kosovës dhe Serbia), tregti të ndaluar dhe evazion fiskal, të gjitha në bashkëkryerje. Shtatë nga 21 të pandehur janë akuzuar edhe për armëmbajtje pa leje. Disa të pandehur janë pronarë të pompave të benzinës në veri të Kosovës. Shqyrtimi kryesor filloi në mesin e vitit 2018 dhe pati vonesa të gjata, me asnjë seancë të mbajtur pas pandemisë. Për shkak të ngarkesës së lëndëve në GJTH të Mitrovicës, ky rast, krahas 12 rasteve të tjera komplekse me aktakuza të ngritura nga prokurorët e EULEX-it në kohën kur EULEX-i kishte mandat ekzekutiv, në shkurt të vitit 2024 iu transferua departamentit special në GJTH të Prishtinës. GJTH e Prishtinës ka bërë përpjekje të fillojë gjykimin, por ende nuk janë zhvilluar seanca produktive.

## Rastet e krimeve të luftës që nuk janë shqyrtuar nga EULEX-i

### Rasti Remzi Shala (P 181/2016), i njohur edhe si 'Rasti Molla Kuqe'

Në tetor të vitit 2016, prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore (GJTH) të Prizrenit kundër Remzi Shalës për krime lufte kundër popullatës civile. I pandehuri ishte pjesëtar i UÇK-së dhe dyshohet se, së bashku me pesë apo gjashtë anëtarë të tjerë të pidentifikuar të UÇK-së, kishin rrëmbyer dhe vrarë një person më 26 qershor 1998. Më 3 korrik 2019, GJTH e Prizrenit e kishte shpallur të pandehurin fajtor për veprën penale të krimeve të luftës kundër civilëve dhe e dënoi me 14 vjet burgim. I pandehuri ka apeluar aktgjykimin dhe më 26 nëntor 2019, Gjykata e Apelit (GJA) ka miratuar pjesërisht ankesën dhe ka ndryshuar aktgjykimin, duke e ndryshuar dënimin në dhjetë vjet burgim. Ankesa e të dëmtuarit është refuzuar si e pabazuar. Mbrojtësi i të pandehurit kundër këtij aktgjykimi ka parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale. Më 2 mars 2020, Gjykata Supreme (GJS) e ndoqi kërkesën dhe i anuloi të dy aktgjykimet dhe ktheu lëndën në rigjykim në GJTH të Prizrenit. Më 27 qershor 2023, trupi gjykues shpalli aktgjykimin, duke e shpallur fajtor të pandehurin. Remzi Shala u dënua me nëntë vjet e gjashtë muaj burgim. Aktgjykimi i GJTH të Prizrenit është lënë në fuqi nga GJA me aktgjykim të dhënë më 5 dhjetor 2023.

### Rastet Vukotić (PPS 35/2020, P 57/2019 dhe P 86/2017)

Më 4 tetor 2023, Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK) ngriti aktakuzë kundër Zoran Vukotić, me pretendimet se më 4 maj 1999, në një fshat të komunës së Vushtrrisë dhe në bashkëkryerje me tre persona të tjerë, kishte dhunuar seksualisht një vajzë nga popullata civile shqiptare - krim lufte kundër popullatës civile sipas nenit 142 të Kodit Penal të Jugosllavisë (KPRSFJ) (*Rasti Zoran Vukotic V*). Menjëherë pas kësaj, lëndët e mëparshme të EULEX-it që ishin në pritje për shumë vite pranë Gjykatës Themelore (GJTH) të Mitrovicës u transferuan në GJTH të Prishtinës. Në mesin e tyre ishin *Rasti Zoran Vukotic I* dhe *Rasti Zoran Vukotic III* (më shumë detaje mbi këto raste mund të gjenden më poshtë). Ndaj të njëjtit të pandehur ka pasur edhe dy raste të tjera, *Zoran Vukotic II* dhe *Zoran Vukotic IV*, të cilat pas përfundimit të ankesave përkatësisht në vitin 2019 dhe 2023 kanë përfunduar me aktgjykim dënues, prandaj nuk janë të detajuara në këtë raport.

Në *rastin Zoran Vukotic I*, kundër të pandehurit u ngrit aktakuzë, më 20 prill 2017, pasi dyshohet se kishte marrë pjesë, si pjesëtar i forcave policore serbe dhe si roje burgu, në bashkëkryerje me anëtarë të tjerë të pidentifikuar të policisë serbe, në ndalimin e paligjshëm të një numri të madh të civilëve, shqiptarë të Kosovës, në burgun e Smrekovnicës në rajonin e Mitrovicës, nga maji deri në fillim të qershorit 1999, ku thuhet se ai i kishte nënshtruar ata në torturë dhe trajtime të tjera çnjerëzore. Më 25 maj 2018, GJTH e Mitrovicës ka nxjerrë aktgjykimin me të cilin të pandehurin e shpallë fajtor dhe i ka shqiptuar dënimin me gjashtë vjet e gjashtë muaj burgim. Aktgjykimi u ankimua nga i pandehuri dhe më 30 janar 2019, Gjykata e Apelit e anuloi pjesërisht aktgjykimin e GJTH të Mitrovicës dhe lënda iu dërgua gjykatës themelore për rigjykim të pjesshëm.

Në *rastin Zoran Vukotic III*, prokuroria ka ngritur aktakuzë kundër Zoran Vukoticit në GJTH të Mitrovicës më 23 qershor 2017. Ai u akuzua se më 17 prill 1999, në Vushtrri, dyshohet se, si pjesëtar i forcës policore serbe dhe në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të pidentifikuar të asaj force, kishte marrë pjesë në plaçkitjen e popullatës civile shqiptare të Kosovës dhe kishte vrarë një 13-vjeçar shqiptar të Kosovës. Seanca fillestare është mbajtur më 15 dhjetor 2017. Pas kësaj date nuk është mbajtur asnjë seancë.

Gjykata vendosi t'i bashkojë tri rastet e mbetura (*Zoran Vukotic I, III dhe V*) në një dhe t'i gjykojë ato së bashku. Aktualisht ajo lëndë e bashkuar është në pritje në GJTH të Prishtinës.

### **Rasti Mejë (PPS 60/2010)**

Më 7 dhjetor 2023, Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK) ngriti një aktakuzë në mungesë në Gjykatë Themelore të Prishtinës kundër 53 pjesëtarëve të ushtrisë, policisë dhe forcave paramilitare serbe, të cilët dyshohet se kishin kryer krime lufte të shumta kundër popullatës civile dhe krime kundër njerëzimit duke përgatitur dhe më vonë duke ekzekutuar një plan për një sulm të gjerë dhe sistematik kundër popullatës civile shqiptare në fshatrat Mejë, Korenicë, Junik dhe të tjerë (gjithsej 33 fshatra), duke kryer mbi 370 vrasje dhe shumë dëbime të popullsisë civile shqiptare. Aktakuza i është kthyer PSRK-së për ndryshim.





eulex.kosovo



eulexkosovo



eulex.kosovo



eulex-mission-in-kosovo



EULEXKosovo



[www.eulex-kosovo.eu](http://www.eulex-kosovo.eu)